

Fjala e Auditorit të Përgjithshëm

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kam kënaqësinë e veçantë të paraqes para Kuvendit të Republikës së Kosovës Raportin Vjetor të Auditimit për vitin fiskal 2016.

Për vitin 2016 kemi përmbushur në tërësi planin vjetor të punës duke publikuar 105 raporte individuale të auditimit dhe raportin e auditimit të pasqyrave financiare të buxhetit të Republikës së Kosovës.

Në Raportin Financiar Vjetor për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 është dhënë opinion i pa modifikuar me theksim të çështjes, për shkak të mos shpalosjes adekuate të informatave sa i përket shënimeve shpjeguese.

Gjatë vitit janë shënuar disa zhvillime pozitive në raportimin financiar për vitin 2016, duke përfshirë rritjen e realizimit të hyrave nga tatimet direkte dhe indirekte, financimet nga huamarrja e brendshme, performancën e mirë buxhetore në realizimin pagesave, regjistrimin e pagesave nga palët e treta në sistemin për menaxhimin financiar dhe të kontabilitetit. Gjithashtu, deficitit buxhetor është në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.

Përkundër këtyre trendëve pozitive, në raportin e auditimit kemi vënë theksin në disa çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me regjistrimin e pasurive. Përfundimisht në vitin 2016, është arritur të regjistrohen pasuritë në vlerën prej 8.1 miliardë euro, përkundër faktit që pasuria publike është shumë më e madhe. Vëmendje të shtuar kërkon trajtimi i obligimeve të papaguara që kanë arritur në nivelin e 215 milionë eurove si dhe llogaritë e arkëtueshme të cilat janë rritur në 548 milionë euro.

Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet operimit të ndërmarrjeve publike. Ato janë karakterizuar me raportime financiare të pasakta që kanë rezultuar me opinione negative të auditimit. Të gjitha ndërmarrjet e audituara punojnë me humbje në total prej 1.5 milionë euro, derisa detyrimet e katër ndërmarrjeve të audituara arrijnë në 8.2 milionë euro prej të cilave pjesa dërmuese janë detyrime afatshkurtëra. Pra, mbetet sfiduese pozita e vështirë financiare dhe rreziku i likuiditetit të obligimeve të ndërmarrjeve që që vështirëson seriozisht mbarëvatjen e veprimtarisë së tyre.

Duke audituar në mënyrë të pavarur fondet publike dhe pastaj duke raportuar gjetjet përmes publikimit të raporteve individuale u kemi dhënë të gjithëve mundësinë për të monitoruar Qeverinë, Komunat, Institucionet e Pavarura dhe disa Ndërmarrje Publike. Në mënyrë të përgjegjshme kemi punuar që të ndihmojmë institucionet e Kosovës të përdorin mirë paranë, të forcojnë qeverisjen e mirë dhe të përmirësojnë jetën e qytetarëve.

Përkundër kësaj, niveli i zbatimit të rekomandimeve për vitin 2015 nuk është premtues, pasi vetëm 26% janë zbatuar plotësisht, 37% pjesërisht dhe 38% e tyre nuk janë zbatuar. Për vitin fiskal 2016 kemi dhënë 1314 rekomandime nga të cilat 914 me prioritet të lartë.

Fakti që numri i rekomandimeve është rritur dhe shkalla e zbatimit të tyre ka shënuar rënie, shtron nevojën e patjetërsueshme për një plan nacional të zbatimit të masave konkrete dhe të koordinuara mirë për përmirësimin e menaxhimit financiar në Kosovë.

Ngritja e llogaridhënies po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme, duke i pasur parasysh sfidat rreth burimeve të kufizuara buxhetore për të financuar kërkesat në rritje nga të gjitha komponentët e shoqërisë dhe për të përkrahur ambicet institucionale për integrimin e vendit në Bashkimin Evropian.

Për sezonin auditues 2016/2017, përveç cilësisë kemi rritur mbulshmërinë në auditim krahasuar me vitin paraprak për dy auditime të rregullsisë, dy auditime të performancës sikurse kemi audituar për herë të parë katër ndërmarrje publike. Në këtë kuadër vlen të theksohet pjesëmarrja në Kongresin e 22-të të Organizatave Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe komunikimi i vazhdueshëm e shkëmbimi i përvojave në rajon dhe vendeve të Bashkimit Europian.

Po ashtu, kemi vazhduar me rritjen e cilësisë së punës sonë bazuar në standardet ndërkombëtare të auditimit dhe të pajtueshmërisë ligjore që ka ndikuar që të rritet mbulimi në auditim, rritet siguria dhe të ulen kostot operative të veprimtarisë sonë.

Një vëmendje të veçantë i kemi kushtuar intensifikimit të bashkëpunimit me palët e interesit, veçanërisht me organizatat e shoqërisë civile dhe mediat si dhe forcimit të bashkëpunimit me institucionet e drejtësisë.

Ne synojmë të punojmë ngushtë me Kuvendin dhe Qeverinë për t'i zhvilluar më tej reformat aktuale në ndërtimin e qeverisjes së mirë dhe sistemeve më të mira për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe të vazhdojmë t'i përmbahemi fuqimisht parimeve themelore për auditim cilësor dhe plotësisht të paanshëm.

Dëshiroj me këtë rast të falënderoj organizatat partnere si Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë, BE, USAID, GIZ dhe DEMOS për përkrahjen e vazhdueshme për ngritjen e kapaciteteve tona.

Në fund, por jo më pak e rëndësishme është respekti dhe falënderimi për personelin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, subjektet e audituara dhe Kuvendin e Kosovës që kanë punuar së bashku për përmbushjen e objektivave audituese, në interes të përmirësimit të qeverisjes në institucionet publike në Kosovë.



Besnik Osmani

Auditor i Përgjithshëm

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti Vjetor i Auditimit përmban rezultatet e auditimit të Raportit Financiar Vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe gjetjet kryesore në auditimin e të gjitha organizatave publike të financuara nga Buxheti i Kosovës për vitin fiskal 2016, sikurse edhe auditimet e performancës dhe të katër ndërmarrjeve publike që kanë qenë subjekt i auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Auditimet tona janë ndërmarrë në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA) për auditimet e rregullsisë (auditimi i pasqyrave vjetore financiare dhe pajtueshmërisë me rregulloret) dhe auditimet e performancës (rishikimi i vlerës për para, projekteve dhe sistemeve).

Ne kemi audituar RFV/BRK-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, i cili përfshinë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e konsoliduar të krahasimit të buxhetit me realizimin, pasqyrën e konsoliduar në para të gatshme dhe bilancin e fondeve si dhe shënimet shpjeguese/shpalosjet e pasqyrave financiare dhe kemi dhënë Opinion të pamodifikuar me theksim të çështjes, sepse sipas opinionit tonë, RFV i BRK-së prezanton një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, në përputhje me SNKSP dhe Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Po ashtu, në raport janë përfshirë konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit, për të ndihmuar përdoruesit e raportit në fazat e zbatimit. Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore janë:

Përderisa në nivel të konsolidimit të RFV të BRK-së ka çështje pozitive për të raportuar, duke përfshirë opinionin i cili është i pa modifikuar, përmirësime nevojiten tek shënimet shpjeguese, në veçanti pjesët që i përkasin pasurive kapitale, llogarive të arkëtueshme dhe borxhit publik të cilat kanë ndikuar në theksimin e çështjes.



Raporti Financiar Vjetor i Buxhetit të Kosovës 2017 duhet të adresoj të gjitha mangësitë e identifikuara në këtë raport, veçmas çështjen e shpalosjeve dhe ato që kanë ndikuar në opinionin e auditimit.
(Kapitulli 1)

Niveli i dobët i implementimit të rekomandimeve të auditimit është duke rezultuar në dobësi të vazhdueshme në kontrollet e brendshme dhe në efikasitetin operacional të Organizatave Buxhetore.



Një fokus i shtuar dhe masa të llogaridhënies duhet të zbatohen në të gjitha nivelet e menaxhimit për të përmirësuar nivelin e adresimit të rekomandimeve nga Organizatat Buxhetore.
(Kapitulli 2).

Edhe pse kornizat ligjore dhe strategjitë ekzistojnë për të mbështetur aranzhimet e qeverisjes së mirë tek organizatat Buxhetore, implementimi i saj kërkon ende përmirësime.



Vetëvlerësimi objektiv i kontrolleve të brendshme, fuqizimi i njësisve të auditimit të brendshëm dhe përmirësimi i vlerësimit të rreziqeve, janë disa nga çështjet kyçe që kërkojnë zhvillim për të përmirësuar sistemet e qeverisjes në Organizatat Buxhetore.

(Kapitulli 3)

Përmirësimet në prokurim janë të ngadalshme si pasojë e implementimit të pamjaftueshëm të rekomandimeve të auditimit dhe funksionalizimit të platformës e-prokurimi.



Një llogaridhënie e forcuar ndaj menaxherëve/zyrtarëve të prokurimit duhet të aplikohet. Kontrollë shtesë në tërë procesin e prokurimit duhet të vendosen, në veçanti në mbikëqyrjen e punëve dhe menaxhimin e kontratave.

(Kapitulli 4)

Performanca e Organizatave Buxhetore është duke stagnuar si pasojë e mungesës së menaxhimit efektiv strategjik dhe operacional përcjellur nga një kornizë ligjore të përshtatshme.



Objektiva të qarta dhe rezultate të monitoruara më nga afër janë zhvillimet kyçe që kërkohen për të përmirësuar menaxhimin e performancës në sektorin publik të Kosovës.

(Kapitulli 5)

Hyrje

Auditimi i jashtëm i sektorit publik kryhet nga Auditori i Përgjithshëm i mbështetur nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Puna jonë ka për qëllim që të ndihmoj bartësitë e funksioneve publike të forcojnë qeverisjen e mirë, rrisin performancën dhe shërbimet. Për sezonin auditues 2016/17, ne në tërësi kemi përmbushur planin vjetor të punës dhe kemi arritur të publikojmë 106 raporte auditimi, prej të cilave:

- 92 auditime të rregullsisë të organizatave buxhetore;
- 4 auditime të ndërmarrjeve publike;
- 2 auditime të projekteve të donatorëve;
- 7 auditime të performancës – që kanë të bëjnë me projektet dhe programet, me theks të veçantë ekonominë, efikasitetin dhe efektivitetin në përdorimin e burimeve, dhe
- Raportin e auditimit të Buxhetit të Kosovës

Raportet tona, duke përfshirë këtu edhe Raportin Vjetor të Auditimit, promovojnë procesin e llogaridhënies së Qeverisë dhe shpenzuesve tjerë buxhetor përmes shqyrtimit të raporteve të tyre në Kuvendin e Kosovës, Kuvendet komunale dhe para organeve tjera kompetente. Publikimi i raporteve tona, gjithashtu u mundëson qytetarëve të jenë të informuar dhe t'i mbaj llogaridhënës ata të cilët janë përgjegjës për përdorimin e burimeve publike.

Puna jonë në këtë Raport Vjetor të Auditimit është përmbledhur si më poshtë:

Kapitulli	Fokusi	Përmbajtja
1	Raporti Financiar Vjetor i Buxhetit të Kosovës	Ky raport reflekton rezultatet e auditimit të RFV të Qeverisë dhe pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore individuale. Gjetjet relevante janë të theksuara së bashku me mekanizmat për të përmirësuar pajtueshmërinë me standardet e kontabilitetit.
2	Adresimi i rekomandimeve të dhëna në vitet paraprake	Rekomandimet e auditimit janë të fokusuara drejt përmirësimit të kualitetit në raportimin financiar të jashtëm, përmirësimit të Menaxhimit Financiar dhe shërbimeve publike. Vlerësimi i veprimeve të ndërmarra në rekomandimet e kaluara është një element i rëndësishëm i punës së ZKA-së dhe është raportuar këtu.
3	Qeverisja e mirë	Qeverisja efektive mbështet performancën organizative të mirë dhe ofron kualitet të mirë të kontroleve të brendshme. Produkti i punës tonë në këtë fushë është përmbledhur këtu dhe ne kemi konsideruar iniciativat për të përkrahur qeverisjen në të gjitha nivelet.
4	Prokurimi	Proceset e prokurimit adresojnë nivele të rëndësishme të shpenzimeve publike, dhe në këtë pjesë ne kemi raportuar rezultatet e auditimeve të rregullsisë dhe performancës të fokusuara në këtë çështje.
5	Performanca në fusha specifike	Performanca e OB-ve në sigurimin e ekonomisë, efektivitetit dhe shërbimeve efikase ka ndikim direkt në cilësinë e shërbimeve të ofruara për individët dhe bizneset, pavarësisht burimeve të pamjaftueshme. Në këtë pjesë është raportuar performanca e një numri të fushave në këtë kapitull.
6	Auditimi i Pasqyrave Financiare i katër (4) ndërmarrjeve publike	Ky kapitull prezanton rezultatet e auditimit të pasqyrave financiare të ndërmarrjeve publike nëse ato japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. Të gjeturat kryesore janë të theksuara, si dhe rekomandimet përkatëse për të përmirësuar pajtueshmërinë me standardet e kontabilitetit.

Raporti ka tri shtojca. E para shpjegon opinionet e ndryshme të dhëna nga AP në auditimet e rregullsisë. E dyta specifikon opinionet e dhëna dhe arsyetimet përkatëse. Përveç kësaj, janë përmbledhur edhe rekomandime të rëndësishme të auditimit të bëra për institucionet e audituara. E treta specifikon se si janë adresuar rekomandimet e dhëna në Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2015.

Raportet e auditimeve individuale mund të gjenden në webfaqen e ZKA-së <http://www.zka-rks.org/publications/>.

1 Auditimi i Raportit Financiar Vjetor 2016

Ministria e Financave në emër të Qeverisë, ka përgatit RFV/BRK-së për vitin 2016 me 31 mars të vitit 2017 në formatin e kërkuar me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) dhe sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”.

RFV/BRK-së përmbledhë transaksionet në lidhje me të gjitha aktivitetet e Qeverisë, me përjashtim të aktiviteteve të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës.

Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të RFV/BRK sipas SNKSP - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e RFV-ve pa keq deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri i Financave është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm është që të shpreh opinion për RFV/BRK. Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, ta planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keq deklarime materiale.

1.1 Opinioni i Auditimit

ZKA ka audituar RFV/BRK-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, i cili përfshinë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e konsoliduar të krahasimit të buxhetit me realizimin, pasqyrën e konsoliduar në para të gatshme dhe bilancin e fondeve si dhe shënimet shpjeguese/shpalosjet e pasqyrave financiare.

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë, RFV i BRK-së prezanton një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, në përputhje me SNKSP dhe Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me ndryshime dhe plotësime).

ZKA ka kryer auditimin në përputhje SNISA. Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë, ZKA është e pavarur nga Qeveria e Kosovës/ Ministria e Financave, dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Theksimi i çështjes

ZKA tërheq vëmendjen tuaj për faktin se në RFV/BRK-së:

- Vlera totale e shpenzimeve kapitale e prezantuar nuk mund të konsiderohet e saktë për shkak të keq klasifikimit të investimeve kapitale. Shpenzimet për mallra/shërbime dhe subvencione/transfere në vlerë prej 14,640,098€ ishin keq klasifikuar si investime kapitale. Nga këto, 13,408,945€ për shkak të buxhetimit jo të drejtë të shpenzimeve nga MF, si dhe 1,231,153€ janë keq klasifikuar nga OB-të, si pasojë e gabimeve dhe aplikimit jo të drejtë të planit kontabël. Shkak i kësaj është arsyeja se me rastin e përgatitjes së buxhetit të Republikës së Kosovës nga MF, nuk janë kryer analizat e hollësishme dhe nuk janë aplikuar kontrollet e duhura për të eliminuar keq klasifikimin e projekteve në procesin buxhetor. Klasifikimi i gabuar i shpenzimeve ka rezultuar në nënvlerësimin e shpenzimeve për mallra/shërbime dhe subvencione, dhe mbivlerësimin e investimeve kapitale;
- Në pasqyrën e shpalosjeve, pasuritë jo financiare mbi 1,000€ për nivelin e qeverisjes qendrore janë prezantuar në vlerë prej 2,413,988,556€, kurse sipas auditimeve individuale vlera e këtyre pasurive ishte 2,405,092,643€. Diferenca prej 8,895,913€, është rezultat i mbivlerësimeve¹ në vlerë 13,837,933€ dhe nën vlerësimeve² në vlerë 4,942,020€. Shkak i kësaj ishte mungesa e një procesi efektiv dhe të plotë të procesit të konsolidimit dhe të regjistrimit të pasurive në SIMFK. Prezantimi jo i plotë dhe i saktë i pasurive ndikon proceset e vendimmarrjes në lidhje me ndarjet buxhetore;
- Katër (4) komuna nuk i kanë regjistruar në SIMFK pasuritë jo financiare mbi 1,000€ dhe nuk janë prezantuar në pasqyrat e tyre financiare. Si pasojë e kësaj, nuk janë paraqitur as në RFV/BRK-së;
- Nuk është prezantuar borxhi publik, vlera e të cilit është 852,738,034€ (478,970,587€ borxh i brendshëm dhe 373,767,447€ borxh i jashtëm) dhe 20,000,000€ borxhi për garancitë shtetërore. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së një procesi efektiv rreth raportimit të borxhit publik në RVF. Mos prezantimi i borxhit publik ndikon në proceset e informimit dhe vendimmarrjes nga Kuvendi i Kosovës dhe kreditorët e jashtëm; dhe
- Llogaritë e arkëtueshme për të dy (2) nivelet e qeverisjes (qendrore dhe lokale) janë prezantuar në shumën prej 515,990,050€, kurse sipas raporteve individuale të auditimit vlera totale e tyre është 548,963,060€. Ky fakt paraqet një nënvlerësim të këtyre llogarive për 32,973,010€. Si shkak i kësaj ishte mungesa e një procesi efektiv të raportimit dhe të konsolidimit. Prezantimi jo i plotë dhe jo i saktë i llogarive të arkëtueshme mund të ketë efekte në proceset e vendimmarrjes në lidhje me ndarjet vjetore të buxhetit.

¹ MASHT, MMPH dhe SHSKUK.

² MSH, MKK dhe KRPP.

1.2 Qasja e auditimit

Qëllimi ynë është që të marrim siguri të arsyeshme nëse Raporti Financiar Vjetor në tërësi nuk përmban keq deklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq deklarim material që mund të ekzistoj. Keq deklarimet konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtij RFV/BRK.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq deklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe cilësinë e informatave në pasqyrat financiare.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, pasqyrën e konsoliduar të krahasimit të buxhetit me ekzekutimin, pasqyrën e konsoliduar të pasurive në para të gatshme, bilancin e fondit dhe shënimet shpjeguese;
- Nëse këto pasqyra financiare paraqesin, në të gjitha aspektet materiale, një pamje të drejtë dhe të vërtetë të gjendjes financiare për periudhën e auditimit; dhe
- Nëse janë ndërmarr masat e duhura nga Qeveria për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015 dhe vitet e mëhershme.

ZKA gjithashtu ka marrë në konsideratë deklaratën e bërë nga Ministri i Financave dhe Drejtori i Thesarit, me rastin e dorëzimit të RFV/BRK-së në Kuvend dhe tek Auditori i Përgjithshëm.

Qasja jonë është bazuar në procesin sipas të cilit RFV/BRK-së është hartuar. Kjo ka mundësuar zhvillimin e strategjisë së auditimit, e cila përqendrohet në adresimin e rreziqeve specifike. ZKA ka rishikuar pajtueshmërinë me kufirin e deficitit buxhetor, analizën e RFV/BRK-së si dhe pasqyrat individuale të organizatave buxhetore, duke përfshirë konsolidimin e llogarive.

1.3 Deklarata mbi kufirin e deficitit buxhetor

Neni 22.A.1, i Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) nr. 03/L-048 (me plotësime dhe ndryshime), përcakton se “Asnjë Ligj për ndarjet buxhetore nuk duhet të përfshij një deficit të përgjithshëm që kalon nivelin prej 2% të Bruto Produktit Vendor (BPV) të parashikuar”. BPV i parashikuar për vitin 2016 ishte 6,039,000,000€.

Me qëllim të mbajtjes së borxhit total nën kufirin e borxhit të përcaktuar në Ligjin për Borxhin Publik, për çdo vit të pestë fiskal, Kuvendi shqyrton dhe sipas nevojës mund të bëjë përshtatje me kufirin e deficitit në përputhje me kufirin e borxhit dhe me rritjen afatmesme të BPV-së dhe procedurat e zbatimit dhe parametrat kyç që shërbejnë si bazë për kufirin e deficitit.

Ne kemi vlerësuar proceset në kuadër të MF-së, për të siguruar se këto kërkesa ligjore janë zbatuar dhe kemi vlerësuar kufirin aktual në fund të vitit 2016.

Ligji i Buxhetit për vitin 2016 i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës është aprovuar me një deficit buxhetore prej 1.3% të BPV-së, përderisa deficitit aktual në fund të vitit 2016 ishte 0.9%. Konkluzioni është se Qeveria ka zbatuar kërkesat ligjore lidhur me deficitet buxhetore.

Mos prezantimi i shënimeve sqaruese në RFV të BRK-së në lidhje me zvogëlimin e kufirit të deficitit buxhetor në vitin 2016 në raport me vitin 2015

Në vitin 2016 ka një ulje të kufirit të deficitit buxhetor në raport me vitin 2015. Sipas Ligjit të Buxhetit shpenzimet ishin planifikuar që të jenë më të larta se të hyrat për 95,439,000 apo 1.6% e BPV të planifikuar, ndërsa shpenzimet e ndodhura apo aktuale ishin me të larta se të hyrat për 53,872,000€ apo 0.9% e BPV të planifikuar.

Në vitin 2015, sipas buxhetit ishte parashikuar që shpenzimet të jenë më të larta se të hyrat për 118,689,000€ ose me një deficit prej 2% e BPV-së, ndërsa sipas realizimit shpenzimet ishin më të larta se të hyrat për 77,586,000€, ose me një deficit prej 1,3% e BPV-së.

RFV/BRK-së nuk përmban shënime shpjeguese dhe informata të hollësishme për arsyen e rënies së shkallës së deficitit buxhetor në krahasim me vitin 2015.

1.4 Analiza e Buxhetit të Republikës së Kosovës

Të dhënat e prezantuara në RFV/BRK janë reflektim i pranimeve dhe pagesave reale dhe ndarjeve buxhetore përkatëse. Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2016 i është nënshtruar rishikimit buxhetor (Ligji nr. 05/L-109 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.05/L-071), ku kishte ndryshime buxhetore edhe ndërmjet kategorive ekonomike në kuadër të OB-ve.

1.4.1 Analiza e pasqyrave themelore

Treguesit e konsoliduar fiskal të Buxhetit Shtetëror për vitin 2016 janë si vijon:

- **Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit për vitin 2016** – Janë realizuar në shumën prej 1,777,908,000€, nga 1,978,414,000€ të planifikuara ose 90%, me një diferencë prej 200,506,000€. Krahasuar me realizimin e vitit 2015, pranimet janë rritur për 70,534,000€ apo 4%. Rritja e pranimeve në vitin 2016 ishte rezultat i arkëtimit më të lartë të të hyrave tatimore direkte dhe indirekte; dhe
- **Realizimi i shpenzimeve të përgjithshme buxhetore për vitin 2016** – Shpenzimet e përgjithshme për vitin 2016, ishin 1,763,242,000€ nga 1,863,753,000€ të planifikuara ose 94.5%, me një diferencë prej 100,511,000€. Krahasuar me realizimin e shpenzimeve për vitin 2015, këtë vit shpenzimet ishin më të larta për 148,904,000€.

Tabela në vijim prezanton një pasqyrë të pranimeve dhe pagesave të përgjithshme krahasuar me planifikimin:

Tabela 2. Buxheti fillestar dhe realizimi i pranimeve në raport me pagesat (në 000 €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	Realizimi 2016	Realizimi 2015	Realizimi 2014
Pranimet	1,861,909	1,978,414	1,777,908	1,707,374	1,462,578
Pagesat	1,773,032	1,863,753	1,763,242	1,614,338	1,510,857

Realizimi i të ardhurave të buxhetit të vitit 2016

Gjatë vitit 2016, në buxhetin shtetëror janë inkasuar të ardhura prej 1,777,908,000€, me një rritje prej 4.1% krahasuar me vitin 2015. Kjo përqindje është ndikuar kryesisht nga rritja e të hyrave tatimore (tatimet direkte dhe indirekte).

Ndikim negativ në mos realizimin e planit në arkëtimin e të hyrave të përgjithshme ka pasur niveli i ulët i arkëtimit të të hyrave vetjake të komunave, financimi nga huamarrja e jashtme, të hyrat e njëhershme të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP-së), dhe të hyrat nga dividendat.

Të hyrat e përgjithshme të buxhetit, sipas zërave paraqiten si në vijim:

Tabela 3. Buxheti fillestar dhe realizimi i pranimeve në raport me pagesat (në 000 €)

Pranimet	Buxheti final	Realizimi 2016	Realizimi 2015	Realizimi 2014
Tatimet direkte	227,289	232,121	199,454	189,904
Tatimet indirekte	1,207,759	1,227,392	1,104,923	1,005,180
Të hyrat jo tatimore	211,800	175,343	188,086	171,253
Kthimet	-42,850	-38,381	-35,644	-33,516
Financimi nga huamarrja	309,459	154,412	166,719	113,836
Grantet dhe ndihmat	12,887	8,735	13,310	12,092
Pranimet tjera	52,070	18,286	70,526	3,829
Totali	1,978,414	1,777,908	1,707,374	1,462,578

Sipas tabelës më sipër, të ardhurat e përgjithshme përbëhen:

- 13% nga tatimet direkte;
- 69% nga tatimet indirekte;
- 9% nga të hyrat jo tatimore; dhe
- 9% nga financimi me huamarrje, grantet/ndihmat dhe pranimet tjera.

Kundrejt buxhetit final, realizimi i të hyrave tatimore ka rezultuar si në vijim:

- Të hyrat tatimore direkte dhe indirekte kanë një rëndësi kritike për arkën shtetërore dhe përbëjnë mbi 80% të të hyrave të tërësishme buxhetore. Këto të hyra tatimore realizohen përmes Doganës së Kosovës (DK) dhe Administratës Tatimore të Kosovës (ATK). Këto dy (2) agjenci në vitin 2016 kanë shënuar performancë të mirë sa i përket përmbushjes së planit në realizimin e të hyrave;
- Të hyrat nga tatimet direkte dhe indirekte janë realizuar në shumë prej 1,459,513,000€ nga 1,435,048,000€ të planifikuara, me një tejkalim të planit për 24,465,000€; dhe
- Të hyrat tatimore në vitin 2016, kundrejt realizimit të vitit 2015, kanë shënuar rritje prej 155,136,000€ apo 11.9%.

Realizimi i të hyrave nga Dogana e Kosovës

DK gjatë vitit 2016, kishte realizuar të hyra në shumën prej 1,051,419,000€ apo për 99,611,000€ (10.5%) më tepër se në vitin 2015. Rritje më të madhe ka pasur tek grumbullimi i TVSH-së në kufi në vlerë prej 57,943,000€ apo 13%, dhe akciza në kufi prej 41,046,000€ apo 12%.

Realizimi i të hyrave nga Administrata Tatimore e Kosovës

ATK gjatë vitit 2016 ka realizuar të hyra 386,385,187€ e që në krahasim me vitin 2015 ka një rritje për 53,613,187€ apo 16%. Rritje më të madhe është shënuar tek tatimi në korporata në vlerë prej 13,385,211€ apo 20%, TVSH-ja me 25,209,755€ apo 16%, tatimi në paga 8,237,957€ apo 11.4%, tatimi nga bizneset individuale me 2,402,732€ apo 7.8% dhe në burime apo tatimet tjera ka një rritje prej 4,377,532€.

Ngritja e përgjithshme në shkallën e inkasimeve në Doganë dhe ATK, vjen si rezultat i aktivitetit të shtuar ekonomik në vend, masat e reja në politikat tatimore, reformat e ndërmarra nga agjencitë e të hyrave, lirimet për lëndët e para dhe makineritë në import, fillimi i zbatimit të përshkallëzuar të TVSH-së dhe efekti i Ligjit për faljen e borxheve.

Realizimi i të hyrave jo tatimore

Të hyrat jo tatimore për vitin 2016, janë planifikuar në shumën prej 212,000,000€, ndërsa realizimi i tyre ishte 175,343,000€, me një diferencë prej 36,657,000€, apo 17% më pak se plani. Në këtë ka ndikuar mos realizimi në disa zëra si të hyrat nga taksat, ngarkesat në nivel lokal, si dhe mos arkëtimi i dividendës nga Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK) në shumën e paraparë prej 15,000,000€.

Deklarimi i dividendës nga PTK përgjatë viteve ka shënuar rënie. Sipas Departamentit për Politika Makroekonomike si dhe bazuar në pasqyrat financiare të PTK-së, vërehet një rënie e konsideruar e fitimit dhe si rezultat edhe i deklarimit të dividendës.

Në nivel të OB-ve të qeverisjes lokale, performancë jo të mirë në realizimin e planit kishin shënuar; Komuna e Prishtinës 19% më pak kundrejt planit ose 24,243,686€ të realizuara nga 29,950,000€ të planifikuara, dhe Komuna Prizrenit kishte një realizim më të ulët për 34% kundrejt planit ose 6,292,849€ të realizuara kundrejt 9,480,000€ të planifikuara.

Të hyrat e njehershme nga Agjencia Kosovare e Privatizimit

Të hyrat e njehershme të AKP-së në vlerë prej 33,000,000€ nuk janë realizuar fare. Një nga arsyet e mos realizimit të këtyre të hyrave, sipas Departamentit për Politika Makroekonomike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar, janë vonesat e trajtimit të kërkesave apo ankesave potenciale nga ana e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme e cila funksion kryesor të saj ka çështjet që lidhen me procesin e privatizimit.

Borxhi Publik/ Financimi nga huamarrja

Sipas Ligjit për borxhet publike, borxhi i përgjithshëm përkufizohet si "tërësia e borxhit shtetëror dhe borxhit komunal. Borxhi shtetëror është borxh që merret në emër të Institucioneve Qendrore Qeveritare të cilën Republika e Kosovës është e obliguar ta paguajë, por nuk përfshinë asnjë detyrim të entiteteve tjera të caktuara qeveritare, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në Komuna, ndërmarrje publike, apo Bankën Qendrore të Kosovës".

Qëllimi i borxhit publik është financimi i deficitit buxhetor shtetëror, atëherë kur sipas gjykimit (vlerësimit) të Ministrit shpenzimet e autorizuara me ligj, tejkalojnë apo ka mundësi të tejkalojnë, të hyrat e nevojshme për t'i paguar ato. Qëllim tjetër i borxhit publik është edhe financimi i projekteve investuese të cilat vlerësohen të jenë synim kombëtar.

Andaj, rëndësia e borxhit shtetëror ka ndikime në rritjen e aktiviteteve ekonomike, vëllimin e prodhimit, krijimin e vendeve të reja të punës, rritjen e BPV-së si dhe përmirësimin e parametrave makroekonomik.

Portofoli i borxhit shtetëror është krijuar në vitin 2009 dhe deri në fund të vitit 2016 përbëhet nga borxhi i brendshëm dhe borxhi i jashtëm, si dhe dy (2) garanci shtetërore. Në fund të vitit 2016, borxhi i përgjithshëm është 852,738,034€ (nëse e krahasojmë me shumën nominale të vitit paraprak është rritur për 14%), i cili përbëhet nga borxhi ndërkombëtar 373,767,447€ dhe borxhi i brendshëm 478,970,587€.

Në vitin 2014, është emetuar garancia e parë shtetërore në shumën prej 10,000,000€ me të cilën garanton Fondi i Sigurimit të Depozitave për linjën kreditore të ofruar nga BERZh. Ndërsa, garancinë e dytë ndërkombëtare, të cilën Kosova e ka emetuar gjatë vitit 2016, e garanton ndërmarrjen publike lokale Trafiku Urban për kredinë e ofruar nga BERZH në vlerën 10,000,000€.

Me Ligjin e Buxhetit për vitin 2016, të hyrat nga huamarrja (borxhi) janë planifikuar 309,459,000€ nga të cilat janë realizuar 154,194,000€ ose 49.8%³.

Borxhi i brendshëm – Financimi nga huamarrja (borxhi) i brendshëm për vitin 2016 ishte 101,189,000€ kundrejt 100,000,000€ të planifikuara. Qëllimi i huamarrjes së brendshme ishte financimi i deficitit buxhetor, si dhe rritja e bilancit bankar.

Rritja e bilancit bankar është kërkesë e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) e cila deri në fund të vitit 2016 planifikohet të jetë e barabartë më 4.5% të vlerës së BPV. Gjatë vitit 2016 bilanci bankar është rritur për 14,666,000€ duke arritur në 256,539,000€ dhe është 4.2% e BPV-së.

Shkallë e ulët e realizmit të planit të financimit nga borxhi (huamarrja) ndërkombëtar

Qëllimi i huamarrjes ndërkombëtare është financimi i projekteve të caktuara. Sipas Ligjit nr. 03/L-175 për borxhin publik, Qeveria do të lëshojë një Vendim përmes të cilit autorizohet Ministri që të nënshkruaj marrëveshje lidhur me Borxhet Ndërkombëtare.

Huazimet nga IFN-të janë të lidhura me progresin e projekteve të cilat financohen nga marrëveshjet respektive.

Arsyeja kryesore e ngecjes së huazimeve nga IFN-të është mos zbatimi i projekteve në përputhje me parashikimin buxhetor, e kjo si pasojë e vonesave në ratifikim të marrëveshjeve financiare, negocimit të vonuar të marrëveshjeve financiare, si dhe arsytet tjera që ndërlidhen me zbatuesit e projekteve.

³ Sipas shpjegimeve të Thesarit, nënhuazimet nuk kalojnë përmes Llogarisë së Buxhetit, por ndikojnë në rritjen e stokut të borxhit.

Ministri i Financave-së në vitin 2016 ka miratuar rregulloren Nr. 01/2016 për administrimin e fondeve të huamarrjes. Buxhetimi dhe alokimi i fondeve prej huamarrjes bëhet sipas ndarjeve buxhetore në ligjin vjetore të BRK-së.

Gjatë vitit 2016 gjithsej janë arritur gjashtë (6) marrëveshje me IFN të cilat ishin të aprovuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Këto marrëveshje kanë të bëjnë me projekte në sektorët e arsimit, shëndetësisë infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore.

Qëllimi i këtyre projekteve është: Rehabilitimi i Rrugës Hekurudhore 10 (kredi e nën-huazuar), Projekti për Përmirësimin e Sistemit të Arsimit, Projekti i Rrugëve Rajonale, Modernizimi i Shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën e Klinikës Universitare të Kosovës dhe Projekti për Masat e Energjisë Efiçiente në Ndërtesat Publike nëpër Komuna.

Niveli i ulët i realizimit të financimit nga huamarrja ndërkombëtare ishte si pasojë e mos disbursimit të transfereve nga FMN-ja si dhe mos zbatimit të projekteve të caktuara nga OB-të. Ngecjet janë shënuar në zbatimin e disa projekteve krahasuar me parashikimin buxhetor në Ministrinë e Infrastrukturës, Zhvillimit Ekonomik dhe Shëndetësisë.

Arsyeja e mos disbursimit të transfereve sipas parashikimit buxhetor 2016 nga programi Stand-By Arrangement (SBA) me FMN-në është se rishikimi i aktiviteteve dy (2) dhe tre (3) që zhvillohet nga FMN-ja për arritjet e aktiviteteve para disbursimit është shtyrë për vitin pasues. Kjo shtyrje ka ardhur si pasojë e aprovimit me vonesë i ligjit për veteranët nga ana e Qeverisë, (është aprovuar më 30 dhjetor 2016), e që ka rezultuar në mos rishikimin e aktiviteteve dy (2) dhe tre (3) nga FMN.

Mos realizmi i projekteve me financim nga huamarrja ndërkombëtare në nivel të ministrive

ZKA ka trajtuar arsyet e mos realizimit të disa prej projekteve të planifikuara:

- Për “Projektin Efiçencë për energji dhe energjia e ripërtëritshme” në kuadër të MZHE, i planifikuar të financohet nga BB me vlerë prej 4,060,000€ nuk janë ndarë fondet për të. Arsyet e mos disbursimit të fondeve sipas parashikimit me buxhetin e vitit 2016, janë vonesat në finalizimin e procedurave të prokurimit. Duke qenë e pakënaqur me procedurat e prokurimit të kryera nga ministria, BB ka vendosur të mos financojë këtë projekt (për pesë ndërtesat e para për rinovim);
- Projekti “Zgjerimi i rrugës kryesore N2 “Milloshevë - Mitrovicë” në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës, i planifikuar të financohet në vlerë prej 14,700,000€, ka ngecje disa mujore vetëm për procesin e bartjes së mjeteve financiare. Fillimisht vonesat (shtatë mujore) janë shkaktuar në formimin e Njesisë për Menaxhimin e Projektit (NJMP), e cila do të jetë pika kryesore e komunikimit ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës, financuesve, konsulentëve dhe kontraktorëve. Pas formimit të NJMP-së, Banka Islamike ka shprehur gatishmërinë që paraprakisht të transferoj mjete financiare të mjaftueshme për gjashtë (6) muaj për NJMP në një llogari të veçantë e cila duhet të hapet në një bankë komerciale ose në Bankë Qendrore. Por, një kërkesë e tillë është refuzuar nga Thesari për hapjen e një llogarie, duke u mbështetur në Ligjin për Financa Publike. Më 23 dhjetor 2016 është hapur një nën - llogari për bartjen e mjeteve financiare për NJMP; dhe

- Projektet në Ministrinë e Shëndetësisë “Aparatura dhe pajisje tjera mjekësore” me buxhet të planifikuar në vlerë 2,600,000€, dhe me realizim në vlerë 2,110,000€ duke u financuar nga Qeveria Austriake, si dhe projekti “Rishikimi i Sektorit Shëndetësor Kosovare” huamarrja nga Banka Botërore, me buxhet të planifikuar në vlerë 1,771,105€, dhe me realizim në vlerë 1,328,825€ apo 75%. Arsytet e disbursimit të mjeteve me vonesë ishin mos themelimi i linjës së veçantë buxhetore për grantin specifik për shëndetësi si dhe mos funksionalizimi i sistemit të informimit shëndetësor dhe sistemit të informimit shëndetësor të fondit të sigurimeve shëndetësore.

Analiza e Pagesave në para të gatshme

Shpenzimet e përgjithshme për vitin 2016, ishin 1,763,242,000€ nga 1,864,413,000€ të planifikuara sipas buxhetit final ose 94.5%. Niveli i shpenzimeve një vit më parë ishte 1,614,338,000€ apo 9% më pak se në vitin 2016.

Trendi i realizimit të shpenzimeve buxhetore në tri (3) vite të fundit, rezulton si më poshtë:

Tabela 4. Buxheti final dhe realizimi për 2016

(në 000 €)

Përshkrimi	Buxheti SIMFK	Realizimi 2016	Realizimi 2015	Realizimi 2014
Paga dhe mëditje	551,521	544,830	526,311	486,691
Mallra dhe shërbime	192,602	179,897	184,828	188,033
Komunali	24,656	23,362	24,166	22,100
Subvencione dhe transfere	477,620	475,103	422,099	364,526
Investime Kapitale	527,741	452,299	407,926	412,920
Pagesat tjera	90,273	87,751	49,008	36,587
Totali	1,864,413	1,763,242	1,614,338	1,510,857

Nga tabela e mësipërme shihet se ndikimin më të madh në mosrealizimin e shpenzimeve në vlerë prej 101,171,000€, e kanë pasur investimet kapitale 75,443,000 €, apo 75% nga totali.

Çështjet kryesore të dala nga auditimet e kryera janë si në vijim:

Shpenzimet për paga dhe mëditje – janë realizuar në masën 99%, pra në vlerë 544,830,000€ kundrejt 551,521,000€ të planifikuara. Gjatë vitit 2016 janë realizuar 18,519,000€ apo 3.4% më shumë për paga dhe mëditje, krahasuar me vitin 2015. Ndër faktorët kryesor që kanë ndikuar në rritjen e këtyre shpenzimeve janë vendimet e Qeverisë për pagesën e përvojës së punës për punëtorët e sektorit publik, dhe rritja e numrit të punësuarve në të dy (2) nivelet e qeverisjes, qendrore dhe lokale, prej 710 punonjësve.

Te OB-të e nivelit qendror vazhdojnë të përsëriten sfidat buxhetore nga viti ne vit, siç janë: mbulimi i pozitive me ushtrues detyre, lidhja e kontratave për shërbime të veçanta pa procedura të rekrutimit dhe në kohëzgjatje mbi gjashtë (6) muaj, kompensimet për punë jashtë orarit në kundërshtim me bazën ligjore etj.

Shpenzimet për Mallra dhe Shërbime – janë realizuar në shumën prej 179,898,000€ kundrejt 192,602,000€ të planifikuara, përkatësisht 93%.

OB-të e nivelit qendror edhe më tutje sfidohen nga parregullsi të njëjta, siç janë: vonesa në mbylljen e avanseve, pagesa e avanseve në kundërshtim me Ligjin e Buxhetit, keq klasifikim të shpenzimeve sipas kategorive, kompensimet në formë të dhuratave dhe për punë shtesë brenda orarit të rregullt të punës nga kategoria mallra dhe shërbime, hyrja në obligime pa zotim të mjeteve, si dhe furnizime me artikuj jashtë kontratave, dhe anashkalim të procedurave të prokurimit.

Parregullsitë e evidentuara nga auditimet e kryera në komuna janë: hyrja në obligime pa zotime të mjaftueshëm të mjeteve, mungesë caktimit të menaxherëve të kontratës, furnizime me artikuj jashtë kontratave dhe anashkalim të procedurave të prokurimit, si dhe mos ndalja e tatimit në burim për punëtorët e angazhuar me kontratat për shërbime të veçanta sipas Ligjit Nr. 05-L-028.

Shpenzimet për Subvencione dhe Transfere – janë realizuar 475,103,000€ nga 477,620,000€ të planifikuara, ose në masën prej 99%. Gjatë vitit 2016 janë realizuar 53,000,000€ më shumë se në vitin 2015. Një ndër faktorët që kanë ndikuar në rritjen e këtyre shpenzimeve është rritja e pagesave për pensionet e veteranëve të luftës, pensionet bazë kontributdhënëse si dhe pensionet për skema pensionale.

Menaxhimi i subvencioneve ende mbetet sfidë për të dy (2) nivelet e qeverisjes. Praktika aktuale e vlerësimit, monitorimit dhe raportimit të subvencioneve nuk ofron siguri të mjaftueshme se ato shfrytëzohen për qëllimet e dedikuara dhe nëse janë arritur rezultatet e pritura.

Për më tepër, auditimet e kryera kanë nxjerrë në pah këto mangësi: mungesa e politikave të shkruara apo kornizës ligjore për dhënien dhe monitorimin e projekteve të subvencionuara, mosrespektimi i kriterëve të vendosura për subvencionim me rastin e ndarjes së subvencioneve si dhe mos raportimi nga ana e përfituesve të subvencioneve për mënyrën e shfrytëzimit të këtyre mjeteve.

Shpenzimet për investimet kapitale

Investimet kapitale përfshijnë fondet e planifikuara për investime publike për OB të nivelit qendror dhe lokal, me financim nga të ardhurat e buxhetit të shtetit ose nëpërmjet huamarrjes së jashtme, por edhe nga grantet e përcaktuara të donatorëve. Gjatë vitit 2016 shpenzimet për investime kapitale janë 452,299,000€ nga 527,741,000€ të buxhetuara, apo në nivelin prej 86%.

Nga auditimet e kryera për kategorinë e investimeve kapitale në të dy (2) nivelet e qeverisjes, qendrore dhe lokale, ne kemi identifikuar këto mangësi:

- Te OB-të e qeverisjes qendrore – nga 380,220,237€ të planifikuara, janë shpenzuar 341,454,391€ apo 89%. Çështjet e identifikuar kanë të bëjnë me zhvillimin e procedurave të prokurimit jo në pajtueshmëri me kornizën ligjore, duke arritur marrëveshje me operatorët ekonomik të papërgjegjshëm dhe mbikëqyrje jo efikase me rastin e realizimit të projekteve; dhe
- Te OB-të e qeverisjes lokale – Në nivelin lokal, buxheti për investime kapitale ishte 147,521,438, ndërsa realizimi ishte 110,844,257 apo 75%. Në strukturën totale të këtyre shpenzimeve, janë përfshirë edhe të hyrat vetjake, ku nga gjithsej 78,586,598€ të planifikuara, janë shpenzuar 47,010,724€ apo 60%. Në këtë shkallë të ulët të realizimit kanë ndikuar dy (2) komuna; përkatësisht komuna e Prishtinës me një realizim prej 58%, ku nga 33,902,694€ të planifikuara, janë shpenzuar 19,750,828€; dhe komuna e Prizrenit me një realizim prej 54% apo 4,838,877€ nga 8,889,745€ të shumës së buxhetuar.

Dobësi tjera të identifikuar janë: mungesa e projekteve të detajuara, vonesa në kryerjen e punëve dhe procedurave të prokurimit, shpërblimi i operatorëve ekonomik të papërgjegjshëm, monitorim dhe mbikëqyrje e dobët, dhe performancë jo efikase në realizimin e projekteve.

Shpenzimet për investime kapitale me financim nga huamarrja e jashtme

Shpenzimet kapitale nga huamarrja e jashtme janë ekzekutuar në shumën prej 5,701,731€ nga 24,675,984€ të planifikuara, ose 23%.

Trajtim më i hollësishëm në lidhje me mos realizimin e projekteve me financim nga huamarrja e jashtme, është dhënë tek borxhi publik brenda këtij kapitulli.

Shkallë e ulët e realizimit të buxhetit nga Donatorët

Grantet e Përcaktuara të Donatorëve (GPD) janë fonde të cilat duhet të shfrytëzohen në pajtim me kushtet e marrëveshjeve dhe qëllimin e përcaktuar. Gjatë vitit 2016, GPD janë realizuar 57% kundrejt planifikimit ose 11,450,000€ nga 20,090,803€ të planifikuara.

Pjesa më e madhe e këtyre fondeve janë dedikuar dhe shfrytëzuar për investime kapitale, mallra dhe shërbime, subvencione dhe transfere, dhe paga.

Bartja e mjeteve të pashfrytëzuara nga viti në vit, tregon se këto fonde nuk po menaxhohen në mënyrë efikase. Kjo rrit rrezikun që grantet nga donatorët në të ardhmen mund të zvogëlohen për shkak të menaxhimit jo efektiv dhe mos arritjes së qëllimeve të synuara.

1.4.2 Analiza e shpalosjeve/shënimeve

Qeveria dhe OB-të kanë nën kontroll dhe menaxhojnë me fonde publike, si dhe i përdorin këto burime për të arritur objektivat e realizimit të shërbimeve. Megjithatë, Qeveria do të duhej të mbajë evidenca dhe të ketë informata të hollësishme lidhur me fondet publike të cilat i menaxhon.

BSNKS inkurajon fuqimisht që t'i përmbahemi shpalosjes së informatave shtesë, aty ku është e mundshme, në mënyrë që të ngritet transparenca dhe përgjegjësia financiare. Shpalosja e informatave të përshtatshme në RFV të BRK-se në lidhje me aktivitetet e përgjithshme të Qeverisë, mund të rris transparençën e raporteve financiare dhe të ofroj mundësi për kuptim më të mirë të relacionit ndërmjet aktiviteteve qeveritare dhe palëve te interesit.

Shpalosjet apo anekset në RFV të BRK-së duhet të përmbajnë shënime apo të dhëna të plota për rritjen dhe zvogëlimin e borxhit publik, pagesat e anëtarësimit në IFN, të hyrat, shpenzimet, pasuritë dhe detyrimet e shtetit në mënyrë që përdoruesit e RFV-ve të BRK-së t'i kuptojnë më mirë fushat e raportuara, përkatësisht trendet vjetore të buxhetit.

Mos shpalosja e borxhit publik dhe e pagesave me rastin e anëtarësimit të Republikës së Kosovës në IFN

Shënimet shpjeguese nuk përmbajnë informata për stokun e borxhit të brendshëm (borxhi sipas instrumenteve financiare dhe mbajtësit e letrave me vlerë); stokun e borxhit ndërkombëtar (borxhi sipas kreditorëve, informata për marrëveshjet financiare të arritura); garancitë shtetërore dhe informata për pagesat e bëra me rastin e anëtarësimit të Republikës së Kosovës në IFN.

Shënimet shpjeguese përmbajnë vetëm sqarime në lidhje me pagesat për kthimin e kryegjësë dhe interesit, në shumën prej 65,992,000€, përkatësisht 19,206,000€.

Në tabelën më poshtë është prezantuar gjendja e borxhit publik në tri vitet e fundit:

Tabela 5. Gjendja e borxhit publik

(në 000 €)

Përshkrimi	Viti 2016	Viti 2015	Viti 2014
Borxhi ndërkombëtar	373,760	371,170	326,350
Niveli qendror	323,930	339,870	316,540
Nën huazimet	49,830	31,300	9,810
Borxhi i brendshëm	478,970	377,780	256,520
Niveli qendror	478,970	377,780	256,520
Gjithsej borxhi i përgjithshëm	852,730	748,950	582,870
Garancitë shtetërore	20,000	10,000	10,000
Gjithsej borxhi i përgjithshëm (% e BPV-së)	14,58%	13,07%	10,65%

Nga tabela shihet se borxhi publik, përfshirë edhe garancitë shtetërore, në fund të vitit 2016 arrin shumën 872,730,000€, dhe në krahasim me vitin 2015 ka pasur rritje për 113,780,000€ apo 15%.

Pasuritë

Edhe gjatë këtij viti kontrollet vazhdojnë të jenë jo mjaft efektive në menaxhimin e pasurisë (kapitale dhe jo kapitale). Kjo është trajtuar si theksim i çështjes në seksionin e opinionit në këtë kapitull.

Pasuritë e institucioneve qendrore – Vlera neto e pasurive të prezantuara në RFV/BRK-së është 2,413,988,556€, ndërsa sipas auditimeve vlera e tyre është 2,405,092,643€. Ky mos barazim prej 8,895,913€ është si rezultat i mbivlerësimeve prej 13,837,933€ dhe nënvlerësimeve prej 4,942,020€.

Disa nga çështjet më të shpeshta të cilat janë hasur gjatë auditimeve të Institucioneve Qendrore (IQ) dhe të cilat kanë ndikuar në shfaqjen e këtyre diferencave janë: mungesa e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë që pamundëson IQ-të të kenë informata të sakta rreth pasurive, mos mbajtja e rregullt e regjistrave të pasurisë, regjistrimi i gabuar i blerjeve të reja dhe kalkulimi i gabuar apo mos kalkulimi i zhvlerësimit, kalkulimi i zhvlerësimit për investimet në vijim si pasojë e regjistrimit të gabuar të tyre si pasuri në përdorim etj.

Pronat bujqësore në shfrytëzim nga personat privat – Pronat (tokat) bujqësore në vlerë prej 8,378,478€ në pronësi të Institutit Bujqësor të Kosovës që është në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), shfrytëzohen nga personat privat. MBPZHR ka nisur procedurat gjyqësore për kthimin e pronave në shfrytëzim të saj.

Pasuritë e komunave – vlera neto e pasurive të prezantuara në RFV/BRK-së është 5,664,322,481€, dhe paraqet një rritje krahasuar me vitin 2015. Kjo rritje është rezultat i regjistrimit shtesë të pasurisë së komunës së Prishtinës në vlerë prej 2,468,469,000€ në regjistrin kontabël, pasuri e cila nuk ka qenë e regjistruar në vitet e mëparshme.

Edhe gjatë vitit 2016 komunat nuk kanë arritur të sigurojnë një sistem efektiv për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive, duke rezultuar me theksim të çështjes për pasuri pothuajse në të gjitha komunat.

Për më tepër, komunat Mamushë, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq nuk kanë prezantuar asnjë pasuri qoftë ato mbi apo nën 1,000€, ndërsa komunat Novobërdë, Ferizaj, Patesh dhe Kllokot, nuk kanë prezantuar pasuritë me vlerë nën 1,000€.

Mangësi tjera të evidentuara janë: numërimi fizik dhe vlerësimi i pasurisë, raportet jo të përfunduara të inventarizimit të pasurisë, kategorizimi jo adekuat i pasurisë, zhvlerësimi, tjetërsimi dhe klasifikimi jo i drejtë i investimeve të pa përfunduara.

Obligimet e papaguara

Shuma e obligimeve të papaguara në fund të vitit 2016 është 215,682,000€, një shumë e rritur për 8,420,000€ krahasuar me vitin 2015. Rritje të obligimeve ka vetëm tek organizatat e nivelit qendror. Tabela në vijim prezanton obligimet e papaguara të ndara sipas nivelit të qeverisjes dhe të krahasuara ndër vite.

Tabela 6 Obligimet e papaguara

(në 000 €)

Përshkrimi	2016	2015	2014
Niveli Qendror	200,275	191,816	148,199
Niveli Lokal	15,407	15,445	17,188
Gjithsej	215,682	207,261	165,387

Rreth 93% e totalit të obligimeve i takon nivelit qendror, nga të cilat 83% kanë të bëjnë me:

- Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor, obligimet e së cilës arrijnë vlerën 152,899,219€, që kryesisht kanë të bëjnë me procesin e shpronësimit;
- Ministrinë e Infrastrukturës, obligimet e së cilës janë 15,535,336€ që kryesisht iu përkasin kategorisë së investimeve kapitale (vetëm 246,316€ u takojnë kategorive subvencione dhe mallra dhe shërbime); dhe
- Ministrinë e Bujqësisë, që ka obligime 12,903,046€ nga të cilat 12,870,485€ janë obligime për subvencione dhe grante që janë krijuar si rezultat i mënyrës dhe kohës së aprovimit të tyre.

Obligimet e papaguara (përveç atyre nga shpronësimet) janë rezultat i hyrjes në obligime kontraktuale në mungesë të mjeteve të mjaftueshme për financimin e tyre, si dhe pranimit dhe procesimit të faturave më vonësë⁴.

Për më tepër edhe cilësia e raportimit ishte e dobët. Në raste të caktuara, OB-të nuk i kishin raportuar obligimet e tyre rregullisht në MF, e në disa raste tjera obligimet e raportuara nuk ishin të plota.

Mos pagesa e obligimeve nga OB-të me kohë, ka bërë që një pjesë e konsiderueshme e tyre të paguhen nga Thesari dhe në bazë të vendimeve gjyqësore (shih nënkapitullin më poshtë pagesat drejtpërdrejtë nga Thesari dhe nga vendimet e Gjykatave). Vonesat në pagesat e obligimeve shkaktojnë efekte negative në menaxhimin e buxhetit, duke ngarkuar buxhetet e vitit vijues dhe pamundësojnë arritjen e objektivave të planifikuara.

⁴ Kjo është nxjerrë nga analiza e obligimeve në raport me buxhetin në gjashtë (6) OB-të të cilat kanë obligimet më të larta.

Shpalosja jo e plotë dhe e saktë e llogarive të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme, në fund të vitit 2016, kanë shënuar rënie në krahasim me vitin 2015.

Llogaritë e arkëtueshme të nivelit qendror - vlera e tyre e prezantuar në RFV/BRK-së është 371,241,906€, ndërsa sipas raporteve individuale të auditimit ato kanë vlerën 391,504,642€, një shumë e nënvlerësuar prej 20,262,736€.

Në fund të vitit 2016, totali i llogarive të arkëtueshme është më ulët për 140,332,991€ në krahasim me vitin 2015. Kjo rënie ka ardhur si rezultat i faljes së borxheve nga ana e ATK gjatë vitit 2016, në vlerën prej 188,376,150€.

Gjendja e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit 2016 në ATK dhe Dogana është 321,661,000€, përkatësisht 42,857,266€.

Llogaritë e arkëtueshme të nivelit lokal - vlera e tyre e prezantuar në RFV/BRK-së është 144,748,144€, ndërsa sipas auditimeve individuale 157,458,418€. Krahasimi shpalos diferencën e nënvlerësuar prej 12,710,274€.

Komunat: Mitrovica e Veriut, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku nuk kanë raportuar për llogaritë e arkëtueshme, meqenëse nuk aplikojnë tatimin në pronë dhe tatimet ose ngarkesa tjera të cilat krijojnë të arkëtueshme.

Gjendja e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit 2016 është rritur për 207,547€ në krahasim me vitin 2015.

Pagesat e kryera drejtpërdrejt nga Thesari dhe me vendime të gjykatave

Për vitin 2016, Thesari ka ekzekutuar pagesa sipas nenit⁵ 39.2 dhe 40 në vlerë prej 11,249,089€. Nga kjo shumë, bazuar në Vendime të Gjykatave janë bërë pagesa në vlerë prej 6,352,192€, kurse sipas vendimeve të Thesarit janë paguar 4,905,808€.

⁵ LMFP neni 39 dhe 40 - Neni 39.2 kur një faturë nuk është paguar nga OB-ja për një periudhë më të gjatë se 60 ditë, operatori ka të drejtë të kërkoj ekzekutimin e pagesës drejtpërdrejt nga MF/Thesar. MF/Thesari ka të drejtë të ekzekutoj pagesën drejtpërdrejt në llogari të operatorit ekonomik, sipas kërkesës së tij. Gjithashtu, sipas nenit 40 mund të kryej pagesa sipas vendimeve gjyqësore.

Tabela 7 Pagesat me vendim të gjykatave dhe nenit 39.2 të LMFFP

(në 000 €)

Pagesat me Vendim të Gjykatave	Totali 2016	Totali 2015	Totali 2014
Paga dhe mëditje	117	-	-
Mallra dhe Shërbime	1,949	716	441
Subvencione dhe transfere	404	170	-
Investime Kapitale	3,881	3,515	3,037
Totali	6,352	4,402	3,478
Pagesat sipas Nenit 39.2 të LMFFP			
Mallra dhe Shërbime	666	886	441
Investime Kapitale	4,239	3,515	3,037
Totali	4,905	4,402	3,478

Më poshtë, janë pasqyruar disa prej OB-ve tek të cilat kanë janë ekzekutuar pagesa në vlera më të mëdha, bazuar në vendimet gjyqësore dhe në nenin 39.2 të LMFFP.

- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, 2,579,567€;
- Ministria e Infrastrukturës, 473,772€;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, 473,039€;
- Komuna e Gjakovës, 857,229€;
- Komuna e Ferizajt, 812,388€;
- Komuna e Prizrenit, 678,802€; dhe
- Komuna e Prishtinës, 622,486€.

Shkaqet kryesore të pagesës së faturave drejtpërdrejtë nga Thesari dhe ato me vendim të gjykatave janë:

- Hyrja në obligime pa zotim paraprak të mjeteve;
- Obligime të trashëguara nga qeverisjet e kaluara në nivelin lokal;
- Kontestimi i pagesave nga OB-të për shkak të cilësisë së dobët të punës; dhe
- Neglizhenca dhe papërgjegjësia e zyrtarëve përgjegjës në menaxhimin e faturave.

Mos kryerja e obligimeve me kohë ka shkaktuar procedura gjyqësore të kushtueshme dhe të komplikuar si dhe shpenzime shtesë të buxhetit. Përveç kësaj, këto vonesa kanë ndikime negative në reputacionin e institucioneve publike. Andaj, është më se e nevojshme që MF, së bashku me institucionet tjera përkatëse dhe përgjegjësit e tyre, të sigurojnë se faturat e operatorëve ekonomik evidentohen dhe paguhën në mënyrë të rregullt dhe me kohë.

1.4.3 Opinionet e auditimeve dhe rekomandimet në PVF-të individuale

ZKA ka kryer auditimin e rregullsisë së PFV-ve për 92 OB. Të gjeturat e auditimit për secilën OB reflektohen në opinionin e auditimit të RFV/BRK-së.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur opinionet e dhëna për vitin 2016 të ndara sipas llojit dhe sipas niveleve të qeverisjes.

Tabela 8. Lloji dhe numri i opinioneve për PFV individuale të OB-ve

Entitetet e Audituar	Opinion i pa modifikuar	Opinion i pa modifikuar me Theksim të çështjes	Opinion i Kualifikuar	Opinion i Kualifikuar me Theksim të çështjes	Opinion i Kundërt	Gjithsej
Institucionet Shtetërore	7	14	2	1		24
Komuna	1	32		5		38
Të pavarura	16	12	2			30
Gjithsej	24	58	4	6		92

Në raportet individuale, përveç opinionëve, janë dhënë edhe rekomandimet adekuate për të gjitha gjetjet e auditimit. Pasqyra e rekomandimeve të dhëna sipas subjekteve të audituara përmban të dhënat si më poshtë:

Subjektet e audituara	Rekomandime të prioritetit të lartë	Rekomandime të prioritetit të mesëm	Gjithsej rekomandimet
Institucionet e Nivelit Qendror	179	127	306
Institucionet e Nivelit Lokal	488	162	650
Institucionet e pavarura	130	99	229
Ndërmarrjet publike	55	12	67
Auditime të performancës	62		62
Gjithsej rekomandime:	914	400	1314

Shtojca II ofron shënime të hollësishme për bazat e modifikimit të opinionëve si dhe për rekomandimet kryesore për secilën OB.

Opinionin i kualifikuar është dhënë për katër (4) OB, kurse opinionin i kualifikuar me theksim të çështjes është dhënë për gjashtë (6) sosh. Në kualifikimin e opinionit dhe theksimin e çështjes kanë ndikuar pasuritë kapitale, tejkalimi mbi 15% i kufirit të përcaktuar sipas Ligjit të Buxhetit për pagesat në avanc për investime kapitale, keq klasifikimi i shpenzimeve, nënvlerësimi i llogarive të arkëtueshme, etj.

Opinionin për AKP-në është i kualifikuar për shkak të mbivlerësimit të të hyrave të dedikuara të hyrja e parasë së gatshme në llogarinë e Thesarit, ndërsa për Fondet në Mirëbesim opinionin është kualifikuar për shkak të pagesave për Ofruesin e Shërbimeve Profesionale të cilat janë bërë nga fondet që mbahen në mirëbesim.

1.5 Rekomandimet

Rekomandimet për Qeverinë e Republikës së Kosovës:

- Ministri i Financave në koordinim me Drejtorin e Thesarit të siguroj buxhetimin e shpenzimeve dhe projekteve në kategori ekonomike adekuate;
- Ministri i Financave në koordinim me Drejtorin e Thesarit të siguroj se me rastin e hartimit të RFV/BRK-së, shënimet shpjeguese për pasuritë kapitale, llogaritë e arkëtueshme si dhe konsolidimin e transaksioneve ndërqeveritare të jenë të plota dhe të sakta. Përveç këtyre, të prezantohen informata të hollësishme për: stokun e borxhit të brendshëm dhe ndërkombëtar, gjendjen e borxhit sipas kreditorëve, instrumenteve financiare;
- Ministri i Financave në koordinim me OB-të e qeverisjes lokale të zhvillojë një proces më efikas të monitorimit dhe vlerësimit të trendit në lidhje me realizimin e planit për grumbullimin e të hyrave, të identifikoj shkaqet që kanë ndikuar në mos përmbushjen e planit dhe të ndërmerren veprimet e duhura dhe efikase me qëllim të realizimit të planit;
- Ministria e Financave duhet të siguroj që planifikimi i projekteve kapitale i nënshtrohet kontrolleve për menaxhimin e projekteve në përputhje me planet fillestare. Kontrollat në planifikimin e projekteve dhe realizimin e buxhetit duhet të forcohen për të tejkaluar sfidat e identifikuar me qëllim të arritjes së objektivave brenda afateve kohore. Një harmonizim i rrjedhës së parasë me planifikimin e projekteve është i domosdoshëm, për të adresuar nivelet e ulëta të realizimit financiar të projekteve kapitale;
- Ministria e Financave duhet të shqyrtoj aranzhimet ekzistuese të raportimit financiar për t'iu mundësuar OB-ve ngritje të cilësisë së raportimit financiar. Në këtë aspekt, veprime kyçe duhet të ndërmerren, si: përditësimi i planit kontabël i shoqëruar me udhëzime përkatëse, përditësimi i manualit të kontabilitetit dhe rregullave financiare, me theks të veçantë, hartimi i rregullave për menaxhimin e subvencioneve dhe llogarive të arkëtueshme. Më tej, duhet të siguroj mbajtjen e trajnimeve të rregullta me zyrtarët përgjegjës të përfshirë në raportimin financiar;
- Ministri i Financave duhet të rris llogaridhënien ndaj Organizatave buxhetore të përfshira në realizimin e projekteve të financuara nga huamarrja. Vendimi për huamarrje nga OB-të duhet të merret vetëm pas vendosjes së parakushteve dhe kualifikimit si projekte të dokumentuara mirë dhe të cilat kanë mundësi realizimi. Kjo duhet të bëhet me qëllim të përfitimit të mundësive për zhvillimin e ekonomisë së vendit në aspektin e investimeve publike;
- Ministria e Financave në koordinim me OB-të, duhet të aplikoj një mbikëqyrje nga afër të zbatimit të marrëveshjeve për donacionet e dhëna për organizatat buxhetore, për të siguruar se fondet shfrytëzohen brenda afateve kohore dhe në pajtueshmëri të plotë me marrëveshjet e arritura;
- Ministri i Financave duhet t'i shqyrtoj mekanizmat aktual të ndërlidhur me menaxhimin e pasurisë publike. Bashkëveprimi i dy (2) mekanizmave aktual (SIMFK dhe e-pasuria) është domosdoshmëri për të siguruar që OB mbajnë evidenca të plota lidhur me pasurinë e tyre të përgjithshme; dhe
- Thesari/Divizioni për Monitorim në kuadër të MF-së duhet të ushtroj kontrolle më të rrepta të monitorimit në proceset e raportimeve mujore të obligimeve të papaguara. Një rishikim më kritik i raporteve për obligimet e papaguara është i nevojshëm dhe aty ku vonesat dhe vlera e obligimeve është materiale, t'a adresoj çështjen tek zyrtarët më të lartë në zinxhirin llogaridhënës të organizatës përkatëse.

2 Zbatimi i rekomandimeve të dhëna për PFV e vitit 2015

Rëndësia e raporteve të auditimit qëndron në identifikimin e rekomandimeve praktike, zbatimi i të cilave mundëson përmirësim të vazhdueshëm në qeverisjen e përgjithshme dhe menaxhimin e financave publike. Niveli aktual i zbatimit të rekomandimeve të auditimit nuk është i kënaqshëm, sidomos fakti që rekomandimet e prioritetit të lartë janë më pak të zbatuara, krahasuar me rekomandimet me prioritetit të mesëm.

Qeveria kishte përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të RVA-së, megjithatë, nuk është raportuar në baza tremujore në Kuvend për progresin e arritur. Ndërsa, në nivel të auditimeve individuale, shumica e organizatave buxhetore nuk zbatojnë proces sistematik për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve. Ngecjet në zbatimin e plotë të rekomandimeve ndikojnë në përsëritjen e dobësive dhe mangësive të kontrollit dhe shfaqjen sistematike të parregullsive nga viti në vit. Shkaqet që kanë ndikuar në zbatimin e ulët të rekomandimeve janë të ndryshme, të cilat do të shpjegohen më poshtë.

ZKA në vazhdimësi jep rekomandime për institucionet e audituara, për Qeverinë dhe për Kuvendin, për adresimin e çështjeve të ndryshme që identifikohen gjatë auditimeve. Këto rekomandime janë një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive dhe menaxhimit financiar. Zbatimi i rekomandimeve të auditimit, është njëri ndër treguesit nëse menaxhmenti po përmirëson proceset ekzistuese dhe kontrollet.

Përveç dhënies së rekomandimeve, ZKA përmes auditimeve individuale bën edhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna. Rrjedhimisht, në RVA, ZKA vlerëson nivelin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna⁶ dhe progresin e arritur (shih tabelën 1 dhe 2).

Tek auditimet e performancës matja e zbatimit të rekomandimeve bëhet përmes kryerjes së vlerësimeve specifike që njihen edhe si “faza e përcjelljes”.

Çështjet dhe rekomandimet për Ndërmarrjet Publike do të trajtohen në një seksion të veçantë të këtij raporti.

⁶ Shtojca III Rekomandimet e RVA-së të vitit 2015

2.1 Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në RVA 2015

Në RVA për vitin 2015, AP kishte rekomanduar Kuvendin të kërkoj nga Qeveria një raport në lidhje me rekomandimet e dhëna në RVA të vitit 2014, dhe të përgatisë një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në RVA të vitit 2015, si dhe raporte në lidhje me progresin e këtij plani në baza tremujore.

Kuvendi i Kosovës në dhjetor të vitit 2016 kishte miratuar rekomandimet të cilat kërkonin nga Qeveria të:

- përgatisë një raport kthyes në lidhje me rekomandimet e AP-së për RVA për vitin 2014;
- përgatisë një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve nga RVA për vitin 2015 si dhe të raportojë në baza tremujore në KMFP për progresin e arritur; dhe
- gjitha OB-të të raportojnë mbi progresin e zbatimit të rekomandimeve në baza tremujore në MF dhe KMFP.

Qeveria e Kosovës, në shkurt 2017, kishte përgatitur një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të RVA2015, mirëpo nuk kishte bërë raporte në baza tremujore në lidhje me progresin e zbatimit të rekomandimeve.

Në bazë të informatave të siguruara gjatë procesit të auditimit për pasqyrat e buxhetit si dhe nga auditimet individuale, kemi vërejtur se veprimet e ndërmarra nga ana e Qeverisë kanë treguar një progres në zbatimin e rekomandimeve në krahasim me vitet paraprake. Nga gjithsej 39 rekomandime⁷ të dhëna, pesë (5) janë zbatuar plotësisht, 21 ishin në proces të zbatimit dhe pesë (5) të tjera nuk ishin adresuar ende. Për tetë (8) rekomandime të cilat lidhen me auditimet e performancës, mbetet të bëhet auditimi përcjellës i zbatimit të tyre, në mënyrë që të bëhet një vlerësim i saktë i progresit. Për një pasqyrë më të qartë, mund t'i referoheni shtojcës III të këtij raporti.

Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve ka ndikuar që dobësitë dhe parregullsitë e caktuara të përsëriten nga viti në vit. Këtu përfshihen: raportimi i gabueshëm i shpenzimeve në PFV për shkak të keq klasifikimit; mungesë të qasjes efektive në fushat e qeverisjes që ndërlidhen me vetëvlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut; dobësi në procedurat e prokurimit; mungesë të shërbimeve të auditimit të brendshëm për institucionet e vogla të pavarura; dhe menaxhim joefikas të burimeve në komuna. Prandaj, Kuvendi dhe Qeveria duhet të ndërmarrin veprimet e nevojshme për një trajtim adekuat të rekomandimeve të dhëna.

⁷ 28 rekomandime janë dhënë për Qeverinë dhe 11 për Kuvendin e Kosovës. Nga këto rekomandime tetë (8) janë dhënë në lidhje me auditimin e performancës.

2.2 Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale të auditimit për vitin 2015 dhe 2014

Zbatimi i rekomandimeve të AP-së, të dhëna në raportet e auditimit të rregullsisë, përcillet në mënyrë sistematike nga ana e ZKA-së. Vlerësimi se si dhe sa janë zbatuar ato, bëhet në secilën organizatë buxhetore gjatë auditimit të rregullt dhe rezultatet për vitin paraprak paraqiten në raportet e auditimit për vitin vijues.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat rreth zbatimit të rekomandimeve të vitit 2015 dhe 2014, të cilat janë të kategorizuara edhe sipas prioritetit të vlerësuar.

Organizatat e audituara janë ndarë në: Institucione të nivelit qendror⁸, Institucione të pavarura⁹ dhe Institucione të nivelit lokal (38 Komuna).

Tabela 9: Zbatimi i rekomandimeve të AP-së për vitin 2015

Subjektet e audituara	Nr. i rekomandimeve		Prioriteti	Plotësisht të zbatuara		Pjesërisht të zbatuara		Të pa zbatuara	
	Total	Sipas prioritetit		L/M	Nr	%	Nr	%	Nr
Institucionet e nivelit qendror	338	221	L	52	24	93	42	76	34
		117	M	41	35	33	28	43	37
Institucionet e pavarura	184	109	L	28	26	49	45	32	29
		75	M	24	32	21	28	30	40
Institucionet e nivelit lokal	640	516	L	113	22	192	37	211	41
		124	M	40	32	37	30	47	38
Rekomandime me prioritet të lartë		846	L	193	23	334	39	319	38
Rekomandime me prioritet të mesëm		316	M	105	33	91	29	120	38
Gjithsej rekomandime		1162	M+L	298	26	425	37	439	38

⁸ 19 Ministri (për 2015 nuk është përfshirë MAPL- auditim i kontraktuar), Zyra e Kryeministrit, Administrata Tatimore e Kosovës, Dogana dhe ShSKUK.

⁹ Në institucionet e pavarura janë përfshirë Kuvendi i Kosovës, Zyra e Presidentit dhe 28 institucione tjera.

Grafiku i zbatimit të rekomandimeve për vitin 2015




Tabela 10. Zbatimi i rekomandimeve të AP-së për vitin 2014

Subjektet e audituara	Nr i rekomandimeve		Prioriteti	Plotësisht të zbatuara		Pjesërisht të zbatuara		Të pa zbatuara	
	Total	Sipas prioritetit		L/M	Nr	%	Nr	%	Nr
Institucionet e nivelit qendror	347	222	L	78	35	77	35	67	30
		125	M	55	44	41	33	29	23
Institucionet e pavarura	200	110	L	43	39	41	37	26	24
		90	M	51	57	16	18	23	26
Institucionet e nivelit lokal	630	489	L	87	18	200	41	202	41
		141	M	42	30	43	30	56	40
Rekomandimet me prioritet të lartë		821	L	208	25	318	39	295	36
Rekomandimet me prioritet të mesëm		356	M	148	42	100	28	108	30
Gjithsej	1177	1177	M+L	356	30	418	36	403	34

Siç shihet edhe nga tabela më lart, numri total i rekomandimeve krahasuar me vitin paraprak (2014) është në rënie. Ndërsa, sipas institucioneve, tek komunat ka një rritje të numrit të rekomandimeve. Sa i përket zbatimit të rekomandimeve krahasuar me vitin 2014, niveli i rekomandimeve të pa zbatuara është në rritje. Në përgjithësi, rekomandimet me prioritet të mesëm kanë një përqindje më të mirë të zbatimit, derisa niveli i zbatimit të rekomandimeve me prioritet

të lartë është në përqindje të ultë. Kjo ka ndikuar që shumë rekomandime të AP-së të përsëriten edhe këtë vit.

Fushat kryesore ku janë përsëritur rekomandimet kanë të bëjnë me: shpalosjet e informatave në PFV, qeverisja (vetëvlerësimi dhe menaxhimi i rrezikut), klasifikimi i shpenzimeve, realizimin e buxhetit, prokurimi, auditimi i brendshëm, llogaritë e arkëtueshme, obligimet e papaguara, menaxhimi i pasurive etj.

Në mënyrë që situata të përmirësohet, nevojitet rritje e përkushtimit nga personat përgjegjës dhe monitorim i rregullt i zbatimit të rekomandimeve nga të gjitha OB-të.

Në përgjithësi, nuk është zbatuar ndonjë proces formal i monitorimit, vlerësimit apo raportimit mbi shkallën e progresit. Kjo pasqyron mungesën e fokusit për të siguruar që rekomandimet zbatohen me kohë dhe pengesat për veprim të identifikohen dhe adresohen.

2.3 Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit të performancës

Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve nga raportet individuale të auditimit të performancës bëhet përmes auditimeve të veçanta të cilat njihen edhe si “faza e përcjelljes”. Në këtë drejtim, ZKA në sezonin e auditimit 2016/2017 ka bërë një auditim përcjellës për zbatimin e rekomandimeve lidhur me kontratën për sistemin e prokurimit elektronik. Prej 13 rekomandimeve të dhëna, 2 rekomandime ishin zbatuar dhe është vërejtur një progres fillestar, 9 rekomandime janë në shqyrtim e sipër, derisa për 2 rekomandime, nuk është ndërmarrë ndonjë veprim drejt adresimit të tyre. Kjo rezulton me konkludimin se MF si dhe KRRP kanë arritur të identifikojnë nevojat për përmirësime, por nuk janë ndërmarrë hapa konkretë për përmirësim e tyre.

Në anën tjetër, në KMFP janë shqyrtuar disa raporte, në kuadër të cilave edhe raportet e auditimit të performancës, si: Raporti për menaxhimin e procesit të pajisjes së nxënësve me tekste shkollore dhe Raporti për administrimin e programit për trajtim jashtë institucioneve shëndetësore publike.

2.4 Arsyet për zbatim të ulët të rekomandimeve

Mungesa e proceseve formale për monitorimin e mirëfilltë dhe sistematik të planeve të veprimit për zbatim të rekomandimeve si dhe mungesa e përkushtimit të duhur për trajtimin e tyre, janë ndër shkaktarët kryesor për nivelin e pakënaqshëm. Po ashtu, mungesa e mbikëqyrjes efikase nga ana e Qeverisë dhe organeve mbikëqyrëse, ka ndikuar që organizatat buxhetore të shmangin zbatimin e plotë dhe konsistent të udhëzimeve për menaxhimin financiar, duke bërë që rekomandimet të përsëriten.

Për të rritur nivelin e zbatimit të rekomandimeve, nevojiten masa shtesë nga ana e Qeverisë ndaj OB-ve dhe forcimi i masave të llogaridhënies ndaj Kuvendit të Kosovës.

2.5 Rekomandimet e përgjithshme

Rekomandimet për Kuvendin e Republikës së Kosovës janë:

- Të kërkoj nga Qeveria dhe Institucionet e Pavarura një raport progresi në baza tre mujore në lidhje me rekomandimet e dhëna nga AP në RVA 2016, dhe rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, që ndërlidhen me këtë raport (përfshirë progresin e arritur dhe barrierat që mund të ndikojnë në mos zbatimin e plotë të rekomandimeve); dhe
- Të kërkoj nga Qeveria dhe Institucionet e Pavarura që të shqyrtojnë arsyet pse një numër i rekomandimeve nga viti i kaluar nuk janë zbatuar, si dhe të siguroj që plani i veprimit i përgatitur pas marrjes së këtij raporti, do të inkorporojë të gjitha rekomandimet e dhëna dhe do të përcaktojë saktë veprimet, afatet kohore dhe personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve dhe monitorimin e tyre.

Rekomandimet për Qeverinë e Republikës së Kosovës janë:

- Të raportoj në baza tre mujore lidhur me progresin dhe sfidat për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga AP në RVA 2016; dhe
- Të zbatojë një proces efektiv të monitorimit të zbatimit të planeve të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të AP-së, dhe të kërkojë nga OB raportim të rregullt mujor në lidhje me progresin e arritur. Të ndërmarr masa adekuate administrative në pajtim me kuadrin ligjor kur organet kompetente dështojnë në zbatimin e rekomandimeve.

Rekomandimet për Kuvendet e Komunave janë:

- Kryetarët e komunave, në baza të rregullta kohore të raportojnë në Kuvendin Komunal lidhur me progresin dhe sfidat për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga AP në RVA 2016; dhe
- Kryetarët e Komunave të zbatojnë një proces efektiv të monitorimit të zbatimit të planeve të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të AP-së, dhe të kërkojë nga njësitë e brendshme organizative raportim të rregullt mujor në lidhje me progresin e arritur.

3 Qeverisja e mirë

Institucionet shtetërore janë përgjegjëse të vendosin dhe zhvillojnë një sistem funksional të kontrollit të brendshëm. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli duhet të zbatohet nga menaxherët e lartë të organizatave në të gjitha strukturat, programet, operacionet dhe proceset e menaxhuara nga ta, duke respektuar parimet e ligjshmërisë, menaxhimit të mirëfilltë financiar dhe transparencës.

Qeverisja si një komponentë shumë e rëndësishme e vlerësimit të performancës së organizatave buxhetore, ka shënuar një progres të lehtë nga viti paraprak. Këtë vit vërehet një disiplinë më e mirë sa i përket dorëzimit të pyetësorit të vetëvlerësimit. Megjithatë, nga testet tona mund të konstatojmë se procesi dhe ndikimi i vetëvlerësimit, ende është i pamjaftueshëm në aspektin e cilësisë apo edhe nga veprimet që duhet të ndërmerren për të adresuar sfidat me të cilat ballafaqohen organizatat.

Sfidat më të theksuara me të cilat po përballen organizatat, edhe më tej janë mungesa e strategjive, menaxhimi i dobët i rrezikut dhe monitorimi i pamjaftueshëm i objektivave të vendosura. Po ashtu, sfida mbetet edhe niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm (rreth 55%) dhe një mbështetje e dobët e Komiteteve të auditimit për Njësitë e Auditimit të Brendshëm të organizatave buxhetore.

Përkundër zhvillimeve pozitive, një numri të konsiderueshëm të OB-ve (41%) u mungojnë planet strategjike dhe kostot financiare të këtyre strategjive (36%). Po ashtu, rreth 59% të OB-ve nuk kanë sisteme efektive të menaxhimit të rrezikut, pavarësisht se kjo është kërkesë aktuale e përcaktuar nga Qeveria.

Draft ligji për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike ende nuk është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës.

Trajnimet në lidhje me vetëvlerësimin nga Njësia Qendrore Harmonizuese ishin më të shpeshta këtë vit, megjithatë duket se ishin të pamjaftueshme, pasi që në disa organizata vërehet se vetëvlerësimi nuk ishte i saktë. Vetëvlerësimi akoma nuk është kuptuar si një proces ku organizata identifikon mangësitë dhe merret seriozisht me adresimin e fushave për përmirësimin e tyre.

Qeverisja e mirë ka për qëllim të kontribuoj në rritjen e llogaridhënies, transparencës, përmirësimin e performancës në sektorin publik dhe luftimin e korrupsionit. Për më tepër, qeverisja e mirë kontribuon në përmirësimin e menaxhimit të organizatave buxhetore, me intervenim më energjik ndaj parregullsive dhe keqpërdorimeve potenciale.

Qeveria e mbështetë agjendën e qeverisjes së mirë përmes zbatimit të një kornize për promovimin e praktikave të mira përmes një strategjie të përgjithshme të KBFP-së e cila synon realizimin e objektivave në vijim:

- Përfshirjen e burimeve të nevojshme në proceset e menaxhimit të financave publike dhe rivlerësimin e përshtatshmërisë së kontrolleve ekzistuese;
- Rritjen e llogaridhënies në zbatimin e politikave qeveritare për menaxhimin e fondeve publike;
- Ndryshimi i kornizës ligjore në përputhje me kërkesat për menaxhimin e rrezikut; dhe
- Avancimin e mëtejshëm të sistemit të auditimit të brendshëm, duke ndikuar në rritjen e llogaridhënies për shfrytëzimin ekonomik, efikas dhe efektiv të fondeve publike.

Mjetet kyçe në dispozicion për t'i mbështetur subjektet e sektorit publik që t'i zbatojnë aranzhimet pozitive të qeverisjes përfshijnë një pyetësor vetëvlerësimi, i cili i dërgohet MF në baza vjetore nga ana e OB-ve individuale, dhe punën e NJQH-së përmes trajnimeve lidhur me ngritjen e njohurive dhe vetëdijes për MFK-në dhe për sistemin e Auditimit të Brendshëm (AB).

NJQH është përgjegjës për hartimin e dokumenteve dhe politikave për zhvillimin dhe monitorimin e MFK-së dhe AB-së, duke ndihmuar, monitoruar dhe kryer vlerësime të jashtme që kanë të bëjnë me rishikimin e sigurimit të cilësisë së auditimit të brendshëm në subjektet e sektorit publik.

NJQH ka organizuar seminare për menaxherët e lartë dhe auditorët e brendshëm rreth rëndësisë së procesit të vetëvlerësimit dhe menaxhimit të rreziqeve.

3.1 Mbështetja nga Zyra Kombëtare e Auditimit për agjendën e qeverisjes së mirë

ZKA ka një rol kyç në mbështetjen e zhvillimeve të qeverisjes. Kjo adresohet përmes një programi të punës, i cili është i bazuar në rrezik (i fokusuar në ato fusha ku puna e tillë pritet të ketë ndikim maksimal) dhe reflekton pjesërisht mbi iniciativat kryesore të zbatuara nga Qeveria.

Në fushën e qeverisjes së mirë, nga auditimet individuale ka rezultuar:

- Progres në lidhje me procesin e vetëvlerësimit dhe menaxhimin e rrezikut;
- Raportim më i mirë menaxherial, rritje e llogaridhënies, si dhe hapat e ndërmarrë për t'u përgjigjur me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara; dhe
- Puna më efektive e NJAB-ve dhe niveli i përmirësuar i zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm nga menaxhmenti.

3.1.1 Roli i vetëvlerësimit nga auditimet individuale në Sistemin e Kontrollit të Brendshëm

MFK është një mjet i rëndësishëm që i ndihmon udhëheqësit e institucioneve shtetërore në promovimin e llogaridhënies në arritjen e misionit, vizionit dhe objektivave strategjike të institucioneve që i drejtojnë. Një faktor kyç në përmirësimin e llogaridhënies është ngritja dhe zbatimi i një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm. Varësisht se si ndryshon mjedisi, edhe institucionet duhet të përmirësojnë proceset operacionale duke vlerësuar në vazhdimësi sistemin e kontrollit të brendshëm në mënyrë që ai të jetë efektiv dhe i përditësuar sipas nevojave.

MF/NJQH ka hartuar Pyetësin e Vetëvlerësimit për komponentët e MFK-së, që kërkohet nga OB-të ta vlerësojnë organizatën e tyre nëpërmjet 106 pyetjeve në pesë (5) komponentë, të cilat adresojnë fushat më të rëndësishme të qeverisjes. Kjo i mundëson MF-së t'i vlerësoj zhvillimet e përgjithshme të MFK-së dhe t'i identifikoj çështjet për të cilat OB-të kërkojnë mbështetje të mëtejme.

Pavarësisht ndërgjegjësimit lidhur me rëndësinë dhe ndikimin që menaxhimi financiar ka në financat publike të vendit, nga auditimet e kryera ZKA evidenton ende problematika lidhur me pesë (5) komponentët bazë të MFK-së.

Në mënyrë më të hollësishme, vlerësimi nga ana e ZKA-së për 91 OB të audituara, për gjashtë (6) pyetjet e përzgjedhura nga Pyetësi i Vetëvlerësimit, ka rezultuar si në vijim:

1) Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit është themeli ku mbështeten të gjitha komponentat tjera të kontrollit të brendshëm. Për auditimin e kësaj komponente, janë trajtuar pyetjet: nëse organizatat kanë hartuar strategjitë, nëse në hartimin e tyre ishin të përfshira palët e interesit dhe aktorët relevant; dhe nëse strategjitë përmbajnë kosto dhe indikatorë matës.

- Hartimi i planeve strategjike dhe përfshirja e palëve të interesit në hartimin e tyre – shqetësim kryesor mbetet numri i madh i organizatave që ende nuk kanë hartuar plan strategjik. Kjo gjendje nuk ka ndryshuar nga viti paraprak, pasi që vetëm 56% (50 nga 90) të organizatave buxhetore kanë një plan strategjik. Mos hartimi i planeve strategjike është më i theksuar tek komunat, ku nga 38 komuna, 20 prej tyre nuk kanë plane strategjike. Në disa raste shqetësim mbetet edhe mos përfshirja e palëve të interesit në hartimin e strategjive; dhe
- Llogaritja e koston së strategjive – Përkundër uljes së shkallës nga 63% në 36% krahasuar me një vit më parë, 18 nga 50 OB që kanë hartuar strategjitë, nuk e kishin të kalkuluar koston financiare dhe nuk kishin vendosur indikatorë matës.

2) Menaxhimi i rrezikut

Bazuar në kërkesat e MFK-së, pas planifikimit të fondeve buxhetore institucioni analizon dhe bën kontrollin e rreziqeve të cilët mund të vënë në rrezik realizimin e objektivave. Menaxhimi i rrezikut është komponentë shumë e rëndësishme për të identifikuar, vlerësuar dhe monitoruar rreziqet si dhe për të zbatuar kontrole, të cilat janë të nevojshme për të reduktuar ekspozimin ndaj rrezikut në një nivel të pranueshëm.

Në auditimin e kësaj komponente është trajtuar nëse organizatat kishin hartuar regjistrin e rreziqeve dhe nëse kishin vendosur mekanizma adekuat për të ndërmarrë veprime konkrete për menaxhimin e tyre.

Nga testet nëpër organizata buxhetore rezulton që komponenta e menaxhimit të rrezikut është përmirësuar, nga fakti që vitin paraprak, rreth 78% e OB-ve nuk e kishin trajtuar nivelin e rreziqeve, përderisa këtë vit kjo ka shënuar rënie prej 19%.

Pra, në vitin 2016, 54 nga 91 organizata buxhetore (59%) nuk kishin krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të identifikimit dhe menaxhimit të rreziqeve në nivel të organizatës. Kjo dukuri kishte ngecje më të theksuar te Komunitet, ku vetëm 13% prej tyre kishin hartuar regjistrin e rreziqeve dhe te Institucionet e pavarura 50%, përderisa gjendja më e mirë ishte te Ministrinë me 72%.

Sa i përket veprimeve konkrete që janë ndërmarrë në lidhje me menaxhimin e rreziqeve, vërehet një gjendje shqetësuese pasi që pak Organizata e kanë trajtuar seriozisht menaxhimin e rrezikut. Rreth 73% e organizatave, nuk ka marrë veprime konkrete për të menaxhuar rrezikun apo 66 nga 91 prej tyre.

3) Aktivitet e kontrollit

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e rreziqeve me synim arritjen e objektivave. Për auditimin e kësaj komponente është trajtuar pyetja: A kanë organizatat një plan prokurimi të miratuar kundrejt disponueshmërisë së fondeve buxhetore të miratuara dhe a azhurnohet i njëjti gjatë vitit në përputhje me ndryshimet e fondeve në dispozicion. Rezultatet e auditimit janë:

- Hartimi i planit të prokurimit nga OB-të – nga auditimet e kryera rezulton se organizatat qëndrojnë mirë në këtë pikë nga fakti që plani final hartohet pas ligjit të buxhetit ku organizatat mund ta di saktë sa do të jenë fondet në dispozicion të tyre dhe të bëj harmonizimet e planit me buxhetin e ndarë. Vetëm në një rast nga 91 sosh, rezulton që nuk ishte hartuar plani i prokurimit në përputhje të plotë me fondet e ndara; dhe
- Azhurnimi i planit të prokurimit qoftë pas rishikimit të buxhetit apo në momentin kur shtohen apo zvogëlohen projektet që duhet të prokurohen, është vërejtur që organizatat vetëm e bëjnë njoftimin në Agjencinë Qendrore të Prokurimit, por nuk bëhet ndonjë azhurnim i planit, pasi që edhe me Ligjin e Prokurimit Publik nuk kërkohet që plani të azhurnohet.

4) Informimi dhe komunikimi

Në lidhje me këtë komponentë, ZKA ka trajtuar nëse organizatat me sistemin e vendosur të raportimit e mbështesin vendimmarrjen në kohën e duhur. Po ashtu, është trajtuar edhe procesi i komunikimit dhe raportimit në mes Departamenteve dhe Zyrtarit Kryesor Administrativ dhe se si informohet ai për ecuritë operative dhe financiare të organizatës.

Vlerësimi në lidhje me nivelin e komunikimit dhe raportimit mund të konsiderohet mjaft funksional pasi që rreth 79% (72 nga 91) e organizatave kanë të vendosura sisteme efikase të raportimit dhe komunikimit, që lehtësojnë vendimmarrjen operacionale të menaxhmentit.

Komunikimi dhe raportimi bëhet qoftë përmes takimeve javore të menaxhmentit apo edhe në format tjera të komunikimit elektronik që dalin sipas kërkesave të menaxhmentit, ku ofrohen informata të dobishme në lidhje me vendimmarrjen. Po ashtu, edhe raportet mbi ekzekutimin e buxhetit janë në baza javore dhe mujore, por ka edhe raporte tjera mbështetëse që kërkohen nga menaxhmenti.

5) Monitorimi

Në lidhje me komponentën e fundit, ZKA ka trajtuar nëse organizatat monitorojnë rregullisht progresin lidhur me arritjen e objektivave dhe analizojnë shkaqet për dështimet e mundshme në këtë drejtim.

- Te çështja e monitorimit të progresit lidhur me arritjen e objektivave bazuar në dëshmitë e ofruara vlerësojmë se situata nuk është përmirësuar nga viti paraprak ngase 49% apo (45/91) nuk kanë një proces efektiv të monitorimit nëse objektivat e organizatës janë duke u arritur; dhe
- Nuk ka një sistem efikas duke bërë ndonjë matje me objektivat strategjike, dhe duke identifikuar shkaktarët e mos përmbushjes së objektivave. Edhe këtu gjendja më e keqe vërehet te Komunitat dhe Institucionet e pavarura.

Në kontekst të kontrolleve të pritura, rishikimi ynë ka shpalosur:

- Progres të kufizuar në proceset strategjike, duke rezultuar me mungesa të planeve strategjike apo edhe me plane strategjike që nuk kanë kosto, duke rritur rrezikun që planet e aprovuara të mos kenë mbështetje financiare;
- Një rritje e lehtë e aktiviteteve sa i përket menaxhimit të rrezikut, por që ende ka shumë mangësi në përmbajtjen e kësaj komponente të rëndësishme; dhe
- Se proceset e informimit dhe komunikimit janë mjaft efektive, përderisa aktivitetet e monitorimit ende nuk janë të dizajnuara dhe nuk funksionojnë siç kërkohet, për të vlerësuar progresin në përmbushjen e objektivave strategjike. Kjo e pamundëson reagimin e menjëhershëm nga ana e menaxhmentit për adresimin e barrierave të cilat pengojnë arritjen e objektivave të organizatës.

Nga analiza jonë vërehet se qëllimi i vetëvlerësimit, përkundër progresit ende nuk është kuptuar sa duhet, nga fakti që veprimet e ndërmarra nga organizatat për adresimin e mangësive të identifikuar nga vetëvlerësimi i vitit paraprak është i kufizuar. Këtë vit një vëmendje më e madhe i ishte kushtuar plotësimit të pyetësorëve ku nga shumë organizata janë mbajtur edhe takime të brendshme për plotësimin e tyre. Po ashtu, edhe NJQH kishte mbajtur trajnime në lidhje me vetëvlerësimin që ka të bëjë me përmbushjen e kërkesave të pyetësorit.

3.1.2 Sistemi i Auditimit të Brendshëm

NJAB është funksion i rëndësishëm në OB, i cili siguron menaxhmentin e lartë se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe funksionojnë në mënyrën e duhur. Po ashtu, NJAB ka rol domethënës në ngritjen e nivelit të shërbimeve që u ofrohen shfrytëzuesve dhe qytetarëve të Kosovës.

NJAB mbështetet nga Komiteti i Auditimit (KA) i cili është organ këshillëdhënës për menaxhmentin e lartë të OB-ve, që siguron pavarësinë e AB-së si dhe siguron se rekomandimet e dhëna nga AB janë pranuar dhe zbatuar nga të audituarit.

Njëra nga objektivat e Strategjisë së Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike (SKBFP) 2015-2019 është edhe funksioni i auditimit të brendshëm. Për arritjen e kësaj objektive është kërkuar avancimi i AB-së përmes zbatimit të programit për zhvillim profesional, zbatimit të sigurisë së cilësisë për pajtueshmëri si dhe azhurnimit të kornizës ligjore. Pra, rëndësia dhe ndjeshmëria e profesionit të AB-së në vlerësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe në dhënien e rekomandimeve, i obligon AB që të kenë nivelin e duhur profesional.

MF gjatë vitit 2016 kishte aprovuar UA nr. 04/2016 për programin kombëtar për trajnim dhe certifikim të auditorëve të brendshëm në sektorin publik, i cili program është akredituar nga Autoriteti Kombëtar për Kualifikime, dhe se i gjithë ky proces ka ndikuar në rritjen numrit të auditorëve të brendshëm të certifikuar për 46% në raport me vitin paraprak (në vitin 2015 ishin 67 auditorë të certifikuar, ndërsa në vitin 2016 ky numër është rritur në 98).

Më tej, NJQH është koordinatore e gjithë procesit për auditim të brendshëm dhe ndër të tjera gjatë vitit 2016 kishte kryer edhe monitorimin e pesë (5) NJAB-ve¹⁰, si dhe në bashkëpunim me ekspertët e Komisionit Evropian ka përgatitur si model “Librin për përshkrimin e proceseve” për tri (3) OB ku janë identifikuar rreziqet në fushën e KBFP si dhe është ofruar një analizë për menaxhimin e tyre.

¹⁰ Raporti vjetor për funksionimin e sistemit të KBFPSP 2016- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria për Komunitet dhe Kthim, Ministria e Administratës Publike, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Univeriteti i Prishtinës.

Fokusi ynë në auditimin e brendshëm për vitin 2016 ka përfshirë vlerësimin e përbashkët për disa fusha kyçe si:

- UA nr.23/2009, përveç kriterëve për themelimin e NJAB-së, ndër të tjera përcakton edhe numrin e nevojshëm të AB-ve sipas madhësisë së OB-ve. Nga auditimet individuale ka rezultuar se vetë katër (4) komuna¹¹ nuk kishin themeluar NjAB, nga 9 sa ishin në vitin paraprak, çka vërehet një progres në këtë aspekt. Më tej, gjashtë (6)¹² OB nuk kishin staf të mjaftueshëm në NJAB, përderisa të gjitha këto njësi me përjashtim të tri (3)¹³ prej tyre kishin përgatitur planet bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe prioritetëve të OB-së;
- Fokusimi i aktivitetit të AB-së në vitin aktual ishte në 71% të aktivitetëve. Ne shqyrtuam edhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë i OB-ve në zbatimin e rekomandimeve të dala nga këto raporte dhe kemi vërejtur se 55% kishin gjetur zbatim, që paraqet një rritje të lehtë krahasuar me vitin paraprak; dhe
- Ne kemi vërejtur se 11 Organizata nuk e kishin themeluar KA. Prej tyre tetë komuna¹⁴ dhe tri (3) agjenci të pavarura¹⁵. Më tej, 41% e këtyre komiteteve ishin efektive dhe kishin mbështetur punën e NJAB-së, ndërsa 24% e KA kishin ofruar kontribute të kufizuara.

Auditimet vazhdojnë të mbeten të orientuara drejt pajtueshmërisë dhe më pak të përqendruara në ndryshimet sistemore dhe përmirësimeve.

Sistemi i kontrollit të brendshëm përkundër përmirësimeve nga viti i kaluar, ende nuk është në nivelin e kënaqshëm, në mënyrë që AB të veprojnë si këshilltarë dhe mekanizëm parandalues i gabimeve dhe parregullsive.

3.2 Zhvillimet e reja në reformën e administratës publike

Reformimi i shërbimit publik ka ndikim të veçantë në krijimin e një administrate publike efektive dhe qeverisjes së mirë. MAP po bën përpjekje të vazhdueshme ta zbatoj në praktikë strategjinë 2015 – 2020 për modernizimin e administratës publike.

Një sistem i shërbimit publik i menaxhuar mirë i ndihmon institucioneve shtetërore të arrijnë shkallë të lartë të profesionalizmit dhe cilësisë së shërbimeve publike ndaj qytetarëve dhe bizneseve. Disa nga zhvillimet në këtë fushë janë:

- Aprovimi i Ligjit për Procedurat e përgjithshme Administrative;
- Miratimi në Qeveri i Projektligjit për pagat i cili paraqet një koncept të ri bazik për zbatimin e reformës në lëmin e pagave dhe kompensimeve tjera për të punësuarit që përfitojnë pagë nga buxheti i Kosovës;
- Hartimi i katalogut të vendeve të punës në shërbimin civil;

¹¹ Komuna e Leposaviqit, Zubin Potokut, Mitrovicës Veriore dhe Mamusha

¹² MASHT, SHSKUK, UP, Kaçaniku, Skenderaj dhe Peja.

¹³ Prishtina, Gjakova dhe ASHNA.

¹⁴ Komuna e Junikut, Prishtinës, Novobërdës, Ranillugut, Gjakovës, Rahovecit dhe Obiliqit

¹⁵ Avokati i Popullit, ASHNA dhe Agjencioni Kosovarë për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronës

- Avancimi i mëtejshëm i Sistemit të Informatave për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, si dhe ndërlidhja e këtij sistemi me disa sisteme tjera;
- Finalizimi i projektit e-Kutia, i cili pritet që të bëjë matjen e kënaqshmërisë së qytetarëve për shërbimet që ofrohen nga institucionet; dhe
- Në procese të regjistrimit dhe raportimit të organizatave jo-qeveritare, ka përfunduar Sistemit Elektronik për OJQ-të (SEMOJQ), i cili ka filluar të aplikohet nga janari i vitit 2017.

Reforma në administratën publike ka vazhduar dhe tashmë janë bërë përgatitjet e duhura që të miratohen dokumentet për Ligjin mbi Shërbimin Civil, Ligjin për Pagat dhe Ligjin për Organizimin e Administratës Shtetërore. Po ashtu, gjatë vitit 2016 janë vënë bazat në racionalizimin e të gjitha Agjencive edhe ato që janë përgjegjësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës, edhe ato që janë përgjegjësi e Parlamentit dhe të agjencive tjera të pavarura.

Me gjithë progresin e theksuar në drejtim të plotësimit dhe ndryshimit të kornizës ligjore, ngecjet janë evidente në zbatimin e tyre. Përkundër aprovimit, katalogu dhe sistemi i ri i pagave ende nuk kanë gjetur zbatim në praktikë. Këto zhvillime do të mundësonin një organizim më efikas të administratës shtetërore, nivelizim të pagave për angazhimet e njëjta të përgjegjësisë në cilindo nivel të shërbimit publik (pagesa e njëjtë për punën e njëjtë), standardizimin e titujve dhe përshkrimin e qartë të vendeve të punës dhe transferim të nëpunësve ndërmjet institucioneve në rastet kur ajo është adekuate.

Po ashtu, auditimet tona individuale të kryera për OB tregojnë dobësi në zbatimin e kërkesave dhe procedurave ligjore në menaxhimin e personelit dhe pagesave të kompensimeve. Kjo veçanërisht theksohet te rekrutimi i personelit, mbajtja e pozitave menaxhuese me ushtrues detyre përtej afatit kohor ligjor dhe angazhimi i punëtorëve me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta pa aplikuar procedura.

3.3 Çështjet tjera të cilat kanë të bëjnë me kolizionet ligjore

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) bazuar në Ligjin nr.04/L-032 “Për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës”, ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ nr. 13/2016 pajisja e nxënësve me tekste shkollore, përdorimi dhe ruajtja e tyre, i cili udhëzim bie ndesh me Ligjin në fjalë.

Udhëzimi i obligon nxënësit/prindërit që t’i ruajnë dhe t’i kthejnë tekstet me përfundimin e vitit shkollor, derisa Ligji përcakton që tekstet të jepen falas, gjë që shihet se edhe brenda vet ligjit ka kundërthënie ngase në njërin anë thuhet që tekstet jepen falas, e në anën tjetër e obligon MASHT-in që të nxjerrë Udhëzim të veçantë për shpërndarjen dhe ruajtjen e tyre.

Për më tepër, ende ka paqartësi ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Financave se në cilin kod buxhetor duhet të regjistrohet projekti “Blerja dhe furnizimi me libra për nxënësit e nivelin I dhe II të arsimit para universitar”.

3.4 Rekomandimet

Rekomandojmë Qeverinë që të siguroj se:

- Menaxhmenti i organizatave buxhetore i kushton vëmendje të veçantë proceseve të hartimit të strategjive, ku do të përfshihen edhe palët e interesit, dhe që strategjia të përmbajë koston financiare dhe indikatorët matës, si dhe më pas të bëj monitorimin e tyre me qëllim të përmbushjes së objektivave të vendosura;
- Menaxhmenti i organizatave buxhetore të cilat ende nuk kanë trajtuar në nivelin e duhur menaxhimin e rrezikut, duhet të sigurojnë se janë ndërmarrë veprime konkrete për adresimin e plotë të kësaj komponente përmes identifikimit, analizës, vlerësimit dhe trajtimit të rrezikut;
- Menaxhmenti i organizatave buxhetore duhet të ndërmarrë masa shtesë të mbikëqyrjes së aktiviteteve për të siguruar se arrihen objektivat e përcaktuara;
- Menaxhmenti i organizatave buxhetore të cilat nuk kanë të themeluar NJAB, duhet të themelojnë këtë njësi, përmes së cilës do të sigurohej funksionimi efikas dhe efektiv i sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Menaxhmenti i organizatave buxhetore të cilat nuk kanë themeluar KA duhet t'i themelojnë këto komitete, për të mbështet realizimin e objektivave të NJAB si dhe të mbaj llogaridhënës stafin përkatës; dhe
- Menaxhmenti i Ministrisë së MASHT-it duhet të inicioj rishikimin e Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës me qëllim të shmangies së paqartësive rreth furnizimit dhe menaxhimit të teksteve shkollore. Gjithashtu, në koordinim me MF-në të ndërmerren veprime që projekti për furnizim me tekste shkollore të klasifikohet në kode buxhetore adekuate dhe të raportohen si shpenzime në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik.

Rekomandojmë Kuvendin e Kosovës që të siguroj se:

- Qeveria e Kosovës monitoron zbatimin e objektivave të përcaktuara në strategjinë për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike; dhe
- Përmes KMFP t'i obligoj të gjitha OB të raportojnë lidhur me procesin e zbatimit të rekomandimeve të dala nga raportet individuale të auditimit nga ZKA.

4 Prokurimi

Zhvillimi i sistemit e prokurimit publik gjatë vitit 2016 ka shënuar një progres të lehtë, megjithëse platforma e prokurimit elektronik nuk është funksionalizuar plotësisht. Sipas vendimit të Qeverisë, e-prokurimi do të duhej të futej në funksion nga organizatat e qeverisjes qendrore prej datës 01.09.2016. Mirëpo, deri tani e-prokurimi është aplikuar vetëm në 16% të Ministrive dhe 36% të Institucioneve të Pavarura. AP ka dhënë 13 rekomandime¹⁶ lidhur me funksionalizimin e sistemit të e-prokurimit, por vetëm dy (2) janë zbatuar (nga MF dhe Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik).

Raportet individuale të auditimit të rregullsisë vënë në pah dobësi duke filluar nga planifikimi i prokurimit, zhvillimi i procedurave të prokurimit, deri te menaxhimi i kontratave. Një përfundim i tillë ka dalë në Raportin e Performancës për Menaxhimin e Procesit të Prokurimit për Mirëmbajtjen e Rrugëve, duke vënë në pah mangësi pothuaj në tërë procesin e prokurimit. Madje, është konkluduar se në disa raste nuk është arritur vlera për para.

Në vitin 2016 institucionet publike kanë nënshkruar 10,015 kontrata përmes prokurimit, në vlerë rreth 425 milion euro¹⁷ apo rreth 1/4 e Buxhetit të Kosovës. Andaj është më rëndësi mbarëvajtja efektive e procesit të prokurimit në zhvillimin e ekonomisë vendore. Ndërsa, platforma elektronike për prokurimin publik edhe pse ka filluar të zhvillohet që nga dhjetori i vitit 2014, ajo ende nuk është plotësisht funksionale.

4.1 Roli i organizatave përgjegjëse për prokurimin publik

Organizatave përgjegjëse për funksionimin e prokurimit publik janë: Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) dhe Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP). Po ashtu, secila organizatë ka rolin dhe përgjegjësinë e saj për zhvillimin e proceseve efektive të prokurimit.

KRPP është përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë në përgjithësi dhe atij elektronik (e-prokurimi).

Qëllimet kryesore të platformës së e-prokurimit, janë: rritja e aftësive vendimmarrëse të zyrtarëve të prokurimit, përmirësimi i planifikimit financiar dhe buxhetimit, përmirësimi i transparencës, efikasitet në gjithë procesin e prokurimit, nxitja/inkurajimi i pjesëmarrjes dhe promovimit të konkurrencës ndërmjet furnizuesve, maksimizimi i vlerës për para në prokurimin qeveritar dhe ndikimi në ekonomi, si dhe rritja e besimit të qytetarëve dhe bizneseve në procesin e prokurimit qeveritar në përdorimin e fondeve publike.

Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që platforma e-prokurimi të funksionoj nga shtatori 2016 në të gjitha autoritetet kontraktuese të nivelit qendror për prokurimet me vlera të mëdha dhe të

¹⁶ Në auditimin e Përfundimit të Performancës "Zbatimi i kontratës për sistemin e prokurimit elektronik"

¹⁷ Në këtë shumë nuk është e përfshirë kontrata për autostradën Prishtinë-Hani Elezit e cila për vitin 2016 ka vlerë përafërsisht 126 milion euro.

mesme. Ndërsa nga janari 2017 kjo platformë është bërë e obligueshme edhe për prokurimet e centralizuara, organizatat buxhetore të nivelit lokal dhe ndërmarrjet publike.

Megjithatë gjatë vitit 2016 e-prokurimi është përdorë në nivel të ultë apo rreth 16% e Ministrive. 26% e ministrive e kanë përdorë në disa raste dhe 58% nuk e kanë aplikuar fare këtë platformë¹⁸.

Një gjendje më e mirë është te Institucionet e Pavarura pasi rreth 36% e tyre kanë zhvilluar procedurat e prokurimit në mënyrë elektronike.

OSHP, është agjenci e pavarur dhe është përgjegjëse për zbatimin e procedurave dhe shqyrtimin e ankesave në prokurim. Gjatë vitit 2016, OSHP ka pranuar 481 ankesa për parregullsi të procedurave, për partneritet publiko-privat dhe ankande, dhe krahasuar me vitin paraprak, ka një rënie të numrit të ankesave për 19%. Nga numri i përgjithshëm i ankesave, 158 janë aprovuar si të bazuara, 198 raste janë kthyer në rivlerësim, për 44 raste është vendosur që të ri-tenderohen, 27 ankesa janë hedhur poshtë si të pa kompletuara, 30 janë tërhequr nga OE ankues dhe pjesa tjetër janë trajtuar si jo kompetencë e OSHP-së.

Edhe në vitin 2016 shkeljet më të shpeshta nga Autoritetet Kontraktuese kanë të bëjnë me: favorizimin e operatorëve, barazinë në trajtim/jo diskriminim, mjetet për promovimin e transparencës, dosjen e tenderit, specifikimet teknike, ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe kriteret për dhënien e kontratës.

Këto ankesa janë drejtuar për 75 institucione të ndryshme; Institucione Qendrore, Institucione të qeverisjes lokale, Institucione të pavarura, Ndërmarrje Publike apo Institucione tjera. Gjatë vitit 2016, OSHP kishte shqiptuar dy (2) gjoba nga 25,000€ për mos respektim të vendimeve të saj; njëra për Telekomin e Kosovës dhe një ndaj Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK).

AQP - është një agjenci ekzekutive e pavarur në kuadër të MF-së, kompetencat e së cilës janë: kryerja e aktiviteteve specifike të prokurimit në emër të autoriteteve kontraktuese pas një vendimi të Ministrit të Financave, kryerja e prokurimeve të centralizuara për artikujt të përdorimit të përbashkët sipas propozimit të MF dhe aprovimit nga Qeveria, kryerja e prokurimeve sipas kërkesës së autoriteteve kontraktuese dhe asistimi i autoriteteve kontraktuese gjatë zbatimit të aktiviteteve të prokurimit, me kërkesën e këtyre të fundit.

Gjatë vitit 2016, AQP kishte kryer 12 aktivitete të centralizuara të prokurimit, për dallim nga viti 2015, ku kishte zhvilluar vetëm 4 procedura. Vlera totale e këtyre kontratave është afërsisht 14% më e ulët se vlera e parashikuar e tyre. Përveç kësaj, AQP kishte zhvilluar procedura për 16 Agjenci të Pavarura dhe procedura tjera në bazë të kërkesës së MF-së apo autoriteteve kontraktuese.

¹⁸ MAPL nuk është e përfshirë në këtë analizë, për shkak se ishte auditim i kontraktuar.

4.2 Auditimet e performancës për prokurim publik

Gjatë vitit të kaluar janë kryer dy (2) auditime të performancës për prokurimin publik: Menaxhimi i procesit të prokurimit për mirëmbajtjen në rrugëve dhe Auditimi përcjellës -Zbatimi i kontratës për sistemin e prokurimit elektronik.

Raporti lidhur me Menaxhimin e procesit të prokurimit për mirëmbajtjen e rrugëve përfshinë mirëmbajtjen e rrugëve nga Ministria e Infrastrukturës dhe Komuna e Prishtinës. Auditimi ka identifikuar dobësi pothuaj në tërë procesin e prokurimit për mirëmbajtjen e rrugëve; nga planifikimi, procesi i tenderimit dhe gjatë mbikëqyrjes së kontratave për mirëmbajtje të rrugëve dhe informata më të hollshme gjenden në seksionin 5 - Auditimet e performancës.

Raporti nga auditimi përcjellës lidhur me Zbatimin e Kontratës për sistemin e prokurimit elektronik ka pasur qëllim vlerësimin se deri në çfarë niveli Ministria e Financave dhe KRPP kanë arritur t'i zbatojnë rekomandimet e dhëna në raportin e publikuar "Implementimi i kontratës për sistemin e prokurimit elektronik" të publikuar në korrik të vitit 2016. Auditimi ka identifikuar ngecje në zbatimin e platformës së prokurimit publik dhe informata më të hollshme gjenden në seksionin 2 - Zbatimi i rekomandimeve

4.3 Çështjet kryesore të rregullsisë në fushën e prokurimit

Raportet individuale të auditimit për vitin 2016 kanë treguar se procesi i prokurimit përcillet me mangësi në të gjitha fazat, që nga planifikimi, zhvillimi i procedurave dhe me theks të veçantë menaxhimi i kontratave. Shumë çështje të identifikuara këtë vit janë mangësi që përsëriten vit pas viti qoftë në raportet individuale, apo në raportin vjetor të auditimit.

Tabela në vijim paraqet çështjet kryesore të cilat janë hasur qoftë në institucionet e nivelit qendror apo nivelit lokal.

Çështja	Shkaku	Ndikimi	Veprimet e kërkuara nga menaxhmenti
Planifikim jo i mirë i prokurimeve dhe aktivitete jashtë planit të prokurimit pa e njoftuar AQP-në.	Planifikim jo i mirë i prokurimit.	Mungesa e plotësisë të kërkesave ligjore mund të shkaktoj që projektet mos të realizohen me kohë apo të mos realizohen fare.	Të kryhet një analizë më e detajuar e nevojave para finalizimit të planit të prokurimit, në mënyrë që prokurimet jashtë planit të zvogëlohen në një nivel të arsyeshëm.
Mos plotësimi i kërkesave teknike dhe profesionale nga OE dhe shpërblimi i ofertave me çmim më të lartë.	Dobësi në procesin e vlerësimit të tenderëve nga ana e komisioneve vlerësuese.	Kjo pamundëson arritjen e objektivave të OB-ve dhe mund të pengojë aktivitetet e përditshme të njëjësive kërkuese, me mundësinë e kostove shtesë të buxhetit.	Të sigurohet përmes menaxherit të prokurimit se procesi i vlerësimit është në harmoni të plotë me kriteret e vendosura dhe trajtimi i operatorëve është i barabartë.
Deklaratat nën betim nuk ishin nënshkruar nga fituesit e tenderëve.	Dështimi i kontrolleve nga komisionet vlerësuese.	Mos zbatimi i drejtë i rregullave dhe udhëzuesve të prokurimit publik, mund të rezultojë në përzgjedhjen e OE të papërgjegjshëm dhe vlerë të dobët për para.	Zyrtarët përgjegjës për prokurim, duhet të zbatojnë në mënyrë strikte kërkesat ligjore të dala nga LPP, dhe dosjet e pakompletuara, të mos shqyrtohen nga ana e komisioneve vlerësuese.
Mangësi në procedurat e prokurimit, duke mos zbatuar kërkesat e LPP-së.	Dobësitë kanë ndodhur për shkak të anashkalimit të procedurave të prokurimit dhe udhëzuesve operativ nga zyrtarët kompetent.	Favorizime potenciale apo diskriminime ndaj OE-ve dhe vlerë e dobët për para dhe/apo dështim për t'i marrë shërbimet e caktuara.	Të aplikohen procese të qarta të llogaridhënies përmes mbikëqyrjes dhe rishikimit. Çdo mos aplikim i procedurave apo udhëzimeve, të justifikohet dhe aprovohet formalisht.

Pagesat për furnizime jashtë afatit të paraparë të kontratës.	Për shkak të neglizhencës për të zhvilluar procedurat e prokurimit me kohë, janë kryer pagesa edhe pas skadimit të kontratave.	Pagesat për furnizime në mungesë të kontratës valide, janë në kundërshtim me rregullat për menaxhimin e parave publike, si dhe mund të dëmtojnë buxhetin.	Të bëhet rishikimi rigoroz që të sigurohet se të gjitha furnizimet realizohen në pajtim të plotë me rregullat dhe procedurat ligjore si dhe çdo pagesë të jetë e bazuar në një kontratë valide.
Mos caktimi i menaxherëve të kontratave, mungesa e planeve për menaxhimin e kontratave dhe menaxhimi i dobët i kontratave.	Mungesa e përgjegjësisë dhe e kontrolleve të mjaftueshme nga nivelet më të larta të menaxhmentit.	Mangësitë në procesin e menaxhimit të kontratave, zvogëlojnë sigurinë që kontratat realizohen konform kushteve dhe specifikave të parapara.	Menaxhmenti përkatës duhet të siguroj respektim konsistent dhe efektiv të rregullave të prokurimit. Monitorimi sistematik i realizimit të kontratave do të shtonte sigurinë për realizimin e tyre konform kushteve të kontraktuara.
Vonesa në furnizim nga OE dhe mos aplikim i ndëshkimeve për vonesa.	Vonesat nga operatorët ekonomik janë si rezultat se furnizimet janë bërë pa urdhër-blerje.	Mos furnizimi me kohë, mund të ndikoj që OB mos të arrin përmbushjen e objektivave, me ndikimin e mundshëm edhe në mbarëvajtjen e operacioneve.	Shpenzuesit buxhetor duhet të kryejnë një rishikim të procesit dhe të ndërmerren masat e nevojshme për menaxhim më të mirë të furnizimeve, si dhe të aplikohen ndëshkimet për vonesa.
Vonesa në realizimin e projekteve kapitale.	Mungesa e monitorimit efektiv të zbatimit të kontratave dhe mos harmonizimi i kërkesave me fondet në dispozicion.	Vonesa në realizimin e përfitimeve nga projekti dhe ngarkesat e buxhetit të viteve vijuese.	Menaxhimi i vazhdueshëm i kërkesave për para, kundrejt orarit të pagesave, si dhe aplikimi i penaleve për çdo vonesë.
Kryerja e pagesave para se të kryhen punët dhe mos përfundimi i punëve për arsye të skadimit të kontratës.	Mangësi në monitorimin e zbatimit të kontratave dhe kryerjen e punëve si nga aspekti i kohës, ashtu edhe nga ndikimet e kushteve tjera.	Kryerja e pagesave pa u pranuar punët dhe mos sigurimi që punët janë kryer brenda afatit ligjor të kontratës, bartin rrezikun që punët të mos kryhen dhe projektet të mos përfundohen.	Duhet të shtohen kontrollet e brendshme që të sigurohet se janë marrë veprimet e nevojshme për të siguruar se punët përfundohen brenda afatit të kontraktuar dhe se asnjë pagesë nuk ekzekutohet para se punët të jenë kryer.

4.4 Rekomandimet

Rekomandojmë Qeverinë që të siguroj se:

- Janë identifikuar arsyet për mos aplikim të mjaftueshëm të prokurimit elektronik;
- Platforma e prokurimit elektronik zbatohet plotësisht në të gjitha institucionet, qofshin të nivelit qendror, nivelit lokal apo ndërmarrje publike; dhe
- Janë zbatuar rekomandimet e dhëna nga auditimet e performancës “Menaxhimi i procesit të prokurimit për mirëmbajtjen në rrugëve” dhe “Auditimi përcjellës-Zbatimi i Kontratës për sistemin e prokurimit elektronik”.

Rekomandojmë Kuvendin që të sigurojë se:

- Ka ushtruar ndikimin e vet tek Qeveria për të siguruar që rekomandimet tona për vitin aktual dhe ato paraprake adresohen plotësisht, duke vendosur kontrolle efektive gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe duke siguruar vlerën për para; dhe
- KRPP monitoron me kohë zbatimin e prokurimit elektronik duke siguruar transparencë më të madhe, efikasitet në procesin e prokurimit, nxitjen dhe inkurajimin e konkurrencës dhe rritjen e besimit në përdorimin e fondeve publike.

5 Auditimet e performancës

Menaxhimi strategjik dhe operacional efektiv i mbështetur në një strukturë të përshtatshme ligjore dhe i bazuar në procese efektive të monitorimit është çelësi për të maksimizuar përfitimet nga shpenzimet publike.

Përkundër përpjekjeve të dokumentuara edhe gjatë procesit auditues nga institucionet për të vendosur procese dhe procedura të strukturuar përmes vendosjes së mekanizmave të monitorimit dhe zbatimit, ende ka mungesë të konsistencës ndërmjet planeve strategjike dhe kapaciteteve për zbatimin e tyre në mënyrë efektive.

Në fushat e audituara gjatë vitit 2016 kemi identifikuar dobësitë vijuese:

- Qytetarët nuk marrin shërbime mjekësore cilësore nga institucionet shëndetësore publike. Për më tepër programi për trajtimin e pacientëve jashtë ISHP-ve nuk administrohet mirë;
- Vëmendje e pamjaftueshme i kushtohet masave për mbrojtjen e mjedisit, madje institucionet nuk sigurojnë informim të plotë dhe cilësor për gjendjen e mjedisit;
- Rishikimi i teksteve shkollore si proces i domosdoshëm nuk i ka arritur qëllimet e synuara për ngritjen e cilësisë në arsim, përmirësimi i teksteve ka qenë i vogël dhe rishikimi ka shtuar kostot pa marrë përfitimet;
- Procesi për mirëmbajtje të rrugëve është përcjellë me dobësi, rezultatet e synuara pjesërisht janë arritur dhe në disa raste nuk është arritur vlera për para;
- Autoritetet përgjegjëse ende kanë vështirësi në menaxhimin efektiv të planifikimit të kontratave të ndërtimit;
- Investimet e Qeverisë të kryera në ndërmarrje publike nuk kanë kontribuar në masën e nevojshme në ngritjen e cilësisë së shërbimeve publike, derisa mungon monitorimi i duhur i investimeve; dhe
- Fondi zhvillimor nuk menaxhohet plotësisht në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe ka një realizim të ultë të buxhetit të projekteve duke ndikuar negativisht në arritjen e qëllimeve të synuara për zhvillim ekonomik dhe social.

ZKA ka kryer auditime të performancës me qëllim të vlerësojë se si janë përdorur paratë publike dhe cilat janë rezultatet e arritura. Qasja e aplikuar reflekton kornizën e inkorporuar në standardet e INTOSAI, bazuar në 3 E-të:

- **Ekonomia** - minimizimin e kostos së resurseve të përdorura në një aktivitetet, duke marrë parasysh kualitetin e duhur;
- **Efikasiteti** - relacioni ndërmjet outputeve (daljeve) në kuptim të mallrave, shërbimeve, rezultateve dhe resurseve të përdorura për prodhimin e tyre; dhe
- **Efektiviteti** - shkalla e arritjes së objektivave dhe relacioni ndërmjet ndikimit të synuar dhe ndikimit aktual të një aktiviteti.

Në këtë kapitull gjeni përmbledhjen e shtatë (7) auditimeve të performancës¹⁹. Prej tyre, dy (2) kanë të bëjnë me projekte (5.7 dhe 5.8). Këto tema janë përzgjedhur për shqyrtim, si rezultat i një procesi të planifikimit të gjerë që përfshinë diskutimet me një sërë akterësh dhe janë konsideruar fusha me rëndësi për vendin dhe për publikun në përgjithësi.

5.1 Trajtimi i Pacientëve Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike

Qytetarët e Republikës së Kosovës kanë të drejtën e trajtimit të barabartë mjekësor, zgjedhjen e lirë për këtë trajtim sikurse të drejtën në ankesë. Shërbimet e kujdesit shëndetësor ofrohen nga Institucionet Shëndetësore Publike (ISHP), publiko-private dhe private. Por ISHP-të nuk kanë arritur të ofrojnë shërbime mjekësore për të gjithë qytetarët në nevojë. Në vitin 2015 janë paraqitur 1,859 aplikacione për trajtim jashtë institucioneve publike apo edhe jashtë vendit.

Për këto nevoja, Ministria e Shëndetësisë ka krijuar Programin për Trajtimin e Pacientëve Jashtë ISHP-ve brenda dhe jashtë vendit. Kuvendi Kosovës në Ligjin e Buxhetit Vjetor të vitit 2015 ka ndarë 7.8 milionë euro për këtë Program. Megjithatë, jo të gjitha rastet përfitojnë nga ky fond. Nga 1,859 aplikacione për trajtim jashtë ISHP-ve gjatë vitit 2015, janë shqyrtuar 1,347 ndërsa 512 nuk janë shqyrtuar fare. Nga rastet e shqyrtuara 1,212 janë aprovuar.

Administrimi i Programit²⁰ në aspektin procedural dhe financiar është paraqitur sfidë për MSH-në. Kjo është theksuar në Raportet e auditimit financiar të ZKA-së dhe në Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2015.

Mesazhi i auditimit, MSH nuk ka siguruar bazë të sigurt të dhënash e cila siguron shqyrtimin e aplikacioneve sipas radhës dhe prioritetit të sëmundjeve. Bordi Ekzekutiv nuk ka dhënë shpjegime të qartë për arsyet e rasteve të refuzuara. Po ashtu, nuk ka mënyrë të definuar për të monitoruar shpenzimet e mjeteve financiare për trajtim të pacientëve dhe si pasojë për vitin 2015 këto shpenzime nuk janë monitoruar fare.

¹⁹ Raportet e plota individuale mund ti gjeni: <http://ëëë.zka-rks.org/publications/>

²⁰ Programi parasheh procedura: aplikacioni për trajtim përcillet më hartimin e raportit nga Komisioni Konziliar (QKUK) që dorëzohet në MSH për vlerësim dhe aprovim/refuzim nga Bordi Ekzekutiv. Vendimet e Bordit për vlerat deri 30,000€, miratohen nga Sekretari i Përgjithshëm dhe Ministri i Shëndetësisë, ndërsa vlerat mbi 30,000€ janë kompetencë e Qeverisë.

Kërkesa e bërë dy (2) vite me radhë për instalimin urgjent të një programi/sistemi kompjuterik, i cili siguron administrim korrekt të aplikacioneve, nuk është përfillur nga Menaxhmenti i MSH-së, gjë që tregon mungesën e veprimeve përmirësuese.

Si përfundim qytetarët e Kosovës nuk iu ofrohen shërbime mjekësore cilësore nga ISHP-të dhe MSH. Për më shumë, Programi për Trajtimin e Pacientëve jashtë ISHP-ve nuk është administruar mirë, dhe kjo i kontribuon negativisht kësaj situatë.

5.2 Masat Kombëtare për Mbrojtjen e Mjedisit

Krijimi i mjedisit të sigurt jetësor si dhe mbrojtja e tij, janë çështje vendimtare për shëndetin e qytetarëve dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Programet mjedisore në Kosovë identifikohen si programe të Qeverisë, ndërsa Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka rol kryesor në zbatimin e tyre.

Raporti i Progresit për Kosovën i vitit 2016 potencon problemet lidhur me mjedisin në Kosovë, si degradimi i mjedisit dhe cilësia e mjedisit larg standardeve mjedisore të BE-së. Edhe Ministria ka identifikuar të ashtuquajturat 'hot-spote' si zona të rrezikshme (ndotësit e ajrit, ujit dhe tokës). Ndërsa zhvillimi i industrisë, teknologjisë, rritja e numrit të automjeteve, e bëjnë edhe më serioze çështjen mjedisore.

Mesazhi i auditimit - Legjislacioni mjedisor thuhet se është konsoliduar, por nuk u është dhënë vëmendje masave për mbrojtjen e mjedisit. Objektivat e vendosura në Planin Kombëtar për Veprim në Mjedis, nuk janë të qëndrueshme pasi burimet për realizim të tyre janë të kufizuara. Andaj trajtimi aktual i sfidave mjedisore është larg nga objektivat e synuara.

Prioritet i ultë i jepet mbikëqyrjes ndotësve të mëdhenj, më me ndikim në mjedis, ndërsa mungojnë instrumentet që lidhen me parimin "Ndotësi paguan" dhe stimulimin ekonomik për të investuar në teknologji të pastër.

Sfidë tjetër është sistemi efektiv i informimit për çështjet mjedisore dhe ndikimit në shëndetin e qytetarëve e cila nuk është siguruar ende. Mekanizmat e brendshëm për zbatim, monitorim, dhe koordinim të projekteve mjedisore ende nuk janë funksionalizuar.

Indikacionet tregojnë se mundësitë dhe kapacitetet aktuale që Kosova ka për t'i adresuar sfidat mjedisore janë të kufizuara dhe duhet qasje sistematike institucionale ndaj këtyre çështjeve. Në përpjekje të MMPH-së për të ngritur në agjendë çështjet mjedisore, nuk janë kyçur Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës. Andaj qytetarëve të vendit ende nuk i është siguruar mjedis adekuat jetësor, madje mungon informimi i plotë për gjendjen dhe ndikimin e mjedisit ku jetojmë.

5.3 Procesi i Rishikimit të Teksteve Shkollore

Arsimi cilësor është e vetmja mënyrë për të rritur mundësitë e nxënësve për arsimim të mëtjshëm dhe për punësim më të mirë. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) mban përgjegjësinë kryesore për sigurimin e cilësisë së sistemit të arsimit para universitar. Cilësia në arsim është një çështje komplekse, ndër tjera ndërlidhet me cilësinë e kurrikulave dhe teksteve shkollore. Burime të ndryshme theksojnë se tekstet e shkollave fillore kanë mangësi: në përmbajtje, teknike dhe pedagogjike. Po ashtu, pesha e rëndë e çantave dhe shpenzimet e larta për libra janë shqetësim.

MASHT në vitin 2015 ka iniciuar procesin e rishikimit të teksteve shkollore me qëllim të përmirësimit të tyre, duke angazhuar Këshillin e Ekspertëve për Programe dhe Tekste Shkollore.

Mesazhi i auditimit - Procesi i rishikimit nuk i ka arritur qëllimet e synuara pasi ka rezultuar me tekste shkollore të përmirësuara përgjithësisht të natyrës teknike. Objektiva lidhur me lehtësimin e çantës shkollore nuk është prekur fare, ndërkohë që vendimi për të botuar të gjithë tirazhin e teksteve shkollore nga klasa 1-9, përfshirë ato që nuk i janë nënshtruar rishikimit, ka krijuar shpenzime të mëdha, e jo kursime siç ishte synuar fillimisht.

Iniciativa për të rishikuar tekstet shkollore ishte e domosdoshme. Megjithatë, Këshilli i Ekspertëve për Programe dhe Tekste Shkollore nuk ka arritur t'i realizojë tri (3) objektivat e përcaktuara: përmirësimin e pasaktësive dhe gabimeve në tekstet shkollore, lehtësimin e çantave shkollore të nxënësve, dhe kursimet buxhetore për botim. Si rrjedhojë, MASHT nuk ka arritur të siguroj parakushte për arsimim cilësor në vend.

5.4 Procesi i Prokurimit për Mirëmbajtje të Rrugëve

Rrugët janë pasuri ekonomike e shoqërore dhe duhet të mirëmbahen për të siguruar qarkullimin normal të qytetarëve. Gjatë viteve 2013-2015, për mirëmbajtje të rrugëve në nivel kombëtar, janë shpenzuar mbi 31 milionë euro. Ministria e Infrastrukturës dhe Komuna e Prishtinës, janë shpenzuesit më të mëdhenj. Mirëmbajtja e rrugëve realizohet përmes kontratave kornizë. Kjo fushë përcillet me menaxhim joefikas dhe gjetjet janë paraqitur në raportet e auditimit financiar. Po ashtu, mediat dhe organizatat joqeveritare shpesh i kanë theksuar dobësitë në këtë fushë

Mesazhi i auditimit - Ekzistojnë dobësi pothuaj në tërë procesin e prokurimit për mirëmbajtjen e rrugësve, nga planifikimi, procesi i tenderimit, dhe menaxhimi i kontratave për mirëmbajtje të rrugëve.

Procesi i prokurimit ka rezultuar me vonesa, dhënie të kontratave jo në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik, konkurrencë të ulët, dhe raportim jo të rregullt dhe jo të plotë për punët e kryera dhe punët shtesë.

Në specifikacionet teknike të kontratave për rrugë, Ministria e Infrastrukturës nuk ka cekur gjerësinë e rrugëve, ndërsa Komuna nuk e ka specifikuar gjatësinë e rrugëve. Kjo ka shkaktuar paqartësi, dhe dallimet në çmime për kilometër rrugë/mirëmbajtje mes Komunës dhe Ministrisë

ishin të mëdha. Më tej, bashkimi i mirëmbajtjes verore dhe mirëmbajtjes dimërore në një tender, ka rezultuar me kërkesa të larta për kualifikim duke ndikuar në zvogëlimin e konkurrencës.

Aktivitetet e ndërmarra nga Ministria e Infrastrukturës dhe Komuna e Prishtinës për Mirëmbajtje të rrugëve kanë arritur pjesërisht rezultatet e synuara dhe nuk është arritur vlera për para.

5.5 Planifikimi për Kontratat e Ndërtimeve

Qëllimi i Qeverisë është përmirësimi i standardit të jetesës së qytetarëve të saj. Një mënyrë për të bërë këtë është përmes investimit në infrastrukturë, siç janë shkollat, qendrat kulturore dhe sportive. Për këtë qëllim, autoritetet publike kanë investuar mjete të konsiderueshme në ndërtimin e objekteve, të cilat menaxhohen nga Ministrinë përkatëse. Vetëm Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve kanë shpenzuar 58 milionë euro për këtë qëllim në katër (4) vitet e fundit (2013-2016)²¹. Megjithatë, jo çdo herë është arritur qëllimi i synuar dhe qytetarët kanë shfaqur pakënaqësinë ndaj aktorëve të përfshirë në zbatimin e kontratave të ndërtimit. Kjo është paraqitur përmes raporteve të publikuara edhe në media²².

Mesazhi i auditimit - Në shumicën e projekteve të shqyrtuara kemi gjetur mangësi nga faza e planifikimit, përcaktimi i nevojave nga përdoruesit e objekteve dhe ekzaminimin e kushteve fizike të lokacioneve ndërtuese. Mangësi janë gjetur edhe në lidhje me financimin dhe sigurimin nëse specifikimet teknike përpunohen plotësisht me realitetin. Si rezultat, projektet e ndërtimit kanë tejkalluar kostot dhe është dashur të alokohet më shumë kohë për të përfunduar projektet.

Problemi aktual i menaxhimit të projekteve shkakton kosto për shoqërinë dhe buxhetin e shtetit. Planifikimi i dobët nga njësitë kërkuuese, tejkalimi i kostove për projekte, vonesat në realizimin e kontratave dhe mbikëqyrja a pamjaftueshme ndikojnë në mos arritjen e qëllimeve të synuara.

5.6 Investimet Kapitale në Ndërmarrjet Publike

Në Kosovë, shërbimet publike si energjia, telekomi, transporti hekurudhor, ujësjellësi, kanalizimi dhe mbeturinat menaxhohen nga Ndërmarrjet Publike (NP). Për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve publike Qeveria e Kosovës, përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE) çdo vit ndanë buxhet për investime kapitale në NP. Cilësia e shërbimeve publike ka nevojë të përmirësohet, ndërsa raportet e auditimit financiar dhe raportet e monitorimit nga Ministria tregojnë se ka probleme në procesin e menaxhimit të fondeve të Qeverisë.

Mesazhi i auditimit - MZHE nuk ka hartuar një dokument mbështetës të bazuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim ku përcaktohen edhe prioritetet për ngritjen e infrastrukturës në NP. Mungojnë udhëzuesit dhe procedurat standarde të mbikëqyrjes dhe monitorimit të NP-ve dhe nuk ka sistem të unifikuar të raportimit. Nuk i kushtohet rëndësi buxhetit të ndarë për NP, dhe në disa

²¹ Gjithsej 41 projekte janë zbatuar gjatë kësaj periudhe: 13 nga MKRS dhe 28 nga MAP. Ne kemi audituar 11 projekte

²² <http://m.gazetaexpress.com/lajme/klina-me-ne-fund-e-ndertoi-palestren-sportive-u-deshten-12-vjet-te-plota-205146/?archive=1>
<http://www.kosova-sot.info/sport/139368/vonesat-pergjegjesi-e-institucioneve-tona/>

raste Qeveria me rishikim ka shkurtuar buxhetin përkundër faktit se NP-të kishin nënshkruar kontratat me operatorët ekonomik.

NP-të, kanë vonesa në funksionalizimin e projekteve të financuara nga Ministria, mungon koordinimi i duhur me nivelin lokal ndërsa, në tri (3) NP buxheti nuk ishte menaxhuar sipas kërkesave të ministrisë.

Paratë e dhëna NP-ve për shërbime publike cilësore nuk kanë arritur efektin e dëshiruar. Në disa raste, projektet e financuara nga Qeveria e Kosovës pas përfundimit nuk janë funksionalizuar apo përdorur për qëllimin e synuar. Mekanizmat për kontrolle dhe monitorim nuk janë efektive dhe mungon menaxhimi adekuat e mjeteve.

5.7 Fondi Zhvillimor

Fondi Zhvillimor (Fondi) është themeluar në bazë të marrëveshjes së Bashkimit Evropian dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës në vitin 2013 në Bruksel. Ky fond krijohet nga të hyrat doganore në dy (2) pikat kufitare në veri të Republikës së Kosovës dhe ka për qëllim promovimin e zhvillimit social ekonomik në Komunitet: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq. Fondi menaxhohet nga Bordi Menaxhues i cili përbëhet nga Ministri i Financave, Përfaqësuesi Special i BE-së si dhe një përfaqësues i komunitetit nga njëra prej komunave përfituese.

Mesazhi i auditimit - Bordi menaxhues është vonuar në shqyrtimin dhe aprovimin e projekteve, dhe si rrjedhojë, komunat i kanë nënshkruar disa kontrata pa aprovim paraprak të Bordit. Komunitet përfituese nuk kanë raportuar mbi ecurinë e projekteve tek BM, siç kërkohet me Termat e Referencës (TeR).

MF dhe Komunitet nuk kanë arritur të klasifikojnë drejtë projektet në buxhet. Mjetet për Fondin janë ndarë vetëm në kategorinë ekonomike të Investimeve Kapitale, ndërsa disa projekte kanë të bëjnë me mallra dhe shërbime apo edhe subvencione. Po ashtu, projektet e aprovuara nuk janë përfshirë në Ligjin e Buxhetit të vitit 2016, derisa për vitin aktual janë përfshirë pjesërisht (prej 21 projekteve, në buxhetin vjetor janë përfshirë 7).

Dogana e Kosovës ka instaluar një sistem funksional për mbledhjen e të hyrave në dy (2) pikat e kalimit kufitar Jarinjë dhe Bërnjak.

Komunitet përfituese të Fondit, aktivitetet e tyre i kanë kryer pjesërisht në pajtim me legjislacionin në fuqi. Ato nuk janë treguar efikase në realizim të buxhetit dhe projekteve. Deri në shtator të vitit 2016, vetëm 2 nga 21 projekte janë realizuar apo vetëm 14% të buxhetit. Kjo ndikon negativisht në arritjen e qëllimit për zhvillim ekonomik e social.

5.8 Rekomandimet

Rekomandojmë Kuvendin e Kosovës që:

- Të obligoj Qeverinë të zhvilloj strategji për të siguruar se performanca e organizatave buxhetore maksimizohet, duke rritur kualitetin e shërbimeve për qytetarët dhe duke ekonomizuar kostot financiare;
- Të obligoj Qeverinë të siguroj trajtim mjekësor cilësor për qytetarët, mjedis të sigurt jetësor, arsimim cilësor dhe shërbime publike cilësore përmes performancës më të mirë të NP-ve;
- Të obligoj autoritetet publike të sigurojnë menaxhim efektiv të procesit të planifikimit të kontratave të ndërtimit për investimet në infrastrukturë, si: shkollat, qendrat kulturore e sportive, qendrat shëndetësore, etj; dhe
- Të obligoj Qeverinë dhe Komunat të sigurojnë menaxhim adekuat dhe efektiv të Fondit zhvillimor me qëllim të arritjes së rezultateve të synuara.

Rekomandojmë Qeverinë dhe Komunat që:

- MSH të vendos një aplikacion softverik për regjistrimin, menaxhimin dhe përpunimin e të dhënave të aplikuesve për trajtim jashtë ISHP-ve. Të përcillet progresi në shërim i pacientëve dhe rrjedha e shpenzimeve të menaxhohet/monitorohet si duhet;
- Të rishikohen masat e përcaktuara në Planin Kombëtar për Veprim në Mjedis mbi një analizë reale, sipas prioriteteve duke përcaktuar objektiva të arritshme dhe financim të qëndrueshëm; të ndërtojë një sistem të integruar të informimit mjedisor; të sigurohet se koordinimi i veprimeve me Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës intensifikon përpjekjet e përbashkëta për shqetësimet mjedisore në politikat e ndryshme dhe sektorët ekonomik;
- MASHT të siguroj rishikim cilësor të teksteve shkollore; të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme puna e recensentëve dhe anëtarëve të Këshillit për Programe dhe Tekste Shkollore për progresin e treguar në arritjen e objektivave të synuara; këshilli i ekspertëve për rishikim të teksteve shkollore të përcaktoj kritere të qarta si bazë e rishikimit si dhe ribotimet e teksteve të bëhen vetëm pas ndryshimeve/përmirësimeve;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Komuna e Prishtinës duhet t'i nisin më herët procedurat e prokurimit, të konsiderohet ndarja e mirëmbajtës së rrugëve në mirëmbajtje verore dhe dimërore në mënyrë që të ulen vlerat e kontratave. Po ashtu, të ngritet niveli i monitorimit si dhe shpenzimet e bëra për mirëmbajtje të rrugëve të regjistruhen në një bazë të të dhënave e cila do të shërbejë për planifikim në të ardhmen;
- Ministrinë të hartojnë Strategji mbi të cilën bazohen investimet e tyre në të ardhmen si dhe të përcaktojnë kriteret e investimeve nga faza e hershme e planifikimit të projekteve/kontratave investuese dhe rrjedhën e informacionit nga subjektet kërkuese në Ministri. Ministrinë dhe njësitë kërkuese, që në fazën e hershme (nga inicimi projekteve) të qartësojnë rolet, përgjegjësitë dhe resurset e nevojshme për secilin projekt. Po ashtu, Ministrinë të ushtrojnë kontrolle mbi projektet e tyre në mënyrë që të arrihen rezultatet e synuara;

- MZHE dhe NP-të si autoritete kyçe në sigurimin efektiv dhe efikas të shërbimeve publike për qytetarët e Republikës së Kosovës duhet të zbatojnë praktika të mira dhe të jenë të koordinuara mjaftueshëm për menaxhimin e investimeve kapitale në fushën e shërbimeve publike; dhe
- Bordi Menaxhues i Fondit Zhvillimor të siguroj vlerësim me kohë të projekteve, si dhe menaxhim adekuat dhe realizim të projekteve sipas afateve kohore nga Ministria dhe Komunitatet përkatëse. Më tej, të sigurohet zbatueshmëria e plotë e legjislacionit në fuqi, dhe të gjitha projektet e aprovuara nga Bordi të vendosen në Ligjin e Buxhetit.

6 Ndërmarrjet publike

ZKA për vitin 2016 ka kryer auditimin e PFV-ve të katër (4) Ndërmarrjeve Publike (NP). Duke ditur rëndësinë e menaxhimit të fondeve publike dhe rritjen e interesimit publik për Ndërmarrjet Publike, ZKA krahas rritjes së kapaciteteve, do të rris edhe numrin e auditimeve të NP-ve. Me këtë, ZKA synon të rris transparencën për mënyrën se si menaxhohen fondet publike dhe llogaridhënien për t'i mbajtur përgjegjës ata që janë të ngarkuar me qeverisje në Ndërmarrje Publike.

Auditimi i PFV-ve të vitit 2016, ka nxjerrë në pah se sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit në NP ka nevojë për përmirësime të dukshme. Fakti që për katër (4) NP kemi dhënë opinione të modifikuara, tregon për cilësinë jo të mirë të sistemeve financiare në NP. Të dhënat financiare të raportuara në Pasqyrat Financiare, kishin gabime materiale. Kjo, dobëson cilësinë e raportimit financiar dhe transparencën lidhur me menaxhimin e fondeve publike.

Për më shumë, ende nuk është instaluar një mekanizëm i qeverisjes së mirë në NP e cila do t'i kontribuonte zbatimit të politikave efektive që sigurojnë se objektivat janë duke u arritur në mënyrë ekonomike dhe efikase. Mungesa e planeve strategjike, llogaridhënies menaxheriale, auditime të brendshme jo efektive, tregojnë për domosdoshmërinë e rishikimit të aranzhimeve ekzistuese.

Proceset ekzistuese të planifikimit të buxhetit nuk janë adekuate. Ato nuk kanë marrë në konsideratë shkaqet të cilat mund të ndodhin gjatë vitit që rrezikojnë NP-të në arritjen e objektivave dhe rrisin pamundësinë e mbulimit të shpenzimeve. NP-të vazhdojnë të operojnë me humbje financiare dhe nevoja e vazhdueshme për subvencionim nga Buxheti i Kosovës apo donatorët, tregon për sistemet e brishta financiare. Jo stabiliteti financiar ka pamundësuar ngritjen e kapaciteteve kapitale për të siguruar ofrimin më cilësorë të shërbimeve për qytetarët.

Për të përmirësuar mënyrën aktuale të menaxhimit të Ndërmarrjeve Publike, kemi dhënë një numër të rekomandimeve, të cilat janë prezantuar në raportet individuale të auditimit dhe janë adresuar tek personat e ngarkuar me qeverisje të NP-ve.

6.1 Menaxhimi i buxhetit në NP

ZKA ka kryer auditimin e PFV për vitin 2016 për katër (4) Ndërmarrje Publike; dy (2) të nivelit qendror dhe dy (2) të nivelit lokal. Në vijim janë paraqitur të ardhurat e realizuara, shpenzimet, rezultati financiar dhe detyrimet afat shkurtëra dhe afat gjata.

Tabela 11: Rezultati financiar dhe detyrimet e NP të auditura

Nr.	Ndërmarrjet e audituara	Të ardhurat 2016	Shpenzimet 2016	Rezultati financiar 2016	Detyrimet afatshkurtëra më 31.12.2016	Detyrimet afatgjata më 31.12.2016
1	Hekurudhat e Kosovës Trainkos sh.a	3,151,291	(4,338,002)	(1,186,711)	4,196,300	859,398
2	Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës	1,851,415	(2,175,193)	(323,778)	690,750	158,582
3	Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastërtia sh.a	1,577,603	(1,629,260)	(51,656)	754,488	0
4	Ngrohtorja e qytetit të Gjakovës sh.a	1,047,819	(1,098,384)	(50,565)	699,613	921,506

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të buxhetit në NP nuk ishin adekuate. Të hyrat vetjake si një prej burimeve kryesore të financimit, nuk arrijnë të arkëtohen në tërësi. Për pasojë, llogaritë e arkëtueshme rriten nga viti në vit. Kjo, për shkak të politikave jo-efektive të zbatuara nga menaxhmenti dhe mungesës së një strategjie për inkasimin e borxheve. Fakti që NP-të në fund të vitit 2016 kanë detyrime të papaguara, të cilat ngarkojnë buxhetin pasues, reflekton sfidat financiare në NP. Jo stabiliteti financiar ka pamundësuar ngritjen e kapaciteteve kapitale për të siguruar ofrimin më cilësor të shërbimeve për qytetarët.

NP-të vazhdojnë të operojnë me humbje financiare dhe nevoja e vazhdueshme për subvencionim nga Buxheti i Kosovës dhe donatorët, rrit rrezikun për stabilitetin financiar. Më tej, mënyra aktuale e menaxhimit të burimeve njerëzore në NP nuk siguron një sistem të planifikuar dhe menaxhuar mirë në drejtim të rritjes së cilësisë së shërbimit publik ndaj qytetarëve.

Rekomandimi

Aksionarët duhet të rrisin llogaridhënien tek Kryesuesit e Bordeve përkatëse për të siguruar përmirësimin e performancës buxhetore. Monitorimi sistematik i NP-ve nga Aksionarët është i domosdoshëm me qëllim të identifikimit me kohë të barrierave dhe marrjen e masave për përmirësim.

6.2 Opinionet e auditimit

Në tabelën në vijim është dhënë një pasqyrë e opinionëve të dhëna për PFV të vitit 2016.

Tabela 12: Opinionet e dhëna për NP të audituara

Nr	Ndërmarrjet e audituara	Opinionet e auditimit
1	Hekurudhat e Kosovës Trainkos sh.a	Opinion i kundërt
2	Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës	Opinion i kualifikuar
3	Kompania Regjonale për Menaxhimin e Mbeturinave Pastërtia sh.a	Opinion i kundërt
4	Ngrohtorja e qytetit të Gjakovës sh.a	Opinion i kualifikuar

Parregullsitë e konfirmuara me rastin e auditimeve të kryera për vitin 2016, për shkak të cilave janë dhënë opinionet e lartpërmendura, kanë të bëjnë me shkaqet si në vijim:

Hekurudhat e Kosovës Trainkos sh.a. – PFV nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. Me theks të veçantë, informatat lidhur me llogaritë e arkëtueshme, llogaritë e pagueshme, bilancin e gjendjes, kapitalit rezervë, pasuritë dhe shënimet shpjeguese nuk ishin të plota dhe të sakta.

Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës – PFV prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, përveç efekteve të cilat kanë të bëjnë me llogaritë e arkëtueshme, llogaritë e pagueshme, detyrimet afatgjata, ekuitetit dhe mos prezantimi i saktë i bilancit të gjendjes.

Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastërtia sh.a - PFV nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. Kjo për arsye të regjistrimit të njëanshëm të transaksioneve, pasurive, kapitalit rezervë, shpenzimeve, stoqeve, llogarive të arkëtueshme, llogarive të pagueshme, dhe Shënimet shpjeguese nuk japin informacione shpjeguese të plota dhe të sakta.

Ngrohtorja e qytetit të Gjakovës sh.a – PFV prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, përveç efekteve të cilat kanë të bëjnë me llogaritë e arkëtueshme, obligimet afatshkurtëra dhe pasuritë.

Rekomandimi

Kryesuesit e Bordeve përkatëse duhet të sigurojnë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet të cilat kanë ndikuar tek dhënia e Opinionit të Kundërt respektivisht të Kualifikuar. Për të rritur cilësinë e informatave në PFV-ve dhe parandalimin e gabimeve, Kryesuesit e Bordeve duhet të ndërmarrin veprime konkrete për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike.

6.3 Rekomandimet e vitit paraprak

PFV-të e NP-ve në vitin e paraprak janë audituar nga kompanitë audituese private të licencuara nga Këshilli Kosovar për Raportim Financiar. Këto auditime kishin rezultuar me dhënien e disa rekomandimeve, që kishin për qëllim t'i ndihmojnë menaxhmentit në përmirësimin e proceseve rreth menaxhimit financiar dhe kontrollit. Në tabelën me poshtë, është prezantuar zbatimi i rekomandimeve të dhëna në vitin paraprak.

Tabela 13. Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të jashtëm për vitin 2015

NP-të e audituara nga ZKA për PFV të vitit 2016	Nr. i rekomandimeve të dhëna për PFV e 2015	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
HK Trainkos sh.a.	6	1		5
KMDK	3			3
Ngrohtorja e qytetit të Gjakovës sh.a	4	1	3	
KRM Pastërtia sh.a.	8	5	2	1
Totali i rekomandimeve	21	7	5	9

Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të jashtëm të vitit paraprak si mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive në përgjithësi nuk është marrë në konsideratë nga menaxhmenti i NP-ve. Një pjesë e madhe e rekomandimeve të vitit 2015, nuk ishin zbatuar dhe për pasojë mangësi të njëjta ishin evidente edhe në vitin 2016. Ky është një tregues që NP-të nuk i kanë trajtuar me kujdes rekomandimet e dhëna dhe përkushtimi për përmirësimin e kontrolleve në menaxhimin financiar është i limituar.

Rekomandimet

- Kryesuesit e Bordeve përkatëse duhet të sigurojnë një plan veprimi i cili përcakton aktivitetet, afatet dhe zyrtarët përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, si dhe të zbatojë një proces efektiv dhe formal për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të AP-së. Progresi kundrejt planit, duhet të rishikohet në mënyrë sistematike dhe të ndërmerren veprime proaktive ndaj barrierave në fazën e zbatimit; dhe
- Aksionarët duhet të kërkojnë nga menaxhmenti i NP-ve raporte progresi në lidhje me rekomandimet e dhëna nga Auditori i Përgjithshëm në raportet individuale të auditimit të ndërmarrjeve për vitin e kaluar.

6.4 Qeverisja e mirë në Ndërmarrjet Publike

Qeveria e Republikës së Kosovës ka kompetencat ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të aksionarit të NP-ve. Kështu, Qeveria përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE) si përfaqësuese e saj, garanton qytetarët e saj që NP-të veprojnë në përputhje me parimin e neutralitetit konkurrues si dhe përdorin fondet publike me eficiencë, ekonomi dhe efektivitet.

Për të mbështetur qeverisjen e mirë korporative, dhe për të rritur llogaridhënien dhe transparencën lidhur me performancën e NP-ve, MZHE ka hartuar Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative. Qeverisja e mirë korporative ka të bëjë me zbatimin e politikave efektive dhe proceseve që sigurojnë se objektivat janë arritur në mënyrë ekonomike dhe efikase brenda afateve të pritura kohore.

Rezultatet e auditimit kanë treguar që NP-të ende nuk kanë instaluar një qeverisje të mirë korporative. Përkundër disa proceseve pozitive, në një pjesë të konsiderueshme të fushave të qeverisjes janë identifikuar mangësi, siç janë:

- Ndërmarrjet nuk përgatitin plan strategjik, por përgatisin vetëm një plan të biznesit një vjeçar. Këto plane kanë identifikuar disa rreziqe që përballen ndërmarrjet, megjithatë shumica e NP-ve operojnë me humbje, për shkak të tarifave të ulëta apo kostove të larta të mirëmbajtjes së makinerive, dhe veprimet për menaxhimin e këtyre rreziqeve nuk ishin paraparë;
- Llogaridhënia dhe raportimi menaxherial nuk ishte adekuate dhe për pasojë cilësia e informatave financiare nuk ishte e mirë. Vendimmarrja mund të bazohet në informata të pasakta dhe kjo rrezikon arritjen e objektivave të ndërmarrjes; dhe
- Njësia e Auditimit të Brendshëm ishte e themeluar në tri (3), nga katër (4) NP-të e audituara. Megjithatë, NJAB-të nuk ishin efektive në mbështetje të menaxhmentit për përmirësimin e funksionimit të kontrolleve të brendshme. Raportet e auditimit të brendshëm nuk pasqyronin rreziqet ekzistuese të ndërmarrjes, nuk ofronin pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë si dhe nuk kishin dhënë rekomandime relevante për përmirësimin e tyre.

Rekomandimet për Bordin e Aksionarëve:

- Aksionarët duhet të sigurojnë se ndërmarrjet përgatisin plan strategjik apo dokument mbështetës bazuar në programin dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim të Qeverisë së Kosovës, me qëllim të prioritizimit të objektivave të tyre. Më tej, duhet të sigurojnë se NP-të përgatisin planin për menaxhimin e rrezikut dhe i njëjti të vihet në zbatim me qëllim të parandalimit, zvogëlimit apo eliminimit të këtyre rreziqeve; dhe
- Të kujdeset që nëpërmes Bordeve të mbaj përgjegjës menaxhmentin për të vendosur kontrolle dhe mekanizma për funksionalizimin e tyre, sidomos në mbledhjen e të hyrave dhe realizimin e shpenzimeve. Aksionarët duhet të sigurojnë se ndërmarrjet janë duke u angazhuar në zhvillimin dhe funksionalizimin e auditimit të brendshëm.

6.5 Prokurimi në NP

Procesi i prokurimit edhe te NP-të duhet të realizohet sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Ligjin e Prokurimit Publik në Kosovë.

Auditimi i katër (4) NP-ve për vitin 2016, ka treguar se kontrollet ekzistuese në fushën e prokurimit publik janë relativisht të mira. Megjithatë, auditimi ka nxjerrë në pah ekzistencën e disa mangësive për të cilat NP-të edhe më tutje duhet të punojnë për të avancuar sistemin aktual për të siguruar që paraja publike shfrytëzohet në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive.

Tabela në vijim paraqet çështjet kryesore të cilat janë hasur gjatë auditimit të NP-ve

Çështja	Shkaku	Ndikimi	Veprimet e kërkuara nga menaxhmenti
Mos caktimi i Menaxherit të Kontratës sipas Ligjit të Prokurimit Publik	Mungesa e vendimit nga Kryeshefi Ekzekutiv.	Mos përmbushja e obligimeve të performancës sipas kushteve të kontratës, nga ana e operatorit ekonomik	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj masat e duhura për respektimin e rregullave të prokurimit publik dhe të ushtrojë mbikëqyrje të përshtatshme për menaxhim efektiv.
Mangësitë në shërbime të kontraktuara	Mungesa e kontrolleve të brendshme efektive	Pranimi i punëve apo pajisjeve jo cilësore dhe jashtë kushteve kontraktuese.	Të vendosen kontrole adekuate dhe të respektohen obligimet kontraktuese, për çmimet dhe cilësinë e pranimin të mallrave të kontraktuara.
Mungesa e raportit për pranim të mallrave/shërbimeve	Mungesa e kontrolleve të brendshme efektive	Mallrat/shërbimet të mos janë pranuar sipas ofertës financiare dhe specifikave të kontratës.	Pranimi duhet të bëhet në përputhje me rregullat dhe raporti i pranimin të jetë dëshmi për përmbushjen e kontratës dhe ekzekutimin e pagesës.

6.6 Çështjet të cilat kanë të bëjnë me kërkesat ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligji “Për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit” i ka dhënë mandat të plotë Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e NP-ve. Megjithatë, Ligji për Ndërmarrjet Publike, Ligji për shoqëritë tregtare si dhe Ligji për kontabilitetet, raportim financiar dhe auditim trajtojnë NP si shoqëri tregtare dhe si të tilla i nënshtrohen kushteve dhe afateve kohore të raportimit financiar dhe auditimit të ndryshme prej atyre të parapara në Ligjin e Auditorit të Përgjithshëm. Për më shumë, në rast të mos respektimit të këtyre kushteve dhe afateve kohore, janë paraparë ndëshkime financiare për NP. Kolizionet mes ligjeve kanë shkaktuar vështirësi dhe paqartësi mes palëve të përfshira në auditim.

Një sistem i definuar qartë i raportimit i mundëson institucioneve publike regjistrimin, monitorimin, auditimin dhe vlerësimin e performancës së NP-ve, si dhe mbikëqyrjen e tyre në pajtueshmëri me standardet e qeverisjes së korporatave.

Rekomandimet për Kuvendin e Kosovës dhe Aksionarët e NP-ve

- Aksionarët e Ndërmarrjeve Publike duhet të sigurojnë që kanë iniciuar rishikimin e kornizës aktuale ligjore e cila ndërlidhet me NP-të me qëllim të amendamentimit dhe sinkronizimit të ligjeve dhe kërkesave në fushën e raportimit dhe të auditimit të NP-ve; dhe
- Rekomandojmë Kuvendin e Kosovës të bëj trajtimin e amendamenteve ligjore të kësaj fushe për t’i mundësuar institucioneve publike kryerjen e mandatit të tyre kushtetues dhe ligjor.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për “Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit”.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin "Theksim i Çështjes" ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Opinionet e auditimit dhe rekomandimet kryesore

Tabela 1. Opinionet e Auditimit dhe rekomandimet kryesore për Institucionet Shtetërore

1.1 Opinionet e pa modifikuara		
Entiteti	Buxheti (në mil.€)	Përmbledhje e rekomandimeve kryesore për menaxhmentin e subjekteve të audituara
Administrata Tatimore	8.42	Të sigurohet aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; Të sigurohet ndërmarrja e veprimeve për funksionalizimin e plotë të strukturës organizative; Të analizohen dhe adresohen dobësitë e kontrolleve mbi të hyra, paga, si dhe mallra dhe shërbime.
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	31.12	Të sigurohet se procesi i përgatitjes së PFV-ve përfshinë një rishikim formal dhe efektiv nga menaxhmenti; Të sigurohet aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; Të përmirësohen aranzhimet e llogaridhënies; Të analizohen dhe adresohen dobësitë e kontrolleve në fushat e menaxhimit të projekteve kapitale, të prokurimit, dhe menaxhimit të pasurive.
Ministria e Forcave të Sigurisë së Kosovës	46.96	Të sigurohet dhe adresohet në vazhdimësi zbatimi i plotë të rekomandimeve të AP-së dhe adresimi i dobësive të kontrolleve në planifikim, prokurim dhe personel.
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	366.00	Të sigurohet një rishikim formal dhe efektiv i procesit të përgatitjes së PFV-ve; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe të zbatohet procesi i vetëvlerësimit; përmirësimi i aranzhimeve të llogaridhënies dhe raportimit menaxherial; adresimi i dobësive në kontrollet mbi fushën e subvencioneve dhe transfereve, prokurimit, dhe pagave e mëditjeve.
Ministria për Integritet Evropian	1.71	Të sigurohet aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; emërimi i Komitetit të ri të Auditimit; të adresohen dobësitë në fushën e menaxhimit të subvencioneve, personelit dhe obligimeve.
Administrata e Kuvendit	9.58	Të sigurohen veprime shtesë për eliminimin e mangësive në subvencione dhe pasuri.
Zyra e Presidentit	2.05	Të sigurohet aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; të adresohen mangësitë në kontrollet në prokurim, në procedimin e pagesave, dhe në menaxhimin e obligimeve.

1.2 Opinionet e pa modifikuara me theksim të çështjes			
Entiteti	Buxheti (në mil.€)	Arsyeja për theksimin e çështjes	Përmbledhje e rekomandimeve kryesore për menaxhmentin e subjekteve të audituara
Ministria e Financave	8.85	Shpenzimet për anëtarësim në Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës janë buxhetuar dhe paguar gabimisht nga mallrat dhe shërbimet.	Të analizohen shkaqet për theksimin e çështjes dhe të përpilohet një plan veprimi për prezantim të drejtë në klasifikimin e shpenzimeve; të sigurohet aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; të analizohen dhe adresohen mangësitë e kontrollit në fushat brengosëse të theksuara në këtë raport.
Doganat	8.05	Shpalosjet e llogarive të arkëtueshme nuk janë plotësisht të sakta dhe të besueshme.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të ndërmerren veprimet për prezantim të drejtë të llogarive të arkëtueshme; të analizohet aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; shkaqet e keq-klasifikimit, mos respektimi i procedurave buxhetore, dhe monitorimi i performancës buxhetore; dhe dobësitë e kontrolleve në menaxhimin e të hyrave.
Ministria e Administratës Publike	16.18	Shpenzimet për mirëmbajtjen e sistemeve të TI ishin buxhetuar dhe paguar gabimisht nga investimet kapital. Gjithashtu, kishte mbivlerësim të pasurive kapitale dhe stoqeve.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes, dhe identifikoni veprimet për prezantim të drejtë dhe të vërtetë të shpenzimeve dhe të pasurisë; të sigurohet aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; përmirësimi i aranzhimeve llogaridhënëse dhe të raportimit menaxherial; aplikimi i një vlerësimi të detajuar të menaxhimit të projekteve kapitale, prokurimit, menaxhimit të pasurive dhe detyrimeve.
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	5.42	Mbivlerësimi i pasurive kapitale.	Të analizohen arsyet e theksimit të çështjes dhe prezantimi i drejtë dhe i vërtetë i gjendjes së pasurisë; të sigurohet që plani i veprimit rishikohet dhe përcakton saktë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatim të rekomandimeve nga AP; dhe vlerësimi i detajuar i fushave brengosëse të theksuara në këtë raport.

Ministria e Drejtësisë	18.60	Shpalosjet e pasurive nuk janë plotësisht të sakta dhe të besueshme.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurisë; të sigurohet aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; monitorimi i arsyeve të realizimit të ulët të buxhetit; të ndërmerren veprime për ndërprerjen e pozitive menaxheriale me ushtrues detyre përtej afatit ligjor.
Ministria e Punëve të Brendshme	106.52	Shpenzimet për mallra dhe shërbime ishin buxhetuar dhe paguar gabimisht nga investimet kapitale.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes, dhe identifikohen veprimet për prezantim të drejtë dhe të vërtetë të shpenzimeve në PFV; të sigurohet që Drejtorët e Përgjithshëm të Agjencive kanë deleguar përgjegjësinë e drejtpërdrejt për menaxhimin e rrezikut; të ndërmerren veprime për ndërprerjen e pozitive menaxheriale me ushtrues detyre përtej afatit ligjor; dhe forcimi i mekanizmave për menaxhim më të mirë të subvencioneve.
Ministria e Shëndetësisë	52.99	Shpalosjet e pasurive dhe stokut farmaceutik nuk janë të sakta.	Të analizohen shkaqet e theksimit të çështjes dhe identifikohen veprimet për prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurisë dhe stoqeve në vitin 2017; të sigurohet se procesi i përgatitjes së PFV-ve përfshinë një rishikim menaxherial formal dhe efektiv; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; përmirësimi i aranzhimeve llogaridhënëse, menaxhimi i rrezikut dhe organizimi i brendshëm; dhe mangësitë e kontroleve mbi prokurimin.
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	43.62	Pasuria fikse e shpalosur në PFV ishte mbivlerësuar.	Të analizohen shkaqet e theksimit të çështjes dhe identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të shpenzimeve dhe pasurisë në vitin 2017; të sigurohet aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; përmirësimi i llogaridhënies dhe cilësisë së raportimit menaxherial; dhe mangësitë e kontrollit mbi menaxhimin e investimeve, mallrave, pagave, menaxhimit të pasurive dhe detyrimeve.

Ministria e Punëve të Jashtme	18.75	Mos mbyllja e shpenzimeve për mallra e shërbime nga Misionet Diplomatike të Kosovës dhe mos regjistrimi i pasurisë në sistemet elektronike përkatëse.	Të analizohen arsyet për theksimin e ëështjes, dhe identifikimi veprimeve për prezantim të drejtë dhe të vërtetë të shpenzimeve në PFV; ndërmarrja e veprimeve për hartimin e planit strategjik, hartimin e regjistrimit të rreziqeve; formimi i Komitetit të Auditimit; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së.
Zyra e Kryeministrit	12.37	Keq klasifikim i shpenzimeve nga investimet kapitale për mallra e shërbime dhe subvencione, si dhe mungesa e dëshmive për arsyetimin e shpenzimeve të subvencioneve.	Të analizohen arsyet për theksim të çështjes dhe të sigurohet se shpenzimet për subvencione janë dokumentuar, klasifikuar në kategoritë adekuate, duke siguruar prezantim të drejtë në PFV-të e vitit 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; dhe adresimi i mangësive të kontrolleve në prokurim.
Ministria për Kthim dhe Komunitete	8.63	Mos shpalosje e pasurive kapitale në PFV.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe ndërmerren veprimet për të siguruar prezantim të drejtë dhe të vërtetë të PFV-ve për vitin 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatimi i procesit të vetëvlerësimit; vlerësimi i detajuar për planifikim dhe ekzekutim të buxhetit; dhe adresimi i mangësive të kontrolleve të menaxhimit dhe raportimit të pasurisë.
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	54.97	Keq klasifikim i shpenzimeve dhe prezantim jo i saktë i pasurive.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe identifikohen veprimet për prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurisë; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatimi i procesit të vetëvlerësimit; dhe adresimi i mangësive lidhur me shërbimet dhe subvencionet.

Ministria e Infrastrukturës	214.00	Shpenzimet për mallra dhe shërbime ishin keq klasifikuar; buxheti final në PFV ishte mbivlerësuar; dhe vlera e pasurive dhe llogarive të arkëtueshme nuk ishte e saktë.	Të analizohen shkaqet për theksimin e çështjes me qëllim të prezantimit të drejtë dhe të saktë të shpenzimeve gjatë përgatitjes së PFV-ve 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatimi i procesit të vetëvlerësimit në mënyrë aktive; përmirësimi i llogaridhënies dhe cilësisë së raportimit menaxherial; dhe adresimi i dobësive të kontrolleve në prokurim, pasuri dhe llogari të arkëtueshme.
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	39.36	Shpalosjet e pasurive jo-financiare dhe obligimeve të papaguara nuk janë të besueshme dhe të sakta.	Të analizohen arsyet për përsëritjen e theksimit të çështjes dhe veprimet për prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurisë dhe obligimeve; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatimi i procesit të vetëvlerësimit në mënyrë aktive; përmirësimi i llogaridhënies dhe cilësisë në raportimin menaxherial; dhe adresimi i mangësive në prokurim.

1.3 Opinioni i kualifikuar

Entiteti	Buxheti (në mil.€)	Arsyeja për kualifikimin e opinionit	Përmbledhje e rekomandimeve kryesore për menaxhmentin e subjektit të audituar
Ministria e Diasporës	1.78	Subvencionet janë paguar dhe raportuar nga kategoria mallra dhe shërbime.	Të analizohen arsyet për modifikimin e opinionit dhe të identifikohen veprimet për një prezantim të drejtë dhe të vërtetë në vitin 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP; dhe adresimi i mangësive të kontrolleve në menaxhimin e buxhetit për mallra dhe shërbime, si dhe në monitorimin e subvencioneve.
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	5.01	Mbivlerësimi i saldoeve fillestare të pasurive kapitale.	Të analizohen arsyet për kualifikimin e opinionit dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurisë; përmirësimi i procesit të vetëvlerësimit dhe rekomandimet të adresohen në mënyrë aktive dhe në baza të rregullta.

1.4 Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes			
Entiteti	Buxheti (në mil.€)	Arsyeja për kualifikimin e opinionit/theksimin e çështjes	Përmbledhje e rekomandimeve kryesore për menaxhmentin e subjektit të audituar
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	19.94	Keq klasifikimi i shpenzimeve në kategori të ndryshme ekonomike; pagesa e punëtorëve sipas vendimit të shfuqizuar të Qeverisë; dhe vlera e pa saktë e pasurive jo financiare.	Të analizohen arsyet për Kualifikim të Opinionit dhe theksimin e çështjes, dhe të ndërmerren veprimet për klasifikim të duhur të shpenzimeve dhe prezantimin e saktë të pasurisë; procesi i përgatitjes së PFV të vitit 2017 përfshinë një rishikim menaxherial formal dhe efektiv; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; përmirësimi i aranzhimeve të llogaridhënies dhe raportimit menaxherial; dhe aplikimi i një vlerësimi të detajuar të subvencioneve dhe fushave tjera brengosëse.

Tabela 2. Opinionet e Auditimit dhe rekomandimet kryesore për Komuna

2.1. Opinion i pa modifikuar		
Entiteti	Buxheti (në mil.€)	Përmbledhje e rekomandimeve kryesore për menaxhmentin e subjekteve të audituara
Vitia	9,49	Të sigurohet se procesi i përgatitjes së PFV për 2017 përfshinë një rishikim menaxherial formal dhe efektiv; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatimi i procesit të vlerësimit të rreziqeve dhe plani strategjik në mënyrë aktive; adresimi i dobësive të kontrolleve mbi klasifikimin e shpenzimeve, monitorimin e subvencioneve, raportimin e investimeve kapitale dhe në sistemin e prokurimit.

2.2. Opinonet e pa modifikuara me theksim të çështjes			
Entiteti	Buxheti (në mil.€)	Arsyeja për theksimin e çështjes	Përmbledhje e rekomandimeve kryesore për menaxhmentin e subjekteve të audituara
Prishtinë	65.88	Klasifikimi i shpenzime në kode jo adekuate; Mos evidentimi i pronave në regjistrin kontabël.	Të analizohen arsyet për theksim të çështjes dhe adresohen veprimet që të njëjtat të mos përsëriten; çështjet e dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme, në veçanti auditimi i brendshëm; të shqyrtohen arsyet për planifikim të dobët të buxhetit veçanërisht investimet kapitale; evidentimi dhe pagesa e detyrimeve brenda afateve ligjore; dhe regjistrimi i llogarive të arkëtueshme për taksat në biznes.
Fushë Kosovë	8.58	Keq klasifikimi i shpenzimeve dhe mos regjistrimi i të gjitha pasurive.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të sigurohet një rishikim formal dhe efektiv për të siguruar prezantim të drejtë të PFV-ve për 2017; çështjet e dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme; dhe adresimi i mangësive të kontrolleve mbi prokurimin dhe menaxhimin e pasurisë.
Obiliq	5.27	Mos prezantimi i pagesave nga palët e treta në PFV; keq klasifikimi i shpenzimeve; dhe regjistri kontabël i pasurisë jo saktë.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe sigurohet një rishikim formal dhe efektiv për të siguruar prezantim të drejtë të PFV-ve për 2017; çështjet e dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme; Analiza dhe adresimi i mangësive të kontrolleve mbi prokurimin, dhe menaxhimin e pasurisë.
Podujevë	18.45	Shpalosjet për të hyrat vetjake dhe llogaritë e arkëtueshme ishin me gabime; dhe mungon regjistri i saktë pasurive.	Të analizohen arsyet e theksimit të çështjeve, dhe identifikohen veprimet për prezantim të drejtë dhe të vërtetë në vitin 2017; vendosja e proceseve efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha kërkesat e raportimit financiar; analiza dhe adresimi i mangësive të kontrolleve në prokurim dhe fushave tjera brengosëse; aranzhimet e llogaridhënies dhe cilësia e raportimit menaxherial.
Mitrovicë	15.96	Mos regjistrimi i plotë i pasurisë; Mospranimi i raportit për progresin e punëve të kryera nga pagesa në avans.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe sigurohet një rishikim formal dhe efektiv për të siguruar prezantim të drejtë të PFV-ve për 2017; përmirësimi i proceseve llogaridhënëse dhe raportimit menaxherial; analiza dhe adresimi i mangësive të kontrolleve mbi prokurimi dhe fushat tjera.

Graçanicë	6.08	Tejkalim i limitit të përcaktuar sipas ligjit të buxhetit 2016 (mbi 15%), për pagesat në avanc për investime kapitale; dhe mos regjistrimi i pasurive në regjistra kontabël dhe mos shpalesje në PFV.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të sigurohet një rishikim formal dhe efektiv për të siguruar prezantim të drejtë të PFV-ve për 2017; të adresohen çështjet e dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme, prokurimit dhe fushave tjera.
Zubin Potok	1.89	Mos regjistrimi dhe shpalesja pasurive në PFV; keq klasifikimi i shpenzimeve të investimeve kapitale për pagesën e pagave; dhe kontratat e punës jo valide.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të sigurohet një rishikim formal dhe efektiv për të siguruar prezantim të drejtë të PFV-ve për 2017; dhe të adresohen çështjet e dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme, prokurimit, pagave, dhe investimeve kapitale.
Shtërpcë	3.12	Mos regjistrimi i pasurive në regjistrin kontabël.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjeve në 2016 dhe identifikohen veprimet e duhura për prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurisë dhe të arkëtueshmeve; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe adresimi i çështjeve të dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme.
Shtime	6.01	Pasuritë ishin nënvlerësuar.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të sigurohet një rishikim formal dhe efektiv për të siguruar prezantim të drejtë të PFV-ve për 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; hartimi dhe menaxhimi i regjistrit për rreziqe; dhe procesi i regjistrimit të gjitha pasurive.
Lipjan	13.07	Pagesa të parregullta për servisim dhe mirëmbajtje të automjeteve dhe llogaritë e arkëtueshme ishin nënvlerësuar.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet e duhura për një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të informatave në PFV; aplikimi e një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; vlerësimi gjithëpërfshirës i planifikimeve buxhetore; dhe adresimi i mangësive të kontroleve mbi pasuritë, dhe llogaritë e arkëtueshme.

Prizren	40.63	Keq klasifikim i shpenzimeve dhe regjistri i pasurive jo i plotë.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të shpenzimeve dhe pasurisë në 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; Përmirësimi i aranzhimeve llogaridhënëse dhe cilësia e raportimit menaxherial; dhe adresimi i mangësive të kontrolleve mbi prokurimin dhe menaxhimin e pasurive.
Suharekë	13.31	Keq klasifikim i shpenzimeve dhe prezantim jo saktë i pasurive nën 1,000€.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikoni veprimet për prezantim të drejtë të shpenzimeve dhe pasurisë në 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; hartimi i një regjistri të rreziqeve dhe plani i veprimit për menaxhimin e tyre; vlerësimi dhe analiza e burimeve potenciale të të hyrave.
Dragash	6.90	Prezantim jo i saktë i pasurive nën 1,000€ në PFV.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të pasurisë në 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe adresimi i çështjeve të dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme, prokurimi dhe menaxhimi i pasurive.
Malishevë	12.36	Keq klasifikim i shpenzimeve dhe mos përfshirje në regjistrin kontabël të një pjesë të pasurive të pa luajtshme; si dhe mbivlerësim të pasurive.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të shpenzimeve dhe pasurisë në 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatimi i procesit të vetëvlerësimit; dhe adresimi i mangësive të kontrolleve mbi prokurimin, menaxhimi e pasurive, subvencioneve, dhe llogarive të arkëtueshme.
Mamusha	1.51	Mos regjistrim dhe prezantim të pasurive në PFV dhe keq klasifikim i shpenzimeve.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të shpenzimeve dhe pasurisë në vitin 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatimi i procesit të vetëvlerësimit; dhe adresimi i mangësive të kontrolleve në prokurim, menaxhim të pasurive dhe subvencioneve.

Rahovec	11.39	Regjistri kontabël i pasurive jo i plotë; dhe keq klasifikimi i shpenzimeve.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të shpenzimeve dhe pasurisë në vitin 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe adresimi i çështjeve të dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme, prokurimi dhe menaxhimi i pasurive.
Kamenicë	7.25	Mos regjistrim i pasurive të financuara nga donatorët si dhe pasurisë tjetër.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të shpenzimeve dhe pasurisë në vitin 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe adresimi i çështjeve të dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme, prokurimi, të hyrat dhe menaxhimi i pasurive.
Gjilan	21.35	Mos regjistrimi apo regjistrimi i gabuar i pasurive.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të shpenzimeve dhe pasurisë në vitin 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe adresimi i çështjeve të dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme, prokurimi, të hyrat, pagat, subvencionet dhe menaxhimi i pasurive.
Kaçanik	6.63	Keq klasifikimi i shpenzimeve.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të shpenzimeve në PFV të vitit 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatimi i procesit të vetëvlerësimit; përmirësimi i aranzhimeve llogaridhënese dhe raportimit menaxherial; hartimi i planit strategjik gjithëpërfshirës dhe regjistri i rreziqeve; dhe adresimi i mangësive të kontrolleve mbi prokurimin.
Han i Elezit	2.11	Regjistri e pasurive jo i plotë dhe keq klasifikimi i shpenzimeve.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të shpenzimeve dhe pasurisë në vitin 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe adresimi i çështjeve të dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme dhe prokurimi.

Novobërdë	1.97	Regjistri i pasurive jo i plotë; keq klasifikim i shpenzimeve; dhe mbivlerësimi i të hyrave vetjake për bartje në vitin e ardhshëm.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të shpenzimeve dhe pasurisë në vitin 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe adresimi i çështjeve të dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme, prokurimi dhe menaxhimi i pasurive.
Partesh	0.84	Mos regjistrim dhe mos prezantim i pasurive në PFV; dhe mungesa e regjistrimit të llogarive të arkëtueshme.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë pasurisë në 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatimi i procesit të vetëvlerësimit; përmirësimi i aranzhimeve llogaridhënëse dhe raportimit menaxherial; dhe adresimi i mangësive të kontrolleve mbi menaxhimin e pasurisë.
Ranillug	1.47	Nënvlerësim i llogarive të arkëtueshme dhe mbivlerësim i pasurive.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë llogarive të arkëtueshme në 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe adresimi i çështjeve të dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme, prokurimi, llogaritë e arkëtueshme dhe menaxhimi i pasurisë.
Ferizaj	25.29	Mos përfshirja e plotë e pasurisë në regjistrin e pasurisë dhe në PFV; dhe keq klasifikimi i shpenzimeve.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të shpenzimeve dhe pasurisë në vitin 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe adresimi i çështjeve të dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme dhe prokurimi.
Gjakovë	19.97	Mos regjistrimi i pronës në regjistrin e pasurisë në SIMFK.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të shpenzimeve dhe pasurisë në vitin 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe adresimi i çështjeve të dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme dhe prokurimi.
Junik	1.21	Regjistri i pasurive jo i plotë.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të pasurisë në vitin 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe adresimi i çështjeve të dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme dhe prokurimi.

Pejë	20.72	Nënvlerësimi gjendjes së pasurive; dhe nënvlerësimi i llogarive të arkëtueshme.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të pasurisë dhe llogarive të arkëtueshme në vitin 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe adresimi i çështjeve të dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme dhe prokurimi, llogaritë e arkëtueshme, obligimet dhe menaxhimi i pasurisë.
Istog	8.80	Nënvlerësim i pasurive mbi 1,000€ dhe llogarive të arkëtueshme.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të pasurisë dhe llogarive të arkëtueshme në vitin 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe adresimi i çështjeve të dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme, prokurimi dhe menaxhimi i pasurisë.
Klinë	8.33	Regjistri i e-pasurisë jo i saktë.	Të analizohen arsyet e theksimit të çështjeve dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë dhe të vërtetë në vitin 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatimi i procesit të vetëvlerësimit; përmirësimi i aranzhimeve llogaridhënëse dhe raportimit menaxherial; dhe adresimi i mangësive të kontrolleve mbi prokurimin dhe menaxhimin e pasurisë.
Drenas	12.71	Regjistri i pasurisë mbi 1,000€ është i mbivlerësuar; regjistri i pasurisë nën 1,000€ dhe llogaritë e arkëtueshme janë nënvlerësuar.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të pasurisë dhe llogarive të arkëtueshme në 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe adresimi i çështjeve të dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme dhe prokurimi, të hyrat dhe menaxhimi i pasurisë.
Skenderaj	11.28	Regjistri i pasurisë nën dhe mbi 1000€, dhe llogaritë e arkëtueshme janë nënvlerësuar.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të pasurisë dhe llogarive të arkëtueshme në 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; monitorimi i buxhetit në mënyrë sistematike; dhe adresimi i mangësive të kontrolleve mbi prokurimin, të hyrat dhe menaxhimin e pasurisë.

Vushtrri	14.72	Mungesa e raportit për përdorimin e mjeteve nga pagesat në emër të bashkëfinancimit me Lux-Dev; mbivlerësimi i pasurive mbi 1,000€, dhe nënvlerësimi i llogarive të arkëtueshme.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të shpenzimeve, pasurisë dhe llogarive të arkëtueshme në 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe adresimi i çështjeve të dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme dhe prokurimi, të hyrat dhe menaxhimi i pasurisë.
----------	-------	--	---

2.3. Opinionet e kualifikuara me theksim të çështjes

Entiteti	Buxheti në mil.€	Arsyeja për kualifikimin e opinionit/theksimi i çështjes	Përmbledhje e rekomandimeve kryesore për menaxhmentin e subjektit të audituar
ZAMV/ Mitrovica e Veriut	5.85	Tejkalim i limit të përcaktuar sipas ligjit të buxhetit (mbi 15%), për pagesat në avanc për investime kapitale; dhe mos regjistrimi i pasurive në regjistra kontabël dhe shpalosjet në PFV.	Të analizohen arsyet për kualifikim të opinionit dhe theksimin e çështjes dhe identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të shpenzimeve dhe pasurisë në 2017; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe adresimi i çështjeve të dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme, prokurimi, subvencionet ,të hyrat dhe menaxhimi i pasurisë.
Zveçan	2.21	Tejkalim i limit të përcaktuar sipas ligjit të buxhetit (mbi 15%), për pagesat në avanc për investime kapitale dhe mungesa e raporteve konfirmuese për mënyrën shpenzimit.	Të analizohen arsyet për kualifikim të opinionit dhe theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të shpenzimeve dhe pasurisë në 2017; procesi i përgatitjes së PFV-ve të përfshi një rishikim formal dhe efektive nga menaxhmenti; të aplikohet një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe të adresohen çështjet e dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme dhe prokurimi, subvencionet, të hyrat dhe menaxhimi i pasurisë.

Leposaviq	4.52	Tejkalim i limit të përcaktuar sipas ligjit të buxhetit (mbi 15%), për pagesat në avanc për investime kapitale dhe mungesa e raporteve konfirmuese për mënyrën shpenzimit; mos regjistrimi i pasurive në SIMFK; dhe kontratat jo valide të punës.	Të analizohen arsyet për kualifikim të opinionit dhe theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të shpenzimeve dhe pasurisë në 2017; të aplikohet një proces formal i monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe të adresohen çështjet e dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme, pagat, prokurimi, investimet kapitale, subvencionet, të hyrat dhe menaxhimi i pasurisë.
Kllokot	0.89	Keq klasifikimi i shpenzimeve dhe mos regjistrimi i pasurive në SIMFK.	Të analizohen arsyet për kualifikim të opinionit dhe theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të shpenzimeve dhe pasurisë në 2017; që procesi i përgatitjes së PFV-ve të përfshi një rishikim formal dhe efektiv nga menaxhmenti; të aplikohet një proces formal i monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe të adresohen çështjet e dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme dhe prokurimi, të hyrat, llogaritë e arkëtueshme, obligimet dhe menaxhimi i pasurisë.
Deçan	7.16	Prezantimi i gabimeve në pasqyrat primare të PFV; Regjistri i pasurive jo i plotë; dhe keq klasifikim i shpenzimeve.	Të analizohen arsyet për kualifikim të opinionit dhe theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të PFV në 2017; që procesi i përgatitjes së PFV-ve përfshinë një rishikim formal dhe efektiv nga menaxhmenti; të aplikohet një proces formal i monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe të zbatohet procesi i vetëvlerësimit; përmirësimi i aranzhimeve llogaridhënëse dhe raportimit menaxherial; dhe adresimi i mangësive të kontroleve në prokurim dhe menaxhim të pasurisë.

Tabela 3. Opinonet e Auditimit dhe rekomandimet kryesore për Institucionet e Pavarura

3.1 Opinonet e pa modifikuara		
Entiteti	Buxheti (në mil.€)	Përmbledhje e rekomandimeve kryesore për menaxhmentin e subjekteve të auditura
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës	0.31	Të sigurohet se procesi i përgatitjes së PFV-ve përfshinë një rishikim formal dhe efektiv nga menaxhmenti; Të hartohet plani i veprimit të strategjisë; dhe të adresohen dobësitë e kontrolleve mbi menaxhimin e shpenzimeve dhe të pasurisë.
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	1.31	Të sigurohet se procesi i përgatitjes së PFV-ve përfshinë një rishikim formal dhe efektiv nga menaxhmenti; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; hartimi i një regjistri të rreziqeve dhe plani i veprimit të menaxhimit të tyre; dhe adresimi i dobësive të kontrolleve mbi menaxhimin e të arkëtueshmeve dhe ndërprerjen e aktiviteteve ilegale.
Gjykata Kushtetuese e Kosovës	1.50	Të analizohen dhe adresohen dobësitë e kontrolleve mbi kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, shërbimet e veçanta dhe menaxhimin e pasurisë.
Instituti Gjyqësor i Kosovës	0.57	Të sigurohet hartimi i strategjisë gjithëpërfshirëse institucionale dhe të definohen indikatorët për monitorimin e arritjes së objektivave; të sigurohen veprime për ndërprerjen e mbulimit të pozitive menaxheriale me ushtrues detyre përtej afatit ligjor; dhe të adresohen dobësitë e kontrolleve mbi menaxhimin e pasurisë.
Institucioni i Avokatit të Popullit	1.40	Të sigurohet aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së.
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	0.35	Të sigurohet aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; të hartohet plani i veprimit për menaxhimin e rrezikut; dhe të adresohen dobësitë e kontrolleve mbi menaxhimin e shpenzimeve, pasurisë dhe obligimeve.
Agjencia Kundër Korrupsionit	0.50	Të sigurohet aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe të zbatohet procesi i vetëvlerësimit.
Autoriteti i Aviacionit Civil	0.93	Të analizohen dhe adresohen dobësitë e kontrolleve mbi menaxhimin e të hyrave, pasurisë dhe obligimeve.
Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor	0.20	Të sigurohet zbatimi i mekanizmit të rishikimit në plotësimin e pyetësorit të vet-vlerësimit, dhe strategjinë gjithëpërfshirëse institucionale; të iniciohen procedurat e emërimit të Udhëheqësit Ekzekutiv; dhe përgatitja dhe monitorimi i buxhetit në mënyrë sistematike.
Akademia e Shkencave dhe Arteve	1.19	Të hartohet plani strategjik gjithëpërfshirës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit	0.33	Të sigurohet aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe të zbatohet procesi i vetëvlerësimit; dhe të adresohen dobësitë e kontrolleve mbi menaxhimin e shpenzimeve dhe pasurisë.
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	5.43	Të sigurohet aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe të zbatohet procesi i vetëvlerësimit; të rishikohen rregullimet ekzistuese për të siguruar që struktura organizative e SKQZ-së është në pajtim me Rregulloret në fuqi; dhe të adresohen dobësitë e kontrolleve mbi menaxhimin e pagave, procedimin e pagesave dhe menaxhimin e pasurisë.
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa	0.21	Të hartohet lista e rreziqeve; të sigurohet se vendimet për kompensimet e punonjësve bëhen mbi bazën ligjore në fuqi; dhe vlera e pasurisë paraqitet saktë në PFV.
Agjencia Kosovar për Krahasim dhe Verifikim të Pronës	2.00	Të sigurohet se procesi i përgatitjes së PFV-ve përfshinë një rishikim formal dhe efektiv nga menaxhmenti; aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe zbatimi i procesit të vetëvlerësimit; përmirësimi i çështjeve të dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme, menaxhimi i personelit dhe të hyrat.
Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	0.30	Të sigurohet që pagesat ekzekutohen vetëm duke u bazuar në fatura të rregullta në pajtim me kërkesat ligjore.
Zyra e Rregullatorit të Energjisë	0.74	Të sigurohet aplikimi i një procesi formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; të adresohen çështjet e dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme, menaxhimi i personelit, investimet kapitale dhe menaxhimi i pasurisë.

3.2. Opinionet e Pamodifikuara me Theksim të Çështjes		
Entiteti	BuxhetArsyeja për kualifikim të opinionit (në mil.€)	Përmbledhja e rekomandimeve kryesore për menaxhmentin e subjekteve të audituara
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	20.75	Shpalosjet e pasurive jo plota dhe të sakta.
Këshilli Prokurorial i Kosovës	8.33	Shpalosjet e pasurive nuk janë plotësisht të sakta dhe të besueshme.
Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës	2.44	Keq klasifikimi i shpenzimeve dhe mbivlerësimi i pasurisë.
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës	69.65	Shpalosja e pasurive dhe stoqeve jo e saktë në PFV; keq klasifikim i shpenzimeve dhe pagesa në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.
		Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të ndërmerren veprimet për të siguruar plotësinë, saktësinë dhe prezantim të drejtë të pasurisë në vitin 2017; të aplikohet një proces formal i monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së, NJAB-së; të përmirësohen çështjet e dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme, personeli, shpenzimet, dhe menaxhimi i pasurisë.
		Të analizohen arsyet e theksimit të çështjes dhe të ndërmerren veprimet për prezantim dhe shpalosje të drejtë të pasurisë në PFV-të e vitit 2017; të aplikohet një proces formal i monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së, të përmirësohen aranzhimet e llogaridhënies dhe cilësia e raportimit menaxherial; dhe të adresohen pagesat për anëtarët e këshillit, pagesat për punë shtesë, dhe menaxhimi i pasurive, në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin.
		Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të shpenzimeve dhe pasurisë në vitin 2017; të hartohet strategjia e zhvillimit dhe të vendosen procese adekuate për menaxhimin dhe monitorimin e rrezikut; dhe të adresohen mangësitë e kontrolleve mbi menaxhimin e shpenzimeve.
		Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të sigurohet një rishikim formal dhe efektiv për të siguruar prezantim të drejtë të shpenzimeve dhe pasurisë në PFV të vitit 2017; Të adresohen çështjet e dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme; dhe të adresohen mangësitë e kontrolleve mbi menaxhimin e buxhetit, prokurimin, të hyrat, pagat dhe mëditjet, pasuritë dhe menaxhimin e barnave.

Universiteti i Prishtinës	28.15	Shpalosje jo e saktë e pasurive dhe stoqeve dhe keq klasifikimi i shpenzimeve.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të sigurohet një rishikim formal dhe efektiv për të siguruar prezantim të drejtë të shpenzimeve dhe pasurisë në PFV të vitit 2017; Të aplikohet një proces formal i monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe të adresohen çështjet e dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme; të rritet efektiviteti i shërbimeve nga Auditimi i Brendshëm; dhe të adresohen mangësitë e kontrolleve mbi menaxhimin e buxhetit, prokurimit, shpenzimet e pagave dhe menaxhimin e pasurive.
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	0.78	Projekti e-prokurimi gabimisht ishte buxhetuar dhe shpenzuar nga mallrat dhe shërbimet, dhe mos regjistrim në regjistrat e pasurisë.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të shpenzimeve dhe pasurisë në 2017; Të aplikohet një proces formal i monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; dhe të adresohen mangësitë e kontrolleve mbi menaxhimin e pasurisë.
Komisioni i Pavarur i Mediave	1.05	Mos shpalosje e pasurisë jo kapitale në PFV.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të shpenzimeve dhe pasurisë në 2017; të aplikohet një proces formal të monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; të adresohet në mënyrë efektive menaxhimi i rreziqeve; dhe të adresohen mangësitë e kontrolleve mbi menaxhimin e buxhetit, të hyrat dhe menaxhimi i pasurive.
Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit	0.36	Llogaritë e arkëtueshme ishin mbivlerësuar.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të llogarive të arkëtueshme në 2017; të aplikohet një proces formal i monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së; të zbatohet procesi i vetëvlerësimit; dhe të adresohen mangësitë e kontrolleve mbi menaxhimin e të hyrave, të personelit, mallrave dhe shërbimeve dhe të pasurisë.

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	0.29	Parregullsitë në paga; mos shpalosjet e buxhetit final; avancet e pambyllura; dhe vlera e stoqeve dhe e detyrimeve jo e plotë dhe e saktë.	Të sigurohet se procesi i përgatitjes së PFV-ve përfshinë një rishikim formal dhe efektiv nga menaxhmenti; që procesi i vetëvlerësimit dhe menaxhimi i rrezikut adresohen në mënyrë efektive; dhe rishikimi kritik i aranzhimeve të qeverisjes në fushën e planifikimit strategjik.
Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	0.80	Shpalosjet e llogarive të arkëtueshme në PFV ishin nënvlerësuar, ndërsa pasuria jokapitale ishte mbivlerësuar.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të llogarive të arkëtueshme dhe pasurisë në 2017; të përgatitet Statuti dhe Rregullorja e re e Punës; dhe të adresohen mangësitë e kontrolleve mbi menaxhimin e shpenzimeve, personelit dhe llogarive të arkëtueshme.
Agjencia për Shërbime të Navigacionit Ajror	2.81	Buxheti final për paga e mëditje dhe burimet e fondeve të shpenzuara ishin nënvlerësuar, dhe mos shpalosje e plotë e pasurive.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të PFV në 2017; që procesi i përgatitjes së PFV-ve përfshinë një rishikim formal dhe efektiv nga menaxhmenti; të aplikohet një proces formal i monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe të zbatohet procesi i vetëvlerësimit; dhe të adresohen mangësitë e kontrolleve mbi pranimet dhe shpenzimet, menaxhimin e pasurisë, zbatimin e kontratave dhe administrimin e obligimeve.
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	0.22	Burimi dhe shfrytëzimi i fondeve në pasqyrën e pranimeve dhe pagesave ishte mbivlerësuar; mos prezantim i të hyrave në raportin e ekzekutimit të buxhetit; dhe nënvlerësimi i pasurive jo-kapitale.	Të analizohen arsyet për theksimin e çështjes dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë të PFV në 2017; të aplikohet një proces formal i monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe të zbatohet procesi i vetëvlerësimit.

3.3 Opinionet e Kualifikuara			
Entiteti	Buxheti (në mil.€)	Arsyeja për kualifikim të opinionit	Përmbledhja e rekomandimeve kryesore për menaxhmentin e subjekteve të audituara
Agjencia Kosovare e Privatizimit	8.97	Mbivlerësimi i realizimit për të hyrat e dedikuara të hyrja e parasë së gatshme në llogarinë e thesarit në tabelën e dytë të PFV-së "Raporti i ekzekutimit të Buxhetit".	Të analizohen arsyet për Kualifikim të Opinionit dhe të adresohen veprimet për prezantim të drejtë për vitin 2017; të aplikohet një proces formal i monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të AP-së dhe të zbatohet procesi i vetëvlerësimit; të përmirësohen aranzhimet e llogaridhënies dhe raportimit menaxherial; dhe të adresohen mangësitë e kontrolleve mbi fushën e planifikimit të buxhetit, prokurimit, pagave, pasurive dhe detyrimeve.
Fondi I Privatizimit	39.52	Pagesat për ofruesin e shërbimeve profesionale nga Fondet në Mirëbesim jo të bazuara në ligjin e AKP-së.	Të ndërmerren veprimet e nevojshme që pagesat e ofruesit të shërbimeve profesionale të bëhen nga buxheti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Tabela 4. Opinionet e Auditimit dhe rekomandimet kryesore për Ndërmarrje Publike

4.1 Opinionet e Kualifikuara			
Entiteti	Buxheti (në mil.€)	Arsyeja për kualifikim të opinionit	Përmbledhja e rekomandimeve kryesore për menaxhmentin e subjekteve të audituara
Ngrohtorja e Qytetit Gjakovë Sh.a.	0.74	Llogaria e arkëtueshme jo e saktë dhe e plotë; prezantim jo i saktë i detyrimeve për tatimin në korporata; mospërputhje e detyrimeve të paguara me faturat sipas furnitorit; dhe regjistri jo i plotë i pasurisë.	Të analizohen arsyet për kualifikim të opinionit dhe të adresohen veprimet në prezantim dhe shpallje të drejtë të pasurisë, detyrimeve, të arkëtueshmeve dhe ekuitetit në 2017; procesi i përgatitjes së PFV-ve përfshinë një rishikim formal dhe efektiv nga menaxhmenti; të aplikohet një proces formal i monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të viteve të kaluara; të përmirësohen aranzhimet e llogaridhënies dhe cilësia e raportimit menaxherial; të shqyrtohet mundësia e themelimit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm; dhe të adresohen mangësitë e kontrolleve mbi shpenzimet, të hyrat dhe pasuritë.

Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës Sh.a.	2.53	Nënvlerësimi i llogarive të arkëtueshme; mos konfirmimi i llogarive të pagueshme për tatim dhe kontribute; detyrimet afatgjata për të hyrat e shtyra; ekuiteti i pasaktë i prezantuar në PFV i; dhe mos përputhje e shënimeve në kontabilitet me PFV.	Të analizohen arsyet për kualifikim të opinionit në 2016 dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurisë, detyrimeve, të arkëtueshmeve dhe ekuitetit në 2017; që procesi i përgatitjes së PFV-ve të përfshinë një rishikim formal dhe efektiv nga menaxhmenti; të aplikohet një proces formal i monitorimit mbi zbatimin e rekomandimeve të viteve të kaluara; të përmirësohen aranzhimet e llogaridhënies dhe raportimit menaxherial; dhe të adresohen mangësitë e kontrolleve mbi shpenzimet, pagat dhe të hyrat.
---	------	---	--

4.2 Opinione të Kundërta

Entiteti	Buxheti (në mil.€)	Arsyeja për opinionin e kundërt	Përmbledhja e rekomandimeve kryesore për menaxhmentin e subjekteve të audituara
KRM Pastërtia Ferizaj Sh.a.	1.59	Regjistrim i njëanshëm i transaksioneve në sistemin e kontabilitetit; Paqartësi në prezantim të detyrimeve tjera afatshkurtra; Prezantim jo i saktë i asetëve, i llogarive të arkëtueshme, dhe kapitalit rezervë; Shënime shpjeguese jo të plota dhe të sakta; dhe prezantim jo i drejtë i shpenzimeve.	Të analizohen arsyet për dhënien e opinionit të kundërt për PFV-të e vitit 2016 dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë për PFV-të në 2017; përcaktimi i objektivave afariste dhe financiare, dhe afateve kohore për realizimin e tyre dhe mënyrën e financimit të shpenzimeve; që Komiteti i Auditimit në mënyrë kritike rishikon planet, rezultatet dhe cilësinë e raporteve të auditimit të brendshëm; dhe të ndërmerren veprime konkrete me qëllim të eliminimit të dobësive në fushën e MFK-së.
Trainkos Sh.a.	4.56	Regjistrim i njëanshëm i transaksioneve në sistemin e kontabilitetit; Nënvlerësimi i kapitalit rezervë, llogarive të arkëtueshme, dhe stoqeve; Prezantim jo i saktë i pasurive jo qarkulluese dhe detyrime afatgjata; dhe Shënime shpjeguese jo të plota dhe të sakta.	Të analizohen arsyet për dhënien e opinionit të kundërt për PFV-të e vitit 2016 dhe të identifikohen veprimet për prezantim të drejtë dhe të vërtetë për PFV-të në 2017; të zbatohet një proces rigoroz i mbikëqyrjes për sigurimin e zbatimit të rekomandimeve të vitit paraprak; të përcaktohen afatet kohore për realizimin e objektivave dhe mënyrën e financimit të shpenzimeve; dhe Komiteti i Auditimit rishikon në mënyrë kritike planet, rezultatet dhe cilësinë e raporteve të auditimit të brendshëm.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të RVA-së të vitit 2015

Institucioni përgjegjës	Rekomandimet e zbatuara	Rekomandimet pjesërisht të zbatuara	Rekomandimet e pa zbatuara
<p>Kuvendi i Kosovës</p>	<p>Kapitulli 1</p> <ul style="list-style-type: none"> • Qeveria e Kosovës ka bërë një vlerësim për të identifikuar shkaqet që kanë ndikuar në menaxhim jo efikas të proceseve rreth menaxhimit financiar dhe kontrollit, • Përgaditja dhe zbatimi i planeve të veprimit për zbatimin e të gjitha rekomandimeve të dala nga ky raport dhe raportet individuale të auditimit, duhet të jetë në fokus të mbikqyrjes nga ana e Kuvendit. 	<p>Kapitulli 3</p> <ul style="list-style-type: none"> • Qeveria do të trajtojë me prioritet dhe do të monitorojë zbatimin e planit të veprimit për zbatimin e strategjisë për kontrollin e brendshëm të financave publike; • Përmes KMFP obligon bartësit e OB që të raportojnë në baza të rregullta kohore në lidhje me nivelin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit. <p>Kapitulli 4</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ka ushtruar ndikimin e vet tek Qeveria për të siguruar që rekomandimet tona për vitin aktual dhe ato paraprake adresohen plotësisht duke vendosur kontrolle efektive gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe duke siguruar vlerën për para. 	<p>Kapitulli 3</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në kuadër të Kuvendit të Kosovës të krijohet Njësia e Auditimit të Brendshëm për auditimin e institucioneve të Pavarura të Republikës së Kosovës. <p>Kapitulli 4</p> <ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi i aktiviteteve të procesit të prokurimit në KRPP rregullohet për të siguruar identifikimin, parandalimin dhe eliminimin e gabimeve të mundshme nga AK gjatë, e jo pas procesit të prokurimit.

<p>Kuvendi i Kosovës</p>	<p>Kapitulli 2</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të kërkojë nga Qeveria një raport në lidhje me progresin në rekomandimet e dhëna nga AP në RVA 2014, dhe rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, që ndërlidhen me këtë raport (duke detajuar progresin e arritur dhe duke identifikuar barrierat që kanë penguar zbatimin e plotë të rekomandimeve); dhe • Të kërkojë nga Qeveria që të përgatisë një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të AP-së në RVA 2015 dhe raporte në lidhje me progresin e zbatimit të këtij plani, në baza tremujore. Këto raporte duhet të sqarojnë qartë pse disa nga rekomandimet nuk janë zbatuar. 		
---------------------------------	--	--	--

<p>Qeveria</p>	<p>Kapitulli 1</p> <ul style="list-style-type: none"> Ministri i Financave gjatë përgatitjes së planit të të hyrave dhe ndërmarrjes së masave fiskale duhet të siguroj përfshirjen më aktive të menaxhmentit të dy (2) agjencive (DK dhe ATK) me qëllim që parashikimet buxhetore të jenë më të përafërta. Parashikimet buxhetore duhet të mbështetën në të dhëna të besueshme indikative për rrjedhat e të hyrave për gjatë vitit. 	<p>Kapitulli 1</p> <ul style="list-style-type: none"> Ministri i Financave në koordinim me Drejtorin e Thesarit të vendos procese efektive për të siguruar që plani i hartimit të RVF/BRK-së 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë dhe kërkesat e raportimit financiar. Në këtë aspekt, të siguroj buxhetimin e shpenzimeve në kategori ekonomike adekuate. Më tutje, procesi i konsolidimit duhet të përfshij informata plotësuese për llogaritë e arkëtueshme, regjistrimin dhe raportimin e plotë të pasurive kapitale, pagesave nga palët e treta si dhe të obligimeve të papaguara; Ministri i Financave në koordinim me Komisionin për Buxhet dhe Financa duhet të luaj rol më aktiv gjatë diskutimeve buxhetore me OB. Aty ku ka argumente dhe ekziston domosdoshmëria për buxhet shtesë të inkorporohen në buxhetet vijuese. Përderisa, buxheti për projekte kapitale duhet të vendoset vetëm për ato projekte të cilat janë të arsyetuara mirë duke zhvendosur buxhetimin e fondeve drejt qëllimeve apo prioriteteve më të rëndësishme dhe të realizueshme; Ngritja e efikasitetit dhe forcimi i kontroleve në menaxhimin dhe raportimin e llogarive të arkëtueshme. Të analizohen shkaqet e rritjes së llogarive të arkëtueshme në mënyrë që të nxjerrë shkaktarët e dështimit në pagesën e borxheve dhe të shfrytëzohen veprimet ligjore për inkasimin e tyre; Thesari/Divizioni për Monitorim në kuadër të MF-së duhet të ushtrojë kontrole më të rrepta të monitorimit në proceset e raportimeve mujore të obligimeve të papaguara. Një rishikim më kritik i raporteve për obligimet e papaguara është i nevojshëm dhe aty ku vonesat dhe vlera e obligimeve është materiale ta adresoj çështjen tek zyrtarët përgjegjës të organizatës përkatëse. 	<p>Kapitulli 1</p> <ul style="list-style-type: none"> Ministria e Financave/Thesari duhet të shqyrtoj aranzhimet ekzistuese të raportimit për t'iu mundësuar OB-ve ngritje të cilësisë së raportimit financiar. Në këtë aspekt, veprime kyçe duhet të ndërmerren si: përditësimi i planit kontabël i shoqëruar me udhëzime përkatëse, përditësimin e manualit të kontabilitetit dhe rregullave financiare. Me theks të veçantë, hartimi i rregullave për menaxhimin e subvencioneve dhe llogarive të arkëtueshme. Më tutje, duhet të siguroj mbajtjen e trajnimeve të rregullta me zyrtarët përgjegjës të përfshirë në raportimin financiar; Ministri i Financave duhet të rris llogaridhënien ndaj zyrtarëve të përfshirë në realizimin e projekteve të financuara nga huamarrja. Vendimi për huamarrje duhet të merret vetëm pas vendosjes së parakushteve si: projekte të dokumentuara mirë dhe të cilat kanë mundësi realizimi. Kjo duhet të bëhet me qëllim të përfitimit të mundësive për zhvillimin e ekonomisë së vendit në aspektin e investimeve publike.
-----------------------	---	---	--

<p>Qeveria</p>		<p>Kapitulli 2</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të zbatoj një proces sistematik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga AP në RVA 2015 dhe RVA të mëhershme. Ky proces duhet t'i identifikoj qartë dhe t'i adresojë barrierat në zbatimin e rekomandimeve; dhe • Të kërkojë nga të gjitha Organizatat buxhetore që të zbatojnë dhe raportojnë nivelin e progresit në zbatimin e rekomandimeve të auditimit, me raporte tremujore të progresit të dërguara në Ministri të Financave dhe në KMFP. Këto raporte duhet të sqarojnë pse disa nga rekomandimet nuk mund të zbatohen. <p>Kapitulli 3</p> <ul style="list-style-type: none"> • Është fuqizuar më tutje përgjegjësia menaxheriale nëpër organizatat buxhetore për të siguruar një mjedis më efikas të kontrollit të brendshëm, në rritjen e efektivitetit të AB-së dhe adresimin me kohë të rekomandimeve të auditimit. Derisa aprovimi i ligjit në pritje për KBFP si dhe kompletimi i akteve përcjellëse nënligjore do të rregullojë dhe zhvillojë më tutje sistemin e menaxhimit financiar dhe të kontrolleve në tërësi; • Proceset efektive të menaxhimit të rrezikut ndërmerren nga të gjitha OB-të, dhe se adresojnë barrierat për përmirësim në këtë fushë. DQH të vazhdoj ofrimin e trajnimeve menaxheriale për procesin e vetëvlerësimit dhe të menaxhimit të rrezikut, të identifikoj praktika të mira në OB-të e zgjedhura dhe ato të ndahen me të tjerat. Auditim i brendshëm të ketë një rol më aktiv në mbështetjen e këtij procesi; 	<p>Kapitulli 2</p> <p>Të përcjellë për së afërmi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të AP-së duke ftuar Ministrinë e Financave që të paraqesë gjendjen e rekomandimeve në njërën prej mbledhjeve të Qeverisë.</p>
-----------------------	--	---	---

<p>Qeveria</p>		<ul style="list-style-type: none"> • OB-të të hartojnë rregullore dhe procedura të brendshme përmes së cilave jepen udhëzimet e nevojshme në administrimin e përditshëm të aktiviteteve financiare dhe operative. Informimi dhe raportimi i brendshëm përfshirë edhe monitorimin e menaxhmentit të zhvillohet tutje; • Procesi i vetëvlerësimit të menaxhimit financiar dhe të kontrolleve nga ana e OB-ve të fuqizohet më tutje për ngritjen e objektivitetit dhe cilësisë së vlerësimit në tërësi. Në këtë drejtim, DQH të vazhdoj ofrimin e trajnimeve shtesë për menaxherët e OB-ve për rëndësinë e pyetësorit të vetëvlerësimit, për zhvillimin e procesit dhe për potencialin që ai ofron në zhvillimin e qeverisjes së mirë; • Është vendosur theksi në zhvillimet e ardhshme të auditimit të brendshëm, në sigurimin e kapaciteteve të duhura të NJAB-ve në krahasim me madhësinë e organizatave. Gjithashtu, me qëllim të rritjes së efektivitetit të auditimit të brendshëm, puna audituese të mbuloj gjithnjë e më shumë aktivitetet e vitit aktual, të rritet niveli i zbatimit të rekomandimeve të AB-së si dhe ngritjen e efektivitetit të komiteteve të auditimit; • Trajtohet dhe qartësohet mjaftueshëm çështja e pagesave të kompensimeve shtesë për anëtarët Komitetit të Auditimit në OB; • Merret në konsideratë rekomandimi i Komisionit Evropian për hartimin e një koncept dokumenti cili qartëson fushëveprimin e LSHC, statusin e nëpunësve civil në raport me kategoritë tjera të punësuarve, qartësimin e kriterëve të pranimit në SHC, depolitizimin dhe profesionalizmin e punonjësve, rregullimin më të qartë të pozitave të nivelit të lartë drejtues, promovimin në karrierë, procedurat disiplinore dhe pezullimin e marrëdhënies së punës; 	
----------------	--	--	--

<p>Qeveria</p>	<p>Kapitulli 4</p> <ul style="list-style-type: none"> Propozimi i anëtarëve të bordit të OSHP të bëhet me kohë në mënyr që të mos cenohet funksionalizimi i Bordit dhe të shmangen situatat ku ankesat e OE mbesin të pa shqyrtuara. 	<ul style="list-style-type: none"> SMIBNJ fillon së zbatuari në formë të plotë në të gjitha institucionet shtetërore. Të gjitha informatat e nevojshme për të punësuarit publik të regjistrohen dhe të përditësohen me kohë në këtë sistem; dhe Janë finalizuar të gjitha veprimet e nevojshme në fillimin e zbatimit të sistemit të ri të pagave. Menaxhmenti i OB duhet të trajtojë mangësitë e hasura në fushën e menaxhimit të personelit dhe kompensimeve shtesë përmes adresimit të rekomandimeve të dhëna nga ZKA. <p>Kapitulli 4</p> <ul style="list-style-type: none"> Aktivitetet e prokurimit të cilat janë përmbyllur dhe nënshkruar nga AQP mundësojnë arritjen e përfitimeve nga blerja aktuale e centralizuar dhe aplikimin e një qasje sistematike për të siguruar rritje të planifikuar të kontratave të AQP për vitet e ardhshme; Sistemi i prokurimit elektronik të zbatohet plotësisht në praktikë në të gjitha OB; Zhvillimet e nevojshme në OB për adresimin e rekomandimeve të AP, të cekura në Kapitullin 3, të vënë theks të veçantë në çështjet e prokurimit dhe me përgjigje të konsoliduar që mbulon adresimin e çështjeve të prokurimit të auditimeve të performancës. 	
-----------------------	--	---	--